



**KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG**

KONFLIKTI I INTERESIT DHE ETIKA MES GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

STANDARDET EVROPIANE NË NIVEL VENDOR



MSc. Ina Xhepa
MSc. Klara Kodra



KONFLIKTI I INTERESIT DHE ETIKA MES GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE: STANDARDET EVROPIANE NË NIVEL VENDOR

*(Përmbledhje e vendime të GJEDNJ-SË,
Vendime të Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane
dhe Vendime të Gjykatës Kushtetuese Italiane)*

MSc. Ina Xhepa
MSc. Klara Kodra

Përgatiti: MSc. Ina Xhepa,
MSc. Klara Kodra

Desing & Layout: Dritan Lleshi
Ilustrimet: Freepik.com

Ky botim u përgatit nga Qendra Europiane me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer, Zyra e Shqipërisë, në kuadër të projektit “Konflikti i interesit dhe etika mes gjyqtarëve dhe prokurorëve: standardet evropiane në nivel vendor”.

Përmbajtja e këtij materiali, opinionet, dhe vlerësimet e shprehura në të, janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet ose përdoret me asnjë formë e mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet ueb apo sisteme të tjera pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

QENDRA EUROPIANE
Rr. “Vaso Pasha”, P. 20/57,
Tirana, Albania
info@euro-centre.org
www.euro-centre.org

KONRAD-ADENUER-STIFTUNG SHQIPËRI
Blv. Dëshmorët e Kombit
Kulla Binjake 1, Kati 11
Tiranë, Shqipëri
[https:// www.kas.de/albanien](https://www.kas.de/albanien)

SHKURTIME

DHPP	Dhoma e Përgjegjësisë Profesionale
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJLA	Gjykata e Lartë e Arbitrazhit
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
KKGJ	Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit
KLGP	Këshilli i Lartë i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

PËRMBAJTJA

HYRJE	VII
-------------	-----

I.

PËRMBLEDHJE E VENDIME TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

1. Pavarësia dhe e drejta për proces të rregullt	3
Remli kundër Francës - (<i>Kërkesa nr. 16839/90</i>)	3
Luka kundër Rumanisë - (<i>Kërkesa nr. 34197/02</i>)	7
Stafford kundër Mbretërisë së Bashkuar - (<i>Kërkesa nr. 46295/99</i>) ...	10
2. Kriteret e pavarësisë	14
Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës - (<i>Kërkesa nr. 26374/18</i>)	14
Kontekstualizimi i situatës në Shqipëri	23
Xhoxhaj kundër Shqipërisë - (<i>Kërkesa nr. 15227/19</i>)	25
Besnik Cani kundër Shqipërisë - (<i>Kërkesa nr. 37474/20</i>)	43
Kontekstualizimi i situatës në Poloni	46
Grzeda kundër Polonisë - (<i>Kërkesa nr. 43572/18</i>)	48
Zurek kundër Polonisë - (<i>Kërkesa nr. 39650/18</i>)	51
Tuleya kundër Polonisë - (<i>Kërkesa nr. 21181/19</i>)	56
3. Paanshmëria objektive dhe subjektive	64
Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë (<i>Kërkesa nr. 24014/05</i>)	64
Filippini kundër San Marinos - (<i>Kërkesa nr. 10526/02</i>)	70

Ndikimi i jashtëm.....	70
Ndërhyrja nga palët në proces	71
Beg sh.p.k kundër Italisë - (<i>Kërkesa nr. 5312/11</i>).....	71
Ndikimet nga brenda gjyqësorit	74
Agrokompleks kundër Ukrainës - (<i>Kërkesa nr. 23465/03</i>)	74
4. Garancitë objektive për karrierën e gjyqtarëve	80
Broda dhe Bojara kundër Polonisë (<i>Kërkesat nr. 26691/18 dhe 27367/18</i>)	80
Bilgen kundër Turqisë - (<i>Kërkesa nr. 1571/07</i>).....	85
5. Etika	88
Oberschlick kundër Austrisë - (<i>Kërkesa nr. 11662/85</i>)	88

II.

PËRMBLEDHJE E VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE FEDEREALE GJERMANE

Kërkesa BvR 890/20.....	95
Kërkesat BvR 2034/16 dhe BvR 2011/16	98
Kërkesa BvR 661/16	101
Kërkesa BvR 2436/10.....	104

III.

PËRMBLEDHJE E VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE ITALIANE

Vendimi 16/2022 - (<i>Kërkesa nr. 44520</i>)	111
Vendimi 45/2023 - (<i>Kërkesa nr. 45424</i>)	113

HYRJE

Manuali “Konflikti i interesit dhe etika mes gjyqtarëve dhe prokurorëve: standardet evropiane në nivel vendor” që sjellim në këtë botim është produkt i realizimit të projektit me të njëjtin titull, i zbatuar nga Qendra Evropiane dhe Fondacioni Konrad Adenauer, Zyra për Shqipërinë.

Reforma në drejtësi e ndërmarrë në vendin tonë ka ardhur si një nevojë e adresimit të çështjeve që lidheshin me perceptimin e qytetarëve për shkallën e lartë të nivelit të korrupsionit në drejtësi. Duke marrë parasysh rëndësinë e reformës dhe ekzistencën e korrupsionit në gjyqësorin shqiptar, doktrina e hapësirës së vlerësimit lejon diskrecion nga Shtetet Palë në marrjen e masave të caktuara në lidhje me legjislacionin, administratën ose drejtësinë. Sidoqoftë, gjithmonë duhet të mbahet parasysh se përmbushja e standardeve të gjyqimit të drejtë dhe nevoja për të luftuar korrupsionin në gjyqësor nuk bëjnë përjashtim në këtë aspekt.

Ky manual sjell në vëmendje parimet që përbëjnë shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës që janë: pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës dhe e drejta për një proces të rregullt si dhe dy elemente kryesore që janë: garancitë objektive për karrierën e gjyqtarëve dhe etika. Për këto në këtë përmbledhje janë sjellë mjaft vendime të rëndësishme të jurisprudencës së vendeve të ndryshme.

Detyrimi që çdo gjykatë vendase të kontrollojë nëse përmbush kriteret e një “*gjykatë të paanshme*” sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së përbën një aspekt të rëndësishëm në përpjekje të fuqizimit të shtetit të së drejtës.

Nëse ndodh e kundërta, Gjykata i mohon palës/palëve mundësinë për të rivendosur të drejtën në vend, e cila vjen në kundërshtim me standardet e GJEDNJ.

Gjithashtu, në këtë përmbledhje sillet dhe një herë në vëmendje rëndësia që ka *nocioni i ndarjes së pushteteve mes ekzekutivit dhe gjyqësorit* dhe parimi i shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes nga arbitrariteti.

Po ashtu, e drejta e një “*gjykate të krijuar me ligj*” nuk duhet të interpretohet shumë gjerësisht në mënyrë që çdo parregullsi në një procedurë emërimi gjyqësor të mos rrezikojë komprometimin e kësaj të drejte. Konstatimi se një gjykatë nuk është “*e krijuar me ligj*” mund të ketë pasoja të konsiderueshme për *parimet e sigurisë juridike* dhe *paprekshmërisë së gjyqtarëve*. Ndërkohë që këto parime duhen respektuar me kujdes në funksion të qëllimeve të rëndësishme dhe sipas kërkesave të një “*gjykate të krijuar me ligj*”, në të kundërt mund të sjellin pasoja mbi shtetin e së drejtës dhe besimin e publikut në gjyqësor.

Ruajtja e pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimit të procedurave në rastet që kanë të bëjnë me karrierën e gjyqtarëve është mjaft e rëndësishme në përmbushje të *parimit të sigurisë së mandatit* gjatë ushtrimit të funksionit të tij/saj.

Për të gjitha parimet dhe elementet e mësipërme, Qendra vjen me këtë përmbledhje vendimesh të GJEDNJ-së, të Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane dhe të Gjykatës Kushtetuese Italiane, me qëllim rritjen e efektivitetit të masave në të kuptuarit dhe vënien në zbatim të standardeve evropiane nga profesionistët e ligjit dhe qytetarët shqiptarë.

I

PËRMBLEDHJE E VENDIME
TË GJYKATËS EVROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT

1. PAVARËSIA DHE E DREJTA PËR PROCES TË RREGULLT

*Në kontekstin e pranimin nga një anëtar i jurisë se ishte racist,
mos-kontrollimi nëse gjykata i përmbushte kriteret e një gjykate të
paanshme përbëri shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës*

REMLI KUNDËR FRANCËS

(Kërkesa nr. 16839/90)

23 prill 1996

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi, Said André Remli, shtetas francez me origjinë algjeriane, i cili ishte duke kryer dënimin në burgun e Marsejës, në Francë. Kërkuesi dhe një i burgosur tjetër (z. Boumédiène Merdji, me origjinë algjeriane) vranë një roje burgu gjatë përpjekjes për t'u arratisur, dhe u akuzuan për vrasje të qëllimshme me synim të lehtësimit, përgatitjes ose ekzekutimit të veprave të arratisjes dhe arratisjes në tentativë.

Kërkuesi dhe z. Merdji u gjykuan nga Gjykata e Assizës në Rhone më 12, 13 dhe 14 prill 1989. Më 12 prill, para fillimit të seancës, një palë e tretë (znj. M), dëgjoi njërin prej anëtarëve të jurisë në gjyq duke thënë "për më tepër, unë jam racist". Znj. M., vuri në dijeni avokatin e kërkuesit për këtë koment dhe identifikoi anëtarin e jurisë në fjalë. Më 13 prill avokati bëri kërkesë që Gjykata e Assizës të nxirrte një notë formale të incidentit, gjë që u refuzua për shkak se deklarata ishte bërë para fillimit të seancës së parë dhe jo në prani të gjyqtarëve.

Më 14 prill, Gjykata e Assizës e dënoi kërkuesin me burgim të përjetshëm dhe z. Merdji me njëzet vjet burg. Kërkuesi apeloj pranë Gjykatës së Kasacionit mbi pika të ligjit, duke argumentuar se Gjykata e Assizës kishte shpërfillur nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke u shprehur se ajo nuk mund të mbante shënime rreth ngjarjeve që supozohej se kishin ndodhur jashtë pranisë së saj kur e kishte fuqinë për ta bërë një gjë të tillë. Gjykata e Kasacionit e rrëzoi apelin, duke deklaruar se Gjykata e Assizës “me të drejtë refuzoi të mbante shënim një ngjarje e cila, nëse vërtetohej, kishte ndodhur jashtë seancës, në mënyrë të atillë që ajo nuk do të kishte pasur mundësi ta mbante shënim”. Kërkuesi pretendoi për shkelje të nenit 6 (e drejta për proces të drejtë) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) për shkak se ai nuk ishte gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe që ai ishte diskriminuar mbi baza racore. Përveç kësaj, ai pretendoi për shkelje të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive).

VENDIMI I GJYKATËS

Pranueshmëria

Në lidhje me kërkesën e bazuar mbi nenin 14 marrë së bashku me nenin 6, Gjykata gjeti se mos-ankimi nga ana e kërkuesit për diskriminim në gjykatat vendase do të thoshte se ai nuk i kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore, për rrjedhojë kjo kërkesë u deklarua e papranueshme. Kërkesa në lidhje me paanshmërinë e Gjykatës së Assizës u deklarua e pranueshme.

Neni 6 § 1

Kërkuesi parashtrroi se kur një gjykatë që gjykon persona me origjinë nga kombësi e huaj përfshinte një anëtar jurie i cili, para seancës, kishte shprehur publikisht ndjenja raciste, asaj i mungonte paanshmëria. Anëtari i jurisë në fjalë, argumentoi kërkuesi, nuk duhet të kishte marrë pjesë në një çështje të cilën ai nuk ishte në gjendje ta vlerësonte

me objektivitet të plotë. Dështimi i Gjykatës së Assizës për të nxjerrë një notë formale rreth një komenti ia mohoi kërkuarit mundësinë për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, siç kërkohet nga neni 6 § 1. Qeveria pranoi se çdo gjykatë që kishte në përbërje të trupit gjykues një anëtar, i cili deklaronte në mënyrë të hapur se ishte racist nuk mund të shihej si e paanshme. Megjithatë, duhet të konstatohej me siguri se opinionet raciste ishin bindje të vërteta dhe se ato kishin mundur të ndikonin tek vendimi rreth fajësisë. Fjalja “për më tepër, unë jam racist” mund të ishte thënë si shaka ose në lidhje me një çështje tjetër. Më tej, nuk mund të pritet që një gjykatë të verifikojë të gjitha komentet që mund të bëjë një anëtar i jurisë para hedhjes së shortit.

Gjykata kujtoi që, gjatë marrjes së vendimit nëse ka arsye legjitime për të dyshuar se një gjyqtari të caktuar i mungon paanshmëria, faktori vendimtar nuk është këndvështrimi i të akuzuarit por fakti nëse frika e të akuzuarit mund të justifikohet objektivisht. Në rastin konkret, Gjykata theksoi domethënien e deklaratës në kontekstin e një gjyqi të dy burrave me origjinë afrikano-veriore. Gjykata vërejti se Gjykata e Assizës e rrëzoi kërkesën për të nxjerrë notë formale mbi bazën se ajo nuk mund “të nxirrte notë formale për të gjitha ngjarjet që supozohej se kishin ndodhur jashtë pranisë së saj”, e as nuk urdhëroi që të mblidheshin prova për ta verifikuar raportimin.

Kështu, kërkuari nuk pati mundësi që i) ta zëvendësonte anëtarin e jurisë në fjalë; ii) të shfrytëzonte komentet që e mbështesnin apelin e tij mbi pika të ligjit; ose iii) të kontestonte anëtarin e jurisë, meqenëse juria ishte krijuar përfundimisht. Më tej, kërkuari nuk pati mundësi ta apelonte vendimin e Gjykatës së Assizës përveç se mbi pika të ligjit. Gjykata konsideroi që neni 6 § 1 caktonte detyrimin që çdo gjykatë vendase të kontrollonte nëse i përmbushte kriteret e një “gjykate të paanshme”. Sipas fakteve, dështimi i Gjykatës së Assizës për të vërtetuar që e kishte bërë këtë ia mohoi kërkuarit mundësinë për të ndrequr një situatë në kundërshtim me Konventën. Kjo, e parë në

kuadër të nevojës që gjykata të ushqejë besim tek ata që i nënshtrohen juridiksionit të saj, përbëri shkelje të nenit 6 § 1.

Neni 50 (tani neni 41)

Konstatimi i shkeljes së nenit 6 § 1 përbënte një shpërblim të drejtë dhe të mjaftueshëm për kërkuesin. Megjithatë, Gjykata e urdhëroi Qeverinë që t'i paguante kërkuesit në lidhje me kostot dhe shpenzimet gjyqësore shumën prej 60,000 franga franceze (afërsisht 9,150 euro).

*Moszbatimi i një vendimi të formës së prerë në favor të kërkuetit
derivonte në shkelje të nenit 6 § 1*

LUKA KUNDËR RUMANISË

(Kërkesa nr. 34197/02)

21 korrik 2009

FAKTET KRYESORE

Kërkueti, Gusztav Luka, është shtetas rumun i cili ka lindur në 1956 dhe jeton në Târgu-Mureş (Rumani). Pasi u pushua nga puna në vitin 1999 nga kompania për të cilën kishte punuar si menaxher dhe shef i departamentit të IT-së, ai ngriti padi për anulimin e këtij vendimi, duke kërkuar edhe dëmshpërblim. Gjykatat vendase vendosën në favor të tij në proceset e zhvilluara në vitin 2000, por në vitin 2003 nisën dy procese të tjera në lidhje me llogaritjen e dëmit dhe ekzekutimin e vendimit. Z. Luka u ankua për praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese duke argumentuar se përbërja e trupit gjykues, që shqyrtonte çështjen e tij (Gjykata e Shkallës së Parë Târgu-Mureş) ishte jo-kushtetuese sepse përfshinte gjyqtarë porotë (“*asistentë gjyqtar*”). Ai u rimor në punë në shtator 2003.

Dy ankimet kryesore të z. Luka u ngritën në bazë të nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt). Ai parashtroi se gjykatat që shqyrtonin rastin e tij nuk kishin qenë as të paanshme dhe as të pavarura, sepse ato kishin përfshirë gjyqtarë porotë. Ai u ankua gjithashtu se arsyeja e apelit e tij në lidhje me anti-kushtetutshmërinë e pretenduar të trupit gjykues në rastin e tij nuk ishte adresuar.

VENDIMI I GJYKATËS

Pretendimi për mungesë të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjykatave

Gjykata nuk mohoi avantazhin e gjykatave të përbëra nga një përzierje e gjyqtarëve profesionistë dhe porotë në fusha ku përvoja e këtyre të fundit ishte e nevojshme për të përcaktuar çështje specifike që mund të lindnin. Ky sistem, i cili ekzistonte në një sërë shtetesh palë të Konventës, nuk ishte në vetvete në kundërshtim me Konventën. Megjithatë, roli dhe detyrat e “asistentëve gjyqësorë”, siç parashikohej në legjislacionin rumun në atë kohë, nuk i mbronte ata ndaj presionit të jashtëm. Ligji i brendshëm nuk kishte dhënë garanci të mjaftueshme për pavarësinë e tyre në kryerjen e detyrave. Ndër të tjera, ata nuk kishin qenë të pazëvendësueshëm apo të mbrojtur nga përfundimi i parakohshëm i detyrës të tyre, si dhe mund të kryenin funksione dhe aktivitete të tjera që u ishin caktuar nga organizatat në emër të të cilave ishin zgjedhur (shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat). Meqenëse shqetësimet e z. Luka për mungesën e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës ishin të justifikuar objektivisht, Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Dështimi për të adresuar apelin e kërkuarit

Gjykatave vendase iu kërkua të bënin një shqyrtim të kujdesshëm të parashtrësive të palëve, duke adresuar ato që ishin relevante dhe kishin një efekt në rezultatin e çështjes. Gjykata e Strasburgut vlerësoi se arsyeja e paraqitur nga z. Luka kishte qenë e rëndësishme për rezultatin e çështjes pasi ishte bazuar në një vendim të Gjykatës Kushtetuese (i cili ishte detyruar për të gjitha autoritetet) në të njëjtën linjë. Gjithashtu, ajo mund të kishte ndikim në rezultatin e çështjes, pasi Gjykata e Apelit ishte e autorizuar të shqyrtonte çështjen. Prandaj, arsyetimi i paraqitur kërkonte një përgjigje specifike dhe të shprehur. Në mungesë të një përgjigjeje të tillë, ishte e pamundur të

dihej nëse Gjykata e Apelit thjesht e kishte neglizhuar vendimin e apelit apo kishte vendosur të mos e shqyrtonte atë dhe nëse po, pse.

Gjykata vuri në dukje se legjislacioni rumun kishte ndryshuar: në raste të tilla, gjyqtarët profesionistë asistoheshin nga “asistentë gjyqtarë”, roli i të cilëve ishte thjesht këshillues. Megjithatë, ndryshimi kishte ndodhur pas vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Apelit, kështu që edhe nëse ankimi i kërkuarit do të ishte lejuar, në atë kohë kjo nuk do të ishte e mjaftueshme për të lejuar një rishqyrtimin e çështjes së tij në përputhje me Konventën. Për këtë arsye Gjykata gjeti një shkelje të mëtejshme të nenit 6 § 1 të Konventës.

Paraburgimi i një personi me urdhër të ministrit, në vend të vendimit të një gjykate, përbënte shkelje të nenit 5, sepse pushteti i tillë ekzekutiv nuk ishte në përputhje me nocionin e ndarjes së pushteteve ose parimin e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen nga arbitrariteti

STAFFORD KUNDËR MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa nr. 46295/99)

28 maj 2002

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi, z. Dennis Stafford, u shpall fajtor për vrasje në vitin 1967. Në vitin 1979 ai u lirua me kusht, po nuk lejohej të dilte jashtë Mbretërisë së Bashkuar. Pas kësaj, kërkuesi e shkeli lirimin me kusht, pasi në vitin 1980 ai udhëtoi jashtë vendit. Në vitin 1989 ai u rikthye në Mbretërinë e Bashkuar me një pasaportë të falsifikuar dhe u arrestua. Pasi pagoi gjobë për posedim të një dokumenti të falsifikuar, kërkuesi u mbajt në paraurgim. Në vitin 1991, pas një ri-shqyrtimi, ai sërish u lirua me kusht. Megjithatë, në vitin 1993 ai u arrestua sërish dhe u shpall fajtor me akuzën e mashtrimit, duke u dënuar me gjashtë vjet burgim.

Në vitin 1996, çështja e tij u mor në shqyrtim dhe Bordi i Lirimit me Kusht, e cila rekomandoi lirimin e tij. Ky rekomandim u refuzua nga Sekretari i Shtetit. Kërkuesi kërkoi rishqyrtim të rastit. Vendimi i Sekretarit të Shtetit u hodh poshtë me arsyetimin se ky autoritet nuk kishte tragrin për të vendosur mbi paraburgimin e një personi të dënuar me burg të përjetshëm pasi ai e kishte vuajtur dënimin me burg dhe nuk përbënte rrezik për përsëritjen e veprave penale. Megjithatë, vendimi i Sekretarit të Shtetit u la në fuqi nga Gjykata e Apelit, dhe Dhoma e Lordëve e ndaloi apelimin e mëtejshëm. Në vitin 1998,

kërkuesi u lirua me kusht, gati një vit pas kohës kur duhej të ishte liruar për dënimin e tij për mashtrim. Duke u mbështetur në nenet 5 § 1 (e drejta për lirinë dhe siguri) dhe 5 § 4 (e drejta për vendosjen e shpejtë nga gjykata të ligjshmërisë së paraburgimit të personit) të Konventës, kërkuesi u ankua para Gjykatës së paraburgimit të tij ashtu siç ishte vendosur nga Sekretari i Shtetit ishte arbitrar dhe se ai duhet të kishte pasur mundësinë për të bërë kërkesë para një organi, i cili mund ta kishte shqyrtuar dhe kishte vendosur për vazhdimin e paraburgimit të tij, në vend të një organi që mund të nxirrte vetëm rekomandime jodetyruese.

VENDIMI I GJYKATËS

Neni 5 § 1

Fillimisht, Gjykata përcaktoi se ndërkohë që ajo e kishte konsideruar nëse regjimi i Mbretërisë së Bashkuar për burgimin e përjetshëm kishte qenë në pajtueshmëri me Konventën në çështje të mëparshme, në interes të vazhdimësisë dinamike të Konventës dhe në mënyrë që të drejtat që përmbante ai ishin praktike dhe efektive, ishte e nevojshme të rivlerësohej regjimi i dënimeve që ishin me burgim të përjetshëm në ‘kushtet e sotme’ në Mbretërinë e Bashkuar. Në mënyrë të veçantë, Gjykata ishte e mendimit se, ndryshe nga çështjet e mëparshme, tani ishte konstatuar në të drejtën vendase që dënimi i përjetshëm që kishte marrë kërkuesi nuk ishte ndëshkim i pacaktuar por dënim i caktuar vazhdimi i të cilit, ishte i bazuar mbi vlerësimin e karakteristikave të personit të burgosur.

Në çështjen në fjalë, kërkuesi e kishte përfunduar periudhën e burgimit të përjetshëm në vitin 1979 kur u lirua së pari me kusht.

Prandaj, Gjykata arsyetoi që, pasi periudha e burgimit të tij në lidhje me dënimin për mashtrim kishte përfunduar më 1 korrik 1997, vazhdimi i paraburgimit të tij sipas kushteve të dënimit të përjetshëm

të detyrueshëm nuk mund të shihej si i justifikuar si ndëshkim për krimin e tij original. As Sekretari i Shtetit nuk e justifikoi mbajtjen në burg të kërkuesit me rrezikshmërinë e tij për publikun.

Gjykata më tej shpjegoi që, sipas nenit 5 § 1 (a), një individ mund të privohej nga e drejta e lirisë dhe sigurisë së personit në rastet kur privimi kryhej përmes një procedure të parashikuar me ligj dhe kur ai përbënte paraburgim të ligjshëm të personit pas dënimit nga një gjykatë kompetente. Në mënyrë që të ndodhë kjo ‘pas dënimit’ duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore mes dënimit dhe paraburgimit.

Në këtë rast, Gjykata nuk e gjeti një lidhje të tillë shkakësore mes paraburgimit të kërkuesit pas 1 korrikut 1997 dhe dënimit të tij për vrasje.

Gjykata vuri në dukje se në të drejtën vendase nuk kishte pushtet që autorizonte caktimin e paraburgimit ndaj një personi për një kohë të pacaktuar me qëllim që të parandalohej kryerja prej tij e veprave të tjera jo të dhunshme. Gjykata më tej doli në përfundimin se paraburgimi i kërkuesit nga Sekretari i Shtetit mbi bazën e frikës së përgjithshme që ai mund të kryente vepra jo të dhunshme në të ardhmen nuk ishte në pajtueshmëri me theksin që Konventa vë tek shteti i së drejtës dhe mbrojtja nga arbitrariteti. Prandaj, Gjykata gjeti se paraburgimi i kërkuesit pas përfundimit të periudhës së burgimit të tij për mashtrim nuk përmbushte kriteret e justifikimit sipas nenit 5 § 1 (a) dhe se prandaj kishte pasur shkelje të nenit 5 § 1.

Neni 5 § 4

Gjykata filloi duke përsëritur që, meqenëse burgimi i kërkuesit përmbante elementin ndëshkues të dënimit të tij me burg të përjetshëm, vendimi i Sekretarit të Shtetit për ta vazhduar burgimin e tij ishte praktikë dënimi e rrjedhimisht brenda fushëveprimit të nenit 5 § 4. Gjykata arsyetoi se nuk ishte e mjaftueshme që kriteret e nenit

5 § 4 të ishin përmbushur vetëm gjatë procesit gjyqësor origjinal dhe procedurave të apelit, por ato duheshin përmbushur gjatë përcaktimit vijues të paraburgimit. Gjykata ishte e qartë se, meqë paraburgimi i kërkuesit pas përfundimit të periudhës së burgimit të tij për mashtrim ishte urdhëruar nga Sekretari i Shtetit, ligjshmëria e paraburgimit të kërkuesit gjatë asaj kohe nuk ishte vendosur nga një 'gjykatë'. Gjykata u shpreh qartë se procesi përmes të cilit Sekretari i Shtetit kishte urdhëruar paraburgimin e kërkuesit nuk kishte përmbajtur mbrojtjet e kërkuara të një gjykate, përfshirë, për shembull, mundësinë e një seance dëgjimore me gojë. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 5 § 4.

Neni 41

Gjykata vendosi që kërkuesit duhet t'i akordohej shuma 16,500 euro në lidhje me dëmin material dhe jomateriale, dhe 17,865.10 paund në lidhje me kosto dhe shpenzimet gjyqësore.

2. KRITERET E PAVARËSISË

a. Gjykata e krijuar me ligj

Emërimi i gjyqtarëve në Gjykatën e re të Apelit Islandez binte ndesh me parimin e një gjykate të krijuar me ligj

GUÐMUNDUR ANDRI ÁSTRÁÐSSON KUNDËR ISLANDËS

(Kërkesa nr. 26374/18)

1 dhjetor 2020

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi, Guðmundur Andri Ástráðsson, është shtetas islandez i lindur në 1985 dhe jeton në Kópavogur (Islandë).

Në mars 2017, z. Ástráðsson u dënua për drejtim mjete pa patentë të vlefshme dhe nën ndikimin e drogës. Ankesa e tij u dëgjua nga Gjykata e Apelit (Landsréttur), e cila ishte krijuar në janar 2018. Gjyqtarja A.E. ishte një nga gjyqtarët e caktuara për çështjen e tij dhe z. Ástráðsson kërkoi tërheqjen e saj, duke argumentuar se kishte parregullsi në procedurën e emërimit të saj siç përcaktohet nga Gjykata Supreme në vendimet e saj të dhjetorit 2017, por kërkesa e tij u refuzua.

Gjykata e Apelit la në fuqi dënimin e z. Ástráðsson dhe në prill 2018 ai apeloj në Gjykatën e Lartë, duke argumentuar se emërimi i A.E. nuk

kishte qenë në përputhje me ligjin dhe se atij nuk i ishte respektuar e drejta për një gjykim të drejtë përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj. Gjithashtu, ai pretendoi se kishte pasur një motiv politik për emërimin e saj.

Në maj 2018, Gjykata e Lartë e hodhi poshtë ankimin e tij. Ajo konstatoi se përkundër të metave në procedurën me të cilën A.E. ishte emëruar në Gjykatën e Apelit, emërimi i saj kishte qenë i vlefshëm. Ajo konsideroi se nuk kishte arsye të mjaftueshme për të dyshuar se z. Ástráðsson nuk i ishte respektuar e drejta për një gjykim të drejtë përpara gjyqtarëve të pavarur dhe të paanshme.

Procedura për emërimin e gjyqtarës A.E.

A.E ishte emëruar pas një procedure përzgjedhjeje ku një Komision Vlerësues kishte vlerësuar fillimisht 33 kandidatë për postet e 15 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit dhe kishte rekomanduar një listë me 15 kandidatë, të cilët i konsideronte si më të kualifikuarit për t'u emëruar në atë detyrë.

Në zbatim të dispozitës përkatëse të Aktit Gjyqësor nr. 50/2016 ("Ligji i ri për Gjyqësorin"), Ministri i Drejtësisë mund të distancohej nga vlerësimi i Komisionit të Vlerësimit dhe të propozonte një ose më shumë kandidatë të ndryshëm me kusht që kandidati(ët) e propozuar të ishin gjetur nga Komisioni, të plotësonin të gjitha kërkesat minimale të përcaktuara për një emërim të tillë në Aktin Gjyqësor dhe që propozimi të jetë pranuar nga Parlamenti.

Në rastin konkret, Ministrja e Drejtësisë zgjodhi 11 nga 15 kandidatët e sugjeruar të Komisionit, duke shtuar katër të tjerë, përfshirë A.E., i cili ishte renditur më poshtë në listën e Komisionit për kandidatët më të mirë. Ministrja paraqiti disa argumente për ndryshimet që kishte bërë në lidhje me përzgjedhjen e Komisionit.

Në qershor 2017, Parlamenti votoi me shumicë, për të miratuar listën e ministrimit dhe më vonë atë muaj Presidenti i Islandës nënshkroi letrat e emërimit për gjyqtarët e rinj, duke përfshirë A.E.

Dy kandidatë të cilët ishin propozuar nga Komisioni Vlerësues, por ishin larguar nga Ministrja paditën shtetin islandez, duke sfiduar ligjshmërinë e procedurës së emërimit. Në dhjetor 2017, Gjykata e Lartë refuzoi kërkesat e tyre për kompensim dëmi material, por i dha secilit prej tyre 700,000 krónur islandezë (ISK) (afërsisht 5,700 euro) për dëmin jo-material.

Gjykata e Lartë, në dy vendime të datës 19 dhjetor 2017, konstatoi se Ministrja kishte shkelur ligjin administrativ duke mos e mbështetur propozimin e saj në Parlament me një hetim të pavarur që do të kishte dhënë informacionin e nevojshëm për vlerësimin e meritave të kandidatëve që ajo kishte zgjedhur. Procedura në Parlament kishte gjithashtu të meta, për sa i përket katër kandidatëve që nuk ishin në listën origjinale, pasi Parlamenti kishte miratuar listën e ndryshuar në bllok pa votuar për secilin kandidat veç e veç, siç kërkohej me ligj.

Duke u mbështetur në nenin 6 § 1 (e drejta për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj) të KEDNJ, z. Ástráðsson u ankua se një nga tre gjyqtarët në grupin e Gjykatës së Apelit të sapokrijuar, e cila kishte mbështetur dënimin penal, përkatësisht A.E., nuk ishte caktuar në përputhje me legjislacionin vendas përkatës dhe se, për rrjedhojë, akuza penale kundër tij nuk ishte dhënë nga një “gjykatë e krijuar me ligj”, në kuptim të asaj dispozite. Z. Ástráðsson u ankua më tej se atij i ishte mohuar e drejta për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme siç parashikohet në nenin 6 § 1 të Konventës, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e A.E. në trupën gjykuese, që kishte vendosur për çështjen e tij, pavarësisht defekteve në emërimin e saj.

VENDIMI I GJYKATËS

Neni 6 § 1 (gjykata e krijuar me ligj)

Duke iu referuar vendimeve të Gjykatës së Lartë Islandeze të datës 19 dhjetor 2017, Gjykata vërejt se procesi me të cilin gjyqtari A.E. ishte emëruar në Gjykatën e Apelit kishte dështuar në përputhje me disa nga rregullat përkatëse të ligjit të brendshëm për emërimet në gjyqësor.

Duke pasur parasysh implikimet e mundshme të gjetjes së një shkeljeje dhe interesave të rëndësishme kundër balancues në fjalë, Gjykata ishte e mendimit se e drejta për një “gjykatë të krijuar me ligj” nuk duhet të interpretohet shumë gjerësisht në mënyrë që çdo parregullsi në një procedurë emërimi gjyqësor të mos rrezikojë komprometimin e kësaj të drejte. Një konstatim se një gjykatë nuk ishte një “gjykatë e krijuar me ligj” mund të ketë pasoja të konsiderueshme për parimet e sigurisë juridike dhe paprekshmërisë së gjyqtarëve. Ndërkohë që këto parime duheshin respektuar me kujdes në funksion të qëllimeve të rëndësishme që u shërbenin, për t’i mbështetur ato me çdo kusht dhe në kurriz të kërkesave të një “gjykate të krijuar me ligj” në rrethana të caktuara mund të shkaktonte edhe më tej dëme mbi shtetin e së drejtës dhe besimin e publikut në gjyqësor.

Gjykata formuloi në këtë mënyrë një test me tre hapa për të përcaktuar nëse parregullsitë në një procedurë emërimi gjyqësor ishin aq serioze sa që shkaktonin shkelje të së drejtës për një gjykatë të krijuar me ligj.

Hapi 1: Nëse ka pasur një shkelje të dukshme të ligjit të brendshëm

Në vendimet e saj të 19 dhjetorit 2017 dhe 24 majit 2018, Gjykata e Lartë Islandeze arriti në përfundimin se ligji vendas nuk ishte respektuar në dy aspekte gjatë procesit të emërimit të gjyqtarëve të

Gjykatës së Apelit. Së pari, Ministrja e Drejtësisë dështoi në kryerjen e një vlerësimi të pavarur të fakteve dhe nuk kishte dhënë arsye të përshtatshme për ndryshimet e bëra në krahasim me përfundimet e Komisionit Vlerësues, në kundërshtim me nenin 10 të Ligjit të Procedurave Administrative. Së dyti, Parlamenti Islandez nuk kishte respektuar procedurën e veçantë të votimit sipas dispozitës së përkohshme IV të Ligjit të ri Gjyqësor (një votim i veçantë për secilin prej kandidatëve të propozuar nga Ministri).

Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi se nuk kishte asnjë arsye për të vënë në pikëpyetje interpretimin e ligjit të brendshëm nga Gjykata e Lartë dhe se kushti i parë i testit ishte përmbushur.

Hapi 2: Nëse shkeljet e ligjit të brendshëm lidhen me ndonjë rregull themelor të procedurës së emërimit të gjyqtarëve

Gjykata vërejti se, në kuadër të reformës ligjore Komisioni i Vlerësimit ishte autorizuar të lëshonte rekomandime detyruese për emërimet gjyqësore në gjykatat e të tre niveleve.

Ligji e lejonte që vetëm për raste të jashtëzakonshme Ministri i Drejtësisë mund të devijonte deri në një farë pike nga vlerësimi i Komisionit. Megjithatë sipas ligjit vendas përdorimi i këtij diskrecioni duhet të mbetet subjekt i kontrollit parlamentar. Qëllimi kryesor i këtij mekanizmi ishte të kufizonte ndikimin e ekzekutivit në emërimin e gjyqtarëve dhe në këtë mënyrë të forconte pavarësinë e gjyqësorit në Islandë. Në dritën e këtyre shpjegimeve, i takoi Gjykatës të përcaktojë nëse shkeljet në procedurën për emërimin e katër gjyqtarëve të propozuar nga ministrja, ku përfshihej edhe gjyqtarja A.E., ishin të një rëndësie të tillë sa të cenonin legjitimitetin e këtij procesi dhe minojnë vetë thelbin e të drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj”.

Në lidhje me shkeljet e bëra ministrja shpjegoi në Parlament se kishte vendosur të largohej nga vlerësimi i Komisionit me qëllim që ti jepte

më shumë peshë përvojës gjyqësore të kandidatëve dhe të siguronte ekuilibrin gjinor. Megjithatë, vendimi i Komisionit të Vlerësimit për t'i dhënë të njëjtën peshë përvojës së punës në gjyqësor dhe përvojës administrative, kishte qenë në përputhje me legjislacionin përkatës dhe praktikën e Komisionit për të paktën katër vjet.

Për më tepër, metoda e vlerësimit të Komisionit ka qenë në përputhje me kërkesat e balancës gjinore të parashikuara në Ligjin për Barazinë (Ligji nr. 10/2008). Gjykata e Lartë Islandeze, në vendimet e saj të 19 dhjetorit 2017, kishte deklaruar qartë se Ministrja e Drejtësisë nuk mund të mbështetej në konsideratat e barazisë gjinore të ligjit të sipër cituar, sepse ato aplikoheshin vetëm kur dy kandidatë të gjinive të ndryshme, konsiderohen njësoj të kualifikuar.

Megjithatë, edhe nëse supozohet se vlerësimi i Komisionit kishte pasur të meta dhe se Ministrja e Drejtësisë kishte vendosur ndryshe për arsye legjitime, përfundimi kryesor i nxjerrë nga vendimi i Gjykatës së Lartë i dhjetorit 2017 nënvizonte se Ministrja thjesht nuk kishte shpjeguar argumentet mbi të cilat kishte bazuar zgjedhjen e saj siç kërkohet nga neni 10 i Ligjit të Procedurave Administrative. Mos dakordësimi i ministres me metodën e vlerësimit të Komisionit nuk e kishte liruar atë nga detyrimi për të dhënë arsye të forta për vendimmarrjen e saj.

Sipas mendimit të Gjykatës, paqartësia rreth motiveve që kishin shtyrë ministren drejt një vendimmarrjeje të ndryshme kishin krijuar një frikë serioze për ndërhyrje të panevojshme në gjyqësor dhe në këtë mënyrë kishte njollosur legjitimitetin e të gjithë procesit. Kjo situatë vinte veçanërisht edhe për shkak të faktit se ministrja i përkiste njëres prej partive politike, që përbënin shumicën në qeverinë e koalicionit, vetëm me votat e të cilit ishte miratuar propozimi i saj në Parlament.

Për më tepër, në një kohë kur Gjykata nuk ishte në gjendje të pohonte se, siç pretendohet nga kërkuesi, ministrja kishte vepruar për motive

politike, ajo ishte e mendimit se veprimet e saj mund të kishin shkaktuar shqetësime të justifikuara objektivisht. Për rrjedhojë, kjo situatë kishte dëmtuar transparencën e procesit të përzgjedhjes.

Së fundi, mosrespektimi i rregullave përkatëse nga ana e ministres ishte edhe më serioz, pasi asaj iu kujtuan detyrimet ligjore në një sërë rastesh nga këshilltarët ligjorë në ministrinë e saj, nga Kryetari i Komisionit të Vlerësimit dhe nga Sekretar i Përhershëm *ad hoc* i Ministrisë së Drejtësisë.

Gjithashtu, Gjykata iu referua konstatimit të Gjykatës së Lartë në vendimin e saj të dhjetorit 2017 se Ministrja kishte vepruar “duke shpërfillur plotësisht rrezikun e dukshëm” për reputacionin e kandidatëve që nuk u zgjodhën. Kështu, ishte e drejtë të konkludohej se Ministrja dukej se kishte vepruar në dijeni të plotë të detyrimeve të saj sipas ligjit vendas. Duke pasur parasysh shkeljet e bëra prej saj dhe rrethanat në të cilat ato kishin ndodhur, Gjykata konstatoi se ato nuk ishin thjesht defekte teknike apo procedurale, por përbënin parregullsi të rënda që shkonin në thelbin e së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj”.

Sa i përket mangësive në procedurën parlamentare, Gjykata vuri në dukje se Parlamenti jo vetëm nuk kishte kërkuar, që Ministrja të jepte arsye objektive për propozimet e saj, por kishte shpërfillur rregullat e veçanta të votimit sipas dispozitës së përkohshme IV të Ligjit të ri për Gjyqësorin, duke e vendosur propozimin e ministres në një votim *en block* në vend të votimit të veçantë për secilin prej kandidatëve. Ky dështim nga ana e Parlamentit nuk do të ishte në vetvete një shkelje e së drejtës për një «gjykatë të krijuar me ligj», në një kohë kur deputetëve iu ofrua mundësia për të kërkuar një votim të veçantë për secilin kandidat. Një procedurë e tillë votimi kishte minuar rolin e Parlamentit si një kontroll kundër ushtrimit të paligjshmërisë sa i takon emërimeve në gjyqësor. Rrjedhimisht, kërkuesi ka pasur arsye

të justifikuara për të besuar se vendimi i Parlamentit ishte nxitur kryesisht nga përkatësitë politike partiake.

Në një kohë që procedura e posaçme e votimit parlamentar kishte pasur qëllim të forconte legjitimitetin e emërimeve në Gjykatën e sapokrijuar të Apelit, ndërhyrja konkrete e Parlamentit nuk kishte dhënë efektin e dëshiruar. Me fjalë të tjera, Parlamenti nuk kishte përmbushur detyrën e tij si garantues i ligjshmërisë së procedurës së emërimit për katër kandidatët në fjalë. Për rrjedhojë, kishte pasur një shkelje të rëndë në procedurën e emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit.

Hapi 3: Nëse shkeljet e pretenduara të së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj” u shqyrtuan dhe u korrigjuan në mënyrë efektive nga gjykatat vendase

Gjykata vërejti se ishte në kompetencën e Gjykatës së Lartë për të trajtuar dhe korrigjuar efektet e parregullsive të lartpërmendura mbi të drejtën e kërkuesit për gjykim të drejtë. Në vendimin e saj të 24 majit 2018, në çështjen e z. Ástráðsson, Gjykata e Lartë kishte rikonfirmuar gjetjet e saj të mëparshme mbi shkeljet e kryera nga Ministria dhe Parlamenti. Megjithatë, ajo nuk kishte nxjerrë përfundimet e nevojshme dhe as nuk e kishte vlerësuar çështjen në përputhje me Konventën. Ky shqyrtim ishte kufizuar në konstatimin se emërimi i A.E. nuk kishte qenë “nul” sipas ligjit islandez dhe se pavarësisht të metave procedurale në lidhje me emërimin, kërkuesi kishte gëzuar të drejtën për një gjykim të drejtë përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshëme.

Përmbajtja e treguar nga Gjykata e Lartë në shqyrtimin e çështjes së kërkuesit – dhe dështimi i saj për të vendosur ekuilibrin e duhur ndërmjet, në veçanti, ruajtjes së parimit të sigurisë juridike nga njëra anë dhe respektimit të ligjit nga ana tjetër – nuk ishte specifik vetëm për faktet e çështjes, por kishte qenë praktikë e konsoliduar e asaj gjykate.

Në vlerësim të GJEDNJ kjo praktikë ka qenë problematike për dy arsye. Së pari, ajo minoi rolin e rëndësishëm të gjyqësorit në ruajtjen e kontroleve dhe balancave të qenësishme në ndarjen e pushteteve. Së dyti, duke pasur parasysh rëndësinë dhe implikimet e shkeljeve në fjalë, si dhe rolin thelbësisht të rëndësishëm të luajtur nga gjyqësori në një shoqëri demokratike të qeverisur nga shteti i së drejtës, efektet e shkeljeve të tilla mund të mos kufizohen tek kandidatët individualë të cilëve u është bërë padrejtësi, por prekin dhe publikun e gjerë.

Gjykata konstatoi se, në shqyrtimin e çështjes së kërkuarit Gjykata e Lartë nuk kishte marrë në konsideratë në mënyrën e duhur nëse ishte arritur mbrojtja e të drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj”.

Në përfundim, duke pasur parasysh testin me tre hapa, Gjykata vendosi se kërkuarit i ishte mohuar e drejta për një “gjykatë të krijuar me ligj” për shkak të pjesëmarrjes në proces të një gjyqtareje emërimi i të cilës kishte pasur parregullsi të rënda që kishin cenuar vetë thelbin e së drejtës në fjalë. Kështu kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve)

Gjykata vuri në dukje se, në përgjigje të pyetjejes nëse kërkuari do të kërkonte rihapjen e procedimit penal kundër tij në rast të konstatimit të shkeljes së nenit 6, përfaqësuesi i tij ishte përgjigjur negativisht. Pavarësisht se ai më pas kishte tentuar të tërhiqte atë deklaratë, ai nuk kishte dhënë arsyetim të mjaftueshëm për ndryshimin e pozicionit.

Më tej, Gjykata vlerësoi se, në përputhje me detyrimet e saj sipas nenit 46 të Konventës, i takonte Islandës të nxirrte përfundimet e nevojshme nga ky vendim dhe të merrte çdo masë të përgjithshme sipas nevojës për të zgjidhur problemet që kishin çuar në konstatimet e Gjykatës dhe për të parandaluar që të ndodhin shkelje të ngjashme në të ardhmen.

Neni 41

Gjykata, me shumicë, vendosi se konstatimi i një shkeljeje përbënte një kompensim të drejtë dhe të mjaftueshëm për dëmin jo-pasuror për z. Ástráðsson. Më tej, Gjykata vendosi unanimitisht se Islanda duhet t'i paguante atij 20,000 euro për kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

Kontekstualizimi i situatës në Shqipëri

Në 2014 në Shqipëri u krijua një komision parlamentar *ad hoc*, i cili do të ishte përgjegjës për reformimin e sektorit të drejtësisë. Komisioni miratoi një Raport Vlerësimi mbi gjendjen e sistemit të drejtësisë. Ky raport iu referua një sërë sondazheve publike dhe anketave të kryera midis 2009 dhe 2015, për përdoruesit e gjykatave, sipas të cilave kishte një perceptim të gjerë publik se sistemi i drejtësisë ishte i rrënuar nga korrupsioni, ndikimet nga jashtë, mungesa e praktikave transparente, proceset gjyqësore të gjata dhe mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Sipas opinionit publik, disa gjyqtarë dhe prokurorë duhej të paguanin mitë për t'u emëruar ose transferuar në pozicione të lira në kryeqytet, ose qytete të tjera të mëdha.

Niveli i ulët i profesionalizmit i treguar nga aktorët kryesorë të sistemit ishte i dukshëm, ashtu si edhe dështimi i sistemit të edukimit ligjor për të formuar ndërgjegjen qytetare mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore lidhur me rëndësinë e njohjes dhe respektimit të ligjit.

Raporti i Vlerësimit shërbeu si gur themeli për hartimin dhe miratimin e një strategjie për reformën në sistemin e drejtësisë (“Strategjia e Reformës”). Disa nga masat e propozuara në Strategjinë e Reformës synonin, ndër të tjera, (i) përmirësimin e sistemit në lidhje me identifikimin dhe verifikimin e pasurive të gjyqtarëve e prokurorëve, si edhe konfliktit të interesit, me qëllim identifikimin e rasteve të

përvetësimin të pasurive në mënyrë të paligjshme, (ii) përfshirjen e dispozitave ligjore që e bëjnë të detyrueshëm një verifikim të hollësishëm të pasurive të gjyqtarëve e prokurorëve, si edhe konfliktin të interesit përpara marrjes së detyrës nga ana e tyre, (iii) rritjen e transparencës për verifikimin e pasurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke mundësuar përfshirjen e palëve të tjera të interesuara (të tilla si publikut dhe shoqërisë civile) në sigurimin e informacionit, fakteve dhe të dhënave të tjera që do të lehtësonin verifikimin e tyre; dhe (iv) parashikimin me ligj të procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për mos deklaram, deklaram të vonuar ose deklaram jo të saktë të pasurive dhe konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës.

Në 2016 u miratuan amendamentet kushtetuese, të cilat ndryshonin një sërë aspektesh thelbësore të Kushtetutës së Shqipërisë, ndryshime këto që u shoqëruan me miratimin e një sërë ligjesh të tjera. Një prej këtyre ligjeve ishte dhe ligji “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, i quajtur ndryshe si Ligji i *Vetting*-ut.

Procesi i *Vetting*-ut, të cilit duhet t’i nënshtroheshin të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë do të kryhej nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në shkallën e parë dhe një Kolegji i Posaçëm i Apelit në apel. Ky rivlerësim do të mbështetej në tre kritere, përkatësisht: kontroll i aseteve të deklaruara, lidhja potenciale me krimin e organizuar dhe një vlerësim të aftësive profesionale. Të gjithë subjekteve të rivlerësimit, u kërkohej nga ligji të paraqisnin tre deklaratata të ndara, në lidhje me secilin kriter të rivlerësimit.

Duke marrë parasysh rëndësinë e reformës në drejtësi dhe ekzistencën e korrupsionit në gjyqësorin shqiptar, doktrina e hapësirës së vlerësimit lejon diskrecion nga Shtetet Palë në marrjen e masave të caktuara në lidhje me legjislacionin, administratën ose drejtësinë. Sidoqoftë, gjithmonë duhet të kihet parasysh se përmbushja e standardeve të gjyqimit të drejtë dhe nevoja për të luftuar korrupsionin në gjyqësor nuk bëjnë përjashtim në këtë aspekt.

XHOXHAI KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 15227/19)

9 shkurt 2021

FAKTET KRYESORE

Karriera gjyqësore e kërkueses filloi në mars 1995 kur ajo u emërua në pozicionin e gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vitin 2006, ndërsa vazhdonte të punonte si gjyqtare, kërkuesja u zgjodh anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, organi përgjegjës për emërimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve të gjykatave të rrethit dhe apelit, pozicion ku shërbeu për katër vjet. Më 25 maj 2010 ajo u emërua, për një mandat nëntëvjeçar pa të drejtë riemërimi, si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese.

Në përputhje me Ligjin për Deklarimin e Pasurive, kërkuesja kishte dorëzuar deklaratat vjetore të pasurisë në periudhën 2003–2016, ashtu sikurse partneri i saj, i cili ishte nëpunës civil.

Në zbatim të parashikimeve të Ligjit të *Vetting*-ut, kërkuesja dhe partneri i saj dorëzuan deklaratat e pasurisë. Ata paraqitën se gëzonin në bashkëpronësi tre pasuri: i) një apartament 101 m² blerë në 2005; ii) një apartament 59 m² blerë në 2010; dhe iii) një sipërfaqe toke

prej 221.9 m². Ata dhanë një përshkrim të detajuar të burimeve të të ardhurave. Kërkuesja deklaroi se zotëronte dy llogari bankare në SH.B.A të hapura në 2015 dhe 2016. Gjithashtu, ajo plotësoi dhe dorëzoi formularin për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.

Më 14 nëntor 2017, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) nisi një hetim të thelluar administrativ për tre deklaratimet e kërkueses, pasi kjo e fundit për shkak të postit si gjyqtare kushtetuese përfshihej në listën prioritare të personave, që duhet t'i nënshtroheshin *Vetting*-ut.

Gjatë periudhës 15 dhejtor 2017 deri më 5 mars 2018 KPK i drejtoi kërkueses një sërë pyetjesh në lidhje me mospërputhje mes deklaratave të pasurisë së saj me deklaratën e *Vetting*-ut për sqarim të mëtejshëm.

Më 19 mars 2018, KPK njoftoi kërkuesen për përfundimin e hetimit administrativ, duke theksuar se kishte mospërputhje të deklaratave vjetore të pasurisë me deklaratën e *Vetting*-ut në lidhje me pronat e paluajtshme në (bashkë)pronësi të saj dhe likuiditetet. Gjithashtu, KPK theksoi se sipas hetimit kërkuesja kishte mungesë të dokumentacionit shoqëruar në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e një prej apartamenteve, pasi burimet e ligjshme të deklaruara nuk e justifikonin blerjen. KPK u shpreh se ekzistonin paqartësi në lidhje me pjesën takuese të pronësisë së kërkueses mbi një tokë bujqësore. Kërkuesja paraqiti pranë KPK kundër argumentet e saj.

Pas zhvillimit të seancës dëgjimore më 23 prill 2018, KPK shpalli vendimin e shkarkimit të kërkueses nga detyra në 4 qershor 2018, duke nënvizuar se të ardhurat e kërkueses dhe partnerit të saj nuk justifikonin pasuritë në pronësi të tyre.

Më 19 qershor 2018, kërkuesja paraqiti ankim ndaj vendimit të KPK pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) duke pretenduar shkelje procedurale ose substanciale të ligjit; si dhe kundërshti të vendimit

të KPK. Në lidhje me argumentet mbi aspektet procedurale dhe substanciale të ligjit, kërkesja theksoi se KPK kishte pasur një rol aktiv duke kaluar rolin standard të një organi gjykues. Gjithashtu, ajo nënvizoi se ligji nuk i mundësonte asaj si subjekt rivlerësimi zbatimin e parimit të barazisë së armëve në gjykimin kundër saj.

Pasaktësi në mënyrën e vlerësimit të asetëve/deklaratës së pasurisë së kërkueses dhe partnerit të saj, duke zbatuar në mënyrë retroaktive seksionin 31 të ligjit të *Vetting*-ut. Gjithashtu, kërkesja deklaroi se KPK nuk vlerësoi deklarin e pasurisë së saj sipas kriterit dyfishi i shumës së burimeve të legjitimuara, pavarësisht se sipas saj gjendja e pasurisë nuk e kishte kaluar as 100% e burimeve të ligjshme. Më 24 tetor 2018, KPA vendosi të lerë në fuqi vendimin e instancës së parë të *Vetting*-ut sa i përket shkarkimit të kërkueses, duke qartësuar se procesi *Vetting*-ut ka një karakter administrativ dhe jo penal.

Më 16 korrik 2020, kërkesja njoftoi Gjykatën se ndaj njërit prej anëtarëve të trupës gjyqësore të KPA kishte nisur një hetim penal për shkak të fshehjes së informacioneve të rëndësishme gjatë kandidimit dhe zgjedhjes së tij si anëtar i KPA. Ky anëtar kishte qenë pjesë e panelit të KPA, i cili kishte lënë në fuqi vendimin e KPK-së. Ndërkohë, më 1 dhjetor 2020 Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar shpalli fajtor anëtarin në fjalë të KPA dhe e dënoi atë me 6 muaj heqje lirie të konvertuara në një vit shërbim prove.

VENDIMI I GJYKATËS

Kërkesja u ankua për shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me pavarësinë dhe paanësinë e organeve të *Vetting*-ut. Kërkesja e legjitimonte këtë pretendim për shkelje në bazë të argumenteve të mëposhtme: i) organet e *Vetting*-ut përbëheshin nga anëtarë jo-gjyqtarë, të cilët kishin mungesë eksperience dhe profesionalizmi; ii) ata zgjidheshin nga parlamenti pa asnjë eksperiencë të mëparshme në lidhje me gjyqësorin; iii) ndërmorën një hetim administrativ paraprak, formuluan

akuzën kundër kërkueses dhe më pas vendosën mbi themelin e akuzës. Gjithashtu, kërkuesja u ankua se organet e *Vetting*-ut i kishin mohuar të drejtën për të kundërshtuar arsyet e shkarkimit dhe mbrojtur veten; KPK i kishte kaluar një barrë prove jo proporcionale për rrethana të ndodhura dekada më parë; ligji i *Vetting*-ut nuk vendoste kufizime kohore; vendimi i shkarkimit të saj kishte mungesë argumentimi, sa i takon mbrojtjes që ajo kishte bërë, organet e *Vetting*-ut kishin mbajtur standard të dyfishtë krahasuar me çështjet e tjera; KPA nuk i kishte dhënë të drejtë kërkueses të paraqiste prova të tjera dhe nuk zhvilloi një seancë publike; organet e *Vetting*-ut shkelën parimin e sigurisë juridike pasi nuk kishin marrë në konsideratë auditin e kryer nga ILDKPI disa vite më herët.

Kërkuesja u ankua dhe për shkelje të nenit 8 të Konventës, me argumentin se shkarkimi i saj i paligjshëm dhe arbitrar, si dhe ndalimi për të ushtruar profesionin shkelnin të drejtën e saj për të qetë private.

Neni 6

Pranueshmëria

i. Zbatueshmëria e nenit 6 § 1 aspekti civil

Gjykata theksoi se mosmarrëveshjet në lidhje me marrëdhënien juridike të punës midis nëpunësve civilë dhe shtetit mund të mos përfshihen gjithmonë brenda aspektit civil të nenit 6 § 1 të Konventës, me kusht që të plotësohen dy kushte kumulative. Në radhë të parë, shteti duhet ta ketë përjashtuar shprehimisht qasjen në gjykatë të funksionarit ose kategorisë së personelit përkatës. Së dyti, përjashtimi duhet të justifikohet për arsye objektive në interes të Shtetit.

Megjithëse gjyqësori nuk është pjesë e shërbimit civil të zakonshëm, ai është pjesë e shërbimeve publike. Prandaj, neni 6 § 1 është zbatuar për procedura shkarkimi të gjyqtarëve kryesisht për faktin se gjyqtarët

kanë akses në gjykatat vendase për të kundërshtuar vendimin e shkarkimit të tyre. Kështu, Gjykata vërehu se ligji i brendshëm e lejonte kërkuesen të apelonte vendimin kundër saj.

Gjykata vërejtë se i takonte të përcaktonte nëse KPK dhe KPA mund të konsideroheshin si “gjykata të krijuara me ligj”, prandaj vendosi se çështjen e zbatueshmërisë ose jo të aspektit civil të nenit 6 § 1 do ta shqyrtonte së bashku me themelin e ankimit të kërkueses.

ii. Zbatueshmëria e nenit 6 § 1 aspekti civil

Gjykata theksoi se të dy aspektet e nenit 6 § 1 nuk janë domosdoshmërisht përjashtuese me njëra-tjetrën. Koncepti i një “akuze penale” në nenin 6 § 1 është një koncept autonom. Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës përcakton tre kritere për të vlerësuar nëse një akuzë është penale apo jo, të njohura zakonisht si “kriteret e Engel”. Kriteri i parë është klasifikimi ligjor i veprës penale sipas ligjit kombëtar, i dyti është vetë natyra e veprës penale dhe i treti është shkalla e ashpërsisë së dënimit që personi në fjalë rrezikon të marrë. Kriteri i dytë dhe i tretë janë alternative me njëri-tjetrin. Megjithatë, ky fakt nuk përjashton një qasje kumulative ku analiza e veçantë e secilit kriter nuk bën të mundur arritjen e një përfundimi të qartë për ekzistencën e një akuze penale.

Në lidhje me kriterin e parë Engel, përkatësisht klasifikimin sipas legjislacionit të brendshëm të veprës, Gjykata vërejtë se procedurat e *Vetting*-ut kundër kërkueses, të cilat kishin pasur një natyrë disiplinore, bazoheshin në Ligjin e *Vetting*-ut, rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative, Ligjin për organizimin e Gjykatave Administrative ose Kodin e Procedurës Civile. Asnjëherë nuk është bërë referencë apo përmendje e zbatimit ose interpretimit të ligjit penal ose ligjit të procedurës penale. Procedurat e verifikimit u zhvilluan nga një organ i krijuar posaçërisht, KPK, duke iu nënshtruar një ankese të mëvonshme në Kolegjin e Apelit. Autoritetet e ndjekjes

penale dhe gjykatat penale nuk ishin të përfshira në përcaktimin e vendimmarrjes së tyre. Për më tepër, Gjykata vërejti se neni Ç § 5 i Aneksit të Kushtetutës parashikon vetëm një zhvendosje të barrës së provës në procedurat e verifikimit, duke u përjashtuar shprehimisht aspekte penale dhe neni DH § 2 i Aneksit të Kushtetutës ndalon në mënyrë të qartë përdorimin e deklaratave të integritetit në çdo proces penal. Për këto arsye, Gjykata vendosi se nuk mund të pranojë argumentin e kërkueses se pozicioni i saj kishte qenë si ai i një të akuzuari në një proces ose se kompetencat e KPK ishin të ngjashme me ato të një prokurori publik.

Sa i përket kriterit të dytë - vetë natyra e veprës - Gjykata vërejti se dispozitat ligjore të zbatueshme kishin për qëllim vetëm një kategori të caktuar profesionistësh, domethënë gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë dhe jo publikun në përgjithësi. Dispozitat u krijuan për të mbrojtur sjelljen, nderin dhe reputacionin e profesioneve dhe për të ruajtur besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Ato ishin thjesht të një natyre disiplinore dhe nuk ishin të veshura me elementë të natyrës penale.

Gjykata theksoi se fakti, që kërkuësja mund të jetë subjekt i proceseve penale në të ardhmen për shkak të zbulimit të rremë të pasurive nuk mjafton për ta kategorizuar procesin e verifikimit si një proces me natyrë penale. Fakti që një veprim i cili mund të çojë në një sanksion disiplinor, gjithashtu përbën një vepër penale nuk është i mjaftueshëm për të konsideruar një person përgjegjës sipas ligjit me natyrë disiplinore si të “akuzuar” për një krim do të ishte vetëm në kontekstin e ndonjë procedure të veçantë penale të së ardhmes, e cila mund të ngrihet kundër kërkueses, që neni 6 § 1 të mund të gjejë zbatim në aspektin penal.

Në lidhje me kriterin e tretë - se shkalla e ashpërsisë së dënimit - Gjykata vërejti se shkarkimi i kërkuetit është një sanksion karakteristik i një procesi disiplinor dhe nuk mund të ngatërrohet me një dënim penal.

Ndaj kërkueses nuk u vendos asnjë gjobë. Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ndalon subjektet e shkarkuar nga detyra të rikthehen në sistemin e drejtësisë. Ky kufizim nuk është përcaktuar në ligjin penal. Nuk mund të konsiderohet një sanksion me natyrë penale.

Qëllimi i ndalimit të përfshirjes sërish në sistemin e drejtësisë të funksionarëve të shkarkuar nga detyra, ka më tepër qëllim sigurimin dhe ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Fakti i thjeshtë që ndalimi është i një natyre të përhershme nuk mjafton ta konsiderojmë atë si një ndëshkim. I njëjti konstatim do të zbatohet gjithashtu për çdo pretendim tjetër si p.sh. kërkuesja nuk ka të drejtë të përfshihet me shërbimin civil, një pretendim spekulativ, të cilin ajo nuk e ka kundërshtuar para gjykatave vendase.

Në këto rrethana, Gjykata vlerësoi se, elementet e mësipërme, të marra në mënyrë alternative ose kumulative, janë të pamjaftueshme për të arritur në një përfundim se neni 6 është i zbatueshëm nën aspektin penal. Kështu neni 6 do të zbatohet në këtë çështje në aspektin e tij civil.

iii. Shterimi i mjeteve të brendshme të ankimit

Gjykata vërejti se qëllimi i kriterit të shterimit të mjeteve të brendshme të ankimit është t'i japë mundësi Shtetit Palë të adresojë dhe parandalojë ose rivendosi në vend një shkelje të pretenduar të Konventës prej tij. Është e vërtetë, që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës nuk është gjithmonë e nevojshme që Konventa të përmendet qartë në proceset e brendshme me kusht që ankimi të ngrihet “të paktën në përmbajtje”. Kjo do të thotë që kërkuesi duhet të ngrejë argumente ligjore me të njëjtin efekt ose të ngjashëm në bazë të ligjit të brendshëm, në mënyrë që t'u japë gjykatave vendase mundësinë për të korrigjuar shkeljen e pretenduar. Sidoqoftë, siç shpjegon praktika

gjqësore e Gjykatës, për t'i dhënë vërtet një Shteti Kontraktues mundësinë e parandalimit ose korrigjimit të shkeljes së pretenduar kërkohen të merren parasysh jo vetëm faktet, por edhe argumentet ligjore të kërkuesit, për qëllimet e përcaktimit nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë me të vërtetë ishte ngritur paraprakisht, në thelb, para autoriteteve vendase.

Gjykata vërejti se kërkuesja kishte bërë ankim për vendimin e shkarkimit të saj dhënë nga KPK. Pretendimi i cenimit të paanshmërisë së Komisionit konsiderohet se është ngritur në nivel të brendshëm së paku në themel, duke respektuar kështu kriterin e shterimit të mjeteve të brendshme të ankimit.

iv. Zbatueshmëria e kriterit 6 mujor

Në prezantimin e argumenteve të saj me shkrim në lidhje me pranueshmërinë dhe themelin kërkuesja paraqiti në 10 janar 2020 disa pretendime të tjera bazuar në informacione mbi të cilat kish marrë dijeni vetëm pas paraqitjes së çështjes në GJEDNJ. Konkretisht, ajo parashtrroi se 3 anëtarë të Kolegjit të Apelit ishin përzgjedhur si përfaqësues të institucioneve të *Vetting*-ut në shkelje të kritereve formale të vendosura nga ligji për përzgjedhje. Gjithashtu, një anëtar tjetër i KPA nuk kishte deklaruar konfliktin e interesit me kërkuesen pasi një anëtar i ngushtë i familjes ishte dënuar me një vendim të dhënë nga babai i kërkueses kur kishte qenë gjyqtar.

Megjithatë, Gjykata nuk u shpreh e bindur se kërkuesja nuk kish pasur ose nuk mund të kish pasur informacion mbi këto pretendime paraprakisht. Për rrjedhojë Gjykata rrëzoi pretendimet shtesë.

Themeli

Nëse organet e Vetting-ut përbëjnë “një gjykatë të krijuar me ligj”

Gjykata nënvizoi se organet e *Vetting*-ut ishin krijuar me ndryshimet kushtetuese të 2016 dhe ishin votuar nga Parlamenti shqiptar. Për më tepër roli i tyre ishte nënvizuar dhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese shqiptare. Kështu, Gjykata vlerësoi se për qëllime të nenit 6 § 1, një gjykatë nuk duhet të jetë patjetër një institucion pjesë e makinerisë gjyqësore, por mund të krijohet dhe për qëllime të një tipologjie çështjesh specifike të cilat mund të administrohen në mënyrë të duhur edhe jashtë sistemit gjyqësor të zakonshëm.

Gjykata vërejt se KPK dhe KPA zhvillojnë shqyrtimin e faktit dhe ligjit. Ndërkohë, panelet/komisionet gjykuese janë përcaktuar në bazë të ligjit me short. Të dy shkallët e *Vetting*-ut në zbatim të ligjit zbatuan funksionet e tyre në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

Në referim të argumentimit të mësipërm Gjykata vlerësoi se KPK dhe KPA përmbushnin të gjithë kriteret e “një gjykate të krijuar me ligj” dhe kërkuesja kishte pasur mundësi ta aksesonte “gjykatën” në kuptim të kriterit të parë të testit “*Vilho Eskelinen*”. Kështu, Gjykata vendosi se neni 6 § 1 i Konventës do të zbatohet në aspektin civil.

Nëse organet kishin qenë të pavarura dhe të paanshme

Gjykata vërejt se termi “i pavarur” i referohet *vis-à-vis* pushteteve të tjera dhe *vis-à-vis* palëve të tjera. Me qëllim që të përcaktohet nëse një gjykatë është e “pavarur” për qëllime të nenit 6 duhet të merret në konsideratë *inter alia* mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të saj, mandate, garancitë kundër ndikimeve të jashtme dhe nëse organi në fjalë shfaq një sjellje të pavarur.

Gjykata theksoi se ekziston një korrelacion të ngushtë mes një gjykate “të pavarur dhe të paanshme” dhe “një gjykate të krijuar me ligj”. Besimi i qytetarëve tek sistemi i drejtësisë dhe ruajtja e pavarësisë së këtij sistemi *vis-à-vis* pushteteve të tjera thekson secilën prej këtyre kërkesave. Pra, “pavarësia” i referohet pavarësisë së nevojshme personale dhe institucionale, që lidhet me vendimmarrje të paanshme. Përfshin si gjendjen subjektive të gjyqtarit/es, ashtu edhe rregullimet institucionale që garantojnë pavarësinë e tij/saj.

Gjykata vërejtí më tej se paanësia lidhet me mungesën e paragjykimit në vendimmarrje në lidhje me çështje specifike. Në referim të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës, paanësia në kuptim të nenit 6 § 1 duhet të përcaktohet sipas i) testit subjekti – ku rëndësi i jepet lidhjeve personale ose sjelljes së gjyqtarit/gjyqtares; ii) testi objektiv – ku shqyrtohet nëse gjykata veçanërisht përbërja e saj ka ofruar mjaftueshmërisht garanci paanshmërie. Në këtë kuadër ka rëndësi jo vetëm krijimi i panelit, por dhe sjellja e gjyqtarëve. Me fjalë të tjera, drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por edhe duhet të duket, që po bëhet.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Gjykata parimisht nuk ka arsye të vendos në pikëpyetje mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së, ajo do të shqyrtojë për qëllim të çështjes konkrete objekt gjykimi nëse KPK posedonte “pavarësinë në dukje” kërkuar nga kriteret e jurisprudencës së konsoliduar e gjykatës në lidhje me presionet e jashtme.

Sipas Gjykatës, kërkesja nuk arriti të provonte se paneli i komisionerëve të KPK, që shqyrtoi çështjen e saj kishte qenë subjekt i ndonjë presioni nga ekzekutivi. Deklarata e Kryeministrit të vendit mbi ecurinë e rezultateve të procesit të *Vetting*-ut *bërë një natë përpara dhënies së vendimit për shkarkimin e kërkueses nga KPK, kishte pasur*

vetëm një natyrë të përgjithshme dhe nuk mund të konsiderohet se kish cenuar vendimmarrjen e KPK.

Mandati i caktuar pa të drejtë ri-emërimi i komisionerëve të KPK dhe kohëzgjatja 5-vjeçare e këtij mandati, pavarësisht se e shkurtër, është e kuptueshme në kuadër të natyrës së veçantë të procesit të *Vetting*-ut. Gjykata theksoi se ajo çka ka rëndësi në rastin në fjalë është mos-lëvizshmëria e komisionerëve nga posti i tyre, fakt ky thelbësor i lidhur me pavarësinë e tyre.

Ndërkohë, sa i takon hetimit disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga institucione që kanë në mënyrë substanciale përbërje gjyqësore, Gjykata theksoi se rasti i *Vetting*-ut në *Shqipëri* ka një natyrë të posaçme/veçantë e parashikuar në mënyrë të tillë nga nevoja urgjente për të luftuar korrupsionin në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor. Në procesin e rivlerësimit do të kalojnë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë. Ndaj për këtë arsye procesi i *Vetting*-ut në *Shqipëri* ka një natyrë sui generis dhe duhet të dallohet nga çdo lloj hetimi tjetër disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Sipas Gjykatës, fakti se anëtarët e KPK nuk vinin nga gjyqësori përputhet drejtpërdrejtë me shpirtin e reformës, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit dhe garantimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Gjykata risolli në vëmendje dhe kriteret strikte në përzgjedhjen e anëtarëve të KPK-së dhe votimit të tyre nga Parlamenti në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji. Për më tepër komisionerët e KPK kanë të njëjtin status me gjyqtarët e Gjykatës Supreme.

Fakti se ekzekutivi i dha një rrogë bonus në fundin e vitit 2018 komisionerëve të KPK-së nuk mund të jetë e mjaftueshme për të konsideruar se ky veprim ka ndikuar në pavarësinë e tyre.

Gjykata theksoi gjithashtu se KPK gëzon një diskrecion tërësor në vendosjen e strukturës së saj organizative dhe nuk merr asnjë instruksion nga ekzekutivi.

Në referim të sa më sipër, Gjykata vendosi se nuk shihte asnjë problem në lidhje me pavarësinë ose më qartë, mungesën e pavarësisë së KPK.

Sa i takon paanësisë, Gjykata vendosi të shqyrtojë aspektin objektiv pasi kërkuesja nuk u ankua për aspektin subjektiv. Gjykata theksoi se do të shqyrtojë nëse ankimi i kërkueses për anësi të KPK mund të justifikohet në mënyrë objektive në këtë çështje.

Gjykata vërejti se nuk kishte ngatërrim në funksionet e KPK - ekzistonte një detyrim ligjor për të hapur hetimin administrativ ndaj kërkueses, i cili nuk varej nga sjellja e KPK-së ndaj kërkueses, gjetjet paraprake të Komisionit ishin bazuar në informacion në dispozicion, pa marrë në konsideratë mbrojtjen e kërkueses. Ndërkohë, vendimi u mor pasi kërkuesja kishte paraqitur argumentet e saj, duke përfshirë të gjithë parashtrimet në dispozicion, si dhe provat e e argumentet e kërkueses gjatë seancës publike.

Gjykata vërejti se thjeshtë fakti se KPK kishte paraqitur gjetjet paraprake në lidhje me çështjen e kërkueses nuk ishte argument i mjaftueshëm për të nxitur frikën e justifikuar objektivisht për sa i përket paanësisë së Komisionit.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit

Gjykata nënvizoi se kërkuesja nuk kishte arritur të paraqiste ndonjë argument të vlefshëm për të shqyrtuar themelin e pretendimit. Gjithashtu, Gjykata nënvizoi se KPA kishte juridiksion të plotë në shqyrtimin e ankimit të kërkueses dhe dha një vendim të hollësishëm për çështjen në fjalë.

Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me pretendimin e mungesës së pavarësisë dhe paanësia e organeve të *Vetting*-ut.

iii. Pajtueshmëria me kërkesat e procesit të rregullt

Gjykata përsëriti se nuk ishte detyra e saj të zinte vendin e gjykatave vendase. Është detyrë e autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, për të zgjidhur problemet e interpretimit të legjislacionit vendas dhe vlerësimin e provave në kuadër të këtij interpretimi.

Së pari, Gjykata vuri në dukje se fillimi i hetimit nga KPK kishte filluar në përputhje me ligjin. Kërkuesja i ishte njohur me gjetjet paraprake. Rezultatet e hetimit duhet t'i kishin mundësuar kërkueses të kuptonte seriozitetin e gjetjeve paraprake dhe për të përgatitur mbrojtjen e saj. Kërkuesja, e cila ishte përfaqësuar nga një avokat të zgjedhur prej saj, kishte paraqitur argumente të gjera dhe vëzhgime. Nuk kishte asnjë tregues se asaj i kishte munguar koha për të përgatitur një mbrojtje adekuate.

Akuza e kërkueses se KPK kishte fshehur prova ishte, për Gjykatën, e pabazuar nga çdo provë paraqitur në dosjen e çështjes objekt gjykimi dhe mund të konsiderohej “thjesht hamendje”. KPK kishte juridiksion të plotë mbi të gjithë çështjet e faktit dhe të ligjit, si dhe kishte dhënë një vendim duke deklaruar arsyet specifike në përgjigje të argumenteve kryesore të kërkueses.

Së fundmi, Gjykata vendosi që KPA kishte pohuar juridiksionin e plotë në procesin përpara tij, në përputhje me ligjin dhe kishte shqyrtuar secilën nga ankimet e kërkueses, përfshirë refuzimin për të pranuar prova të reja, duke dhënë arsye të mjaftueshme për vendimin e tij. Prandaj, Gjykata nuk gjeti asnjë shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me pretendimin e shkeljes së procesit të rregullt.

3. Kërkesa për një dëgjese publike përpara KPA

Gjykata përsëriti se kishte vendosur që e drejta për një seancë dëgjimore publike nënkuptonte të drejtën për t' u dëgjuar verbalisht së paku një instancë. Për më tepër, Gjykata deklaroi se proceset disiplinore ndaj gjyqtarëve mund të zhvillohen përjashtimisht pa seanca dëgjimore.

Gjykata vërejti se kishte pasur një seancë dëgjimore publike përpara KPK, organ i cili u konsiderua i pavarur dhe i paanshëm, si dhe se kërkuesja nuk kishte kërkuar një seancë publike para KPA. Megjithatë, instanca e apelit kishte paraqitur arsye të përshtatshme për të mos mbajtur një seancë dëgjimore publike.

Në funksion të natyrës së procesit në apel, gjatë së cilës kërkuesja kishte pasur mundësi të mjaftueshme për të paraqitur argumente me shkrim dhe nuk kishte pasur nevojë për të dëgjuar dëshmitarë ose për të marrë prova të tjera, mbajtja e një seance publike nuk ishte kërkuar në mënyrë rigoroze.

Prandaj, Gjykata vërejti asnjë shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me pretendimin e mungesës së një seance dëgjimore përpara KPA.

4. Pajtueshmëria me parimin e sigurisë juridike

Gjykata përsëriti se afatet e parashkrimit janë të rëndësishme për të siguruar parimin e sigurisë juridike. Sidoqoftë, Gjykata deklaroi se auditimi i pasurive, si një masë anti-korrupsion, paraqiti karakteristika të veçanta dhe të dhëna në lidhje me pasuritë, që ishin grumbulluar gjatë gjithë jetës së subjekteve të rivlerësimit.

Gjykata vërejti se gjetjet kontradiktore kundër kërkueses ishin evidentuar në deklaratimet e bëra në formularin e deklaratimit *Vetting*-ut dhe deklaratimeve të mëparshme bëra gjatë viteve.

Fakti që kërkuesja ishte vendosur në një pozicion disi të vështirë për të justifikuar natyrën e ligjshme të burimeve të saj financiare, të cilat kishin shërbyer si bazë për blerjen e pronave, kishte ndodhur pjesërisht për shkak të mos deklarimit të pronave në kohën e blerjes.

Për më tepër, kërkuesja nuk kishte siguruar ndonjë dokument mbështetës që justifikonte ekzistencën enjë pamundësie objektive për të treguar natyrën e ligjshme të burimeve financiare, e cila ishte një rrethanë zbutëse e parashikuar në ligjin e *Vetting*-ut. Kalimi i barrës së provës së kaluar mbi kërkuesen pas prezantimit të gjetjeve paraprahe nuk ishte arbitrare *per se*. Në përfundim, Gjykata vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me pretendimin e cenimit të sigurisë juridike.

Neni 8

Gjykata deklaroi se largimi nga detyra përbënte ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për të gëzuar një jetë të qetë private, por kjo ndërhyrje ishte bërë në zbatim të ligjit të brendshëm dhe ishte ndjekur nga një qëllim legjitim në përputhje me Konventën.

Shkarkimi nga detyra është ndoshta sanksioni më i madh disiplinor, që mund të pësojë një individ dhe kërkon kështu një argumentim dhe fakte solide në lidhje me shkelje profesionale ose etike.

Në vlerësimin e domosdoshmërisë së ndërmarrjes së këtij veprimi, Gjykata vuri në dukje “nevojën e ngutshme shoqërore” në Shqipëri për të reformuar sistemin e drejtësisë për shkak të niveleve alarmante të korrupsionit në gjyqësor.

Në vlerësimin nëse arsyet e paraqitura nga organet e *Vetting*-ut kishin qenë “të rëndësishme dhe të mjaftueshme”, Gjykata shqyrtoi arsyet, që kishin çuar në shkarkimin e kërkueses ishin posaçërisht vlerësimi i pasurive dhe kompetenca profesionale.

Për sa i përket vlerësimit të pasurive, Gjykata vuri në dukje se kërkueses iu kërkua të justifikonte të ardhurat e ligjshme për blerjen e pasurive të saj. Gjykata nuk vërejti ndonjë vendim arbitrar ose qartazi të paarsyeshëm në vendimet e brendshme përkatëse për sa i përket përfundimit se ankuesja kishte qenë palë në blerjen e banesës me sipërfaqe 101 m², cilën ajo se kishte deklaruar për disa vjet.

Gjykata iu referua parimeve ndërkombëtare, të cilat kërkojnë që gjyqtarët të përmbushnin standarde veçanërisht të larta integriteti në lidhje çështjet e jetës së tyre private jashtë gjykatës, në mënyrë që të ruhet dhe rritet besimi i publikut, si dhe të riafirmohet besimi në integritetin e gjyqësorit.

Gjykata gjithashtu vuri në dukje gjetjet e organeve të *Vetting*-ut në lidhje me faktin se kërkuesja nuk kishte poseduar të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar asete likuide në vite të caktuara, se ajo kishte dështuar të zbulonte origjinën e parave në llogaritë e saj në bankat e huaja dhe se partneri i saj nuk kishte arritur të justifikonte një sasi e madhe parash, ishin në kundërshtim me ligjin përkatës.

Për sa i përket vlerësimit të kompetencës profesionale, Gjykata vlerësoi se duke marrë parasysh rrethanat e çështjes në fjalë, organet e *Vetting*-ut nuk kishin dhënë arsye të përshtatshme për të justifikuar në mënyrë të arsyeshme gjetjen e cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë për shkak të pretendimit se kërkuesja nuk ishte tërhequr nga një proces kushtetues.

Për më tepër, Gjykata, përsëriti që skualifikimi automatik i një gjyqtari, që kishte lidhje gjaku me një gjyqtar tjetër i cili kishte qenë pjesë e trupës gjyqësore në një proces tjetër në lidhje me një ose të gjithë palët në proces nuk kërkohet gjithmonë, veçanërisht për një vend me madhësinë e Shqipërisë, si shkelje.

Pavarësisht kësaj, Gjykata vlerësoi se gjetjet e bëra në lidhje me vlerësimin e pasurive ishin mjaftueshmërisht serioze sipas legjislacionit kombëtar për të justifikuar shkarkimin nga detyra.

Gjykata vlerësoi duke iu referuar gjetjeve të organeve të *Vetting*-ut, se shkarkimi i kërkueses kishte qenë proporcional. Ekzistenca e një shkalle sanksioni në ligjin e *Vetting*-ut ka qenë konsistente me frymën e procesit, i cili është unik në llojin e tij dhe synon pastrimin e sistemit të drejtësisë nga elementët e korruptuar. Për më tepër Gjykata vërejti se ndalimi i përhershëm për tu përfshirë në sistemin gjyqësor për shkak të shkeljeve të rënda etike ka qenë konsistent me qëllim sigurimin e integritetit të pushtetit gjyqësor dhe rikthimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Ky ndalim është i justifikuar në vështrim të kontekstit vendas dhe konsolidimit të vazhdueshëm të shtetit të së drejtës. Për rrjedhojë, nuk ka pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës.

Gjykata ka theksuar dhe më parë se në të gjithë Konventën është i natyrshëm kërkimi i një ekuilibri të drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit¹. Në këtë rast, duke marrë parasysh rëndësinë e reformës në drejtësi dhe ekzistencën e korrupsionit në gjyqësorin shqiptar, *doktrina e hapësirës së vlerësimit* lejon diskrecion nga Shtetet Palë në marrjen e masave të caktuara në lidhje me legjislacionin, administratën ose drejtësinë². Sidoqoftë, gjithmonë duhet të kihet parasysh se përmbushja e standardeve të gjykimit të drejtë dhe nevoja për të luftuar korrupsionin në gjyqësor nuk bëjnë përjashtim në këtë aspekt.

1 Shih *Soering v. UK*, A 161 (1989); 11 EHRR 439 para 89 PC.

2 Harris, O'Boyle & Warbrik. (2014). *The law of the European Convention of Human Rights*. Oxford University Press, p. 14.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë thelbësore të procesit të vetingut për reformën në drejtësi dhe impakti që ky sistem mund të ketë për vende të tjera të cilat dëshirojnë të reformojnë sistemin e drejtësisë, heqja dorë nga juridiksioni i Dhomës së Gjykatës në favor të Dhomës së Madhe, në zbatim të nenit 30 të Konventës dhe Rregullit 72 të Rregullores së Gjykatës ndoshta do të kishte qenë një opsion më i mirë. Gjithsesi, neni 30 i Konventës lejon Dhomën e Madhe të shqyrtojë dhe ankimet potenciale të shtetit të paditur për mungesë juridiksioni³.

3 Shih *Scoppola v. Italy* (No. 2) no. 10249/03, § 59, 17 shtator 2009.

Gjykata Evropiane vendosi për rihapjen e proceseve që lidhen me shkarkimin e prokurorit shqiptar

BESNIK CANI KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 37474/20)

4 tetor 2022

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi, Besnik Cani, është shtetas shqiptar i lindur në vitin 1970 dhe jeton në Tiranë (Shqipëri). Ai është ish-prokuror, i cili u shkarkua në vitin 2020 pas procesit të vettingut. Për shkak të perceptimit të qytetarëve lidhur me fenomenin e korrupsionit, Shqipëria në vitin 2016 kishte nisur një reformë të gjerë të reformimit të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë rivlerësimin kalimtar të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në vitin 2003, z. Cani u emërua në postin e prokurorit.

Në vitin 2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK”), e konfirmoi në shkallë parë. Megjithatë, në shkurt 2020 Kolegji i Posaçëm i Apelimeve (“KPA”) e ndryshoi vendimin e KPK-së dhe vendosi shkarkimin e z. Cani me efekt të menjëhershëm.

KPA konstatoi se z. Cani kishte bërë deklarime të pasakta mbi pasuritë e tij dhe të afërmeve të tij dhe se ai ishte përfshirë në një konflikt interesi duke lidhur një marrëveshje tregtare me një kompani hidrokarburesh. Z. Cani parashtrroi mocion për përjashtimin e një prej pesë gjyqtarëve, konkretisht L.D., i cili ishte pjesë e trupit gjykues të KPA. Ai pretendoi se L.D. ishte emëruar në KPA, pavarësisht faktit se në vitin 1997 ishte shkarkuar nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shkelje të ligjit dhe paaftësisë

profesionale në kundërshtim me kërkesat ligjore të kualifikimit për këtë trup gjykues.

KPA, dhe më pas Gjykata Kushtetuese, nuk e morën në shqyrtim ankimin e z. Cani kundër emërimit të gjyqtarit L.D. me arsyetimin se nuk kishin juridiksion për çështjen. Në pritje të procesit të vettingut, Z. Cani kishte bërë kallëzim penal kundër L.D., me pretendimin se ai kishte kryer falsifikim të dokumentacionit duke deklaruar në kërkesën e tij në KLSH se nuk ishte shkarkuar asnjëherë nga asnjë detyrë si punonjës i gjykatës. Gjykatat vendase konstatuan L.D. fajtor dhe e dënuan atë me gjashtë muaj liri me kusht.

Ata konkluduan, se një shkarkim i mëparshëm e skualifikonte një kandidat nga mbajtja e posteve të caktuara brenda sistemit ligjor dhe se, në kundërshtim me argumentin e L.D., masat disiplinore për shkelje të rënda nuk parashkruhen në rastin e heqjes së gjyqtarëve. Në tetor 2021, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimet e gjykatave më të ulëta, dhe përmes një komisioni disiplinor z. L.D. u shkarkua nga pozicioni i gjyqtarit të KPA.

Duke u mbështetur veçanërisht në nenin 6 (e drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ, z. Cani pretendoi se gjyqtari L.D., duhet të ishte përjashtuar nga KPA, sepse ai ishte shkarkuar më parë si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

VENDIMI I GJYKATËS

Neni 6 § 1

Veçanërisht, kërkuesi argumentoi se KPA, e cila kishte verifikuar dhe shkarkuar atë, nuk ishte një “gjykatë e krijuar me ligj” sepse një nga gjyqtarët e trupit gjykues, L.D., ishte emëruar në kundërshtim me kërkesat statutores të pranueshmërisë, pasi ai ishte shkarkuar më parë

si gjyqtar i gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë. Qeveria e kundërshtoi këtë argument, duke pretenduar se autoritetet – Parlamenti – nuk mund të kritikoheshin për emërimin e L.D., në KPA pasi nuk kishin dijeni për shkarkimin e tij të mëparshëm.

Nga ana tjetër, Gjykata konstatoi se u takonte autoriteteve vendase të kishin përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, duke përfshirë kontrollin e aplikimit të L.D., për të siguruar që gjyqtarët e emëruar në KPA të përmbushnin kërkesat ligjore për këtë pozicion. Një verifikim i tillë nuk do të kishte qenë i vështirë pasi: shkarkimi i L.D.-së kishte qenë një çështje zyrtare dhe faktikisht një anëtar i komisionit parlamentar *ad hoc* e kishte pyetur në mënyrë specifike gjyqtarin gjatë intervistës së tij të KPA-së nëse ai ishte shkarkuar apo dhënë dorëheqjen si gjyqtar i gjykatës së rrethit gjyqësor në vitin 1997.

Prandaj, Gjykata konstatoi se kërkuesi kishte paraqitur një pretendim serioz dhe të argumentuar për shkelje të hapur të ligjit të brendshëm në emërimin e L.D. në KPA. Për më tepër, ajo konsideroi se pyetja nëse L.D. kishte qenë i aftë për këtë detyrë kishte të bënte me një rregull themelor në lidhje me emërimin e një gjyqtari. Për më tepër, asnjë autoritet vendas nuk e kishte shqyrtuar, apo korrigjuar, çështjen nëse L.D. ishte emëruar në KPA në përputhje me legjislacionin e brendshëm. L.D., pas dënimit të tij penal, pa dyshim që ishte pushuar nga puna, por kjo kishte ardhur vetëm pasi vetë kërkuesi ishte shkarkuar me një vendim të formës së prerë dhe të paapelueshëm nga KPA. Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të së drejtës së z. Cani për “një gjykatë të krijuar me ligj” sipas nenit 6 § 1 për faktin se L.D., ishte pjesë e trupit gjykues që kishte shqyrtuar çështjen e tij. Nisur nga ky konstatim, Gjykata vendosi, se nuk kishte nevojë të shqyrtonte kërkesat e tjera sipas neneve 6 § 1 dhe 8 të Konventës.

Neni 41

Gjykata hodhi poshtë, njëzëri, kërkesën e kërkuarit për kompensim të drejtë në lidhje me dëmin material dhe u shpreh, se konstatimi i shkeljes përbënte një kompensim të drejtë dhe të mjaftueshëm në lidhje me çdo dëm jo-material.

Neni 46

Gjykata vuri në dukje se procedurat e vettingut kishin pasur pasoja të rënda për z. Cani pasi ai ishte shkarkuar menjëherë nga detyra dhe i ndalohej përgjithmonë rikthimi në pozicionin e prokurorit ose gjyqtarit. Gjykata, konsideroi se forma më e përshtatshme e dëmshpërblimit për shkeljen e të drejtës së kërkuarit për një “gjykatë të themeluar me ligj” do të ishte rihapja e këtyre procedurave dhe rishqyrtimi i çështjes në përputhje me kërkesat e nenit 6 § 1 të Konventës.

Megjithatë, konstatimi i një shkeljeje në vetvete nuk mund të konsiderohet se kërkon rihapjen e të gjitha rasteve të ngjashme që ndërkohë janë bërë *res judicata* sipas ligjit të brendshëm. Së fundi, ajo hodhi poshtë kërkesën e z. Cani për të urdhëruar Qeverinë që ta rikthejë menjëherë në detyrën e prokurorit.

Kontekstualizimi i situatës në Poloni

Rastet e mëposhtme, konkretisht Grzęda, Żurek dhe Tuleya kundër Polonisë lidhen me atë që është përshkruar gjerësisht si kriza e shtetit të së drejtës në Poloni.

Në zgjedhjet e vitit 2015, partia “Ligj dhe Drejtësi” mori kontrollin e presidencës dhe të Sejmimit (dhoma e ulët e Parlamentit). Sejmi i mëparshëm kishte zgjedhur pesë gjyqtarë të rinj në Gjykatën Kushtetuese për të plotësuar tre vendet që do të liheshin vakante brenda mandatit të Sejmimit dhe dy që do të liheshin menjëherë pas tyre. Presidenti i ri i Polonisë nuk pranoi betimin e këtyre gjyqtarëve. Sejmi i ri më pas revokoi zgjedhjen e tyre dhe në vend të tyre zgjodhi një grup të ri prej pesë gjyqtarësh. Ata u betuan menjëherë.

Lidhur me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese vendosi duke u shprehur se çdo Sejm mund të zgjidhte gjyqtarë vetëm për vendet vakante që lindnin brenda mandatit të tij parlamentar; Pra, Sejmi i mëparshëm duhet të kishte zgjedhur tre gjyqtarë, dhe Sejmi i ri dy. Kjo zgjedhje e gjyqtarëve në vendet që tashmë ishin plotësuar në mënyrë të vlefshme ishte fillimi i asaj që është përshkruar gjerësisht si kriza e shtetit të së drejtës në Poloni.

Në vitin 2017, qeveria miratoi tre ligje me qëllim reformimin e gjykatave të zakonshme, Gjykatës së Lartë dhe Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit (KGJ). Ndër të tjera, ato i akorduan kompetenca shtesë Prokurorit të Përgjithshëm (ku në bazë të ligjit të 2016 posti mbahej sipas detyrës zyrtare nga Ministri i Drejtësisë) për organizimin e brendshëm të gjykatave dhe për emërimin dhe shkarkimin e kryetarëve dhe nënkryetarëve të gjykatave; transferoi kompetencën për të zgjedhur anëtarët të gjyqësorit nga KKGJ-së tek Sejm; largohen nga detyra anëtarët gjyqësorë të KKGJ-së që ishin zgjedhur sipas sistemit të mëparshëm; ndryshuan ndjeshëm përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve; dhe u krijuan dy dhoma të reja të Gjykatës së Lartë, Dhoma e Disiplinës dhe Dhoma e Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm dhe Çështjeve Publike, me anëtarë të emëruar nga Presidenti i Republikës pas rekomandimeve të KKGJ-së së re.

Mungesa e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje cenonte të drejtën e kërkuarit për të aksesuar gjykatën e cila derivonte në shkelje të nenit 6

GRZEDA KUNDËR POLONISË

(Kërkesa nr. 43572/18)

FAKTET KRYESORE

Kërkuari, Jan Grzęda, është shtetas polak i lindur në vitin 1956 dhe jeton në Pila (Poloni). Ai ushtron funksionin e gjyqtarit që nga viti 1986. Në atë periudhë ai ishte anëtar i Gjykatës Administrative Rajonale Gorzów Wielkopolski. Në vitin 2016 u zgjodh në KKGJ për një mandat katër vjeçar.

Sipas ndryshimeve të legjislacionit të miratuara në vitin 2017, mandati i tij në KKGJ u ndërpre, kur 15 gjyqtarë të rinj u zgjodhën në KKGJ nga ana e Sejmimit më 6 mars 2018. Sipas tij, nuk kishte asnjë mënyrë për të kundërshtuar mbarimin e mandatit të tij. Z. Grzęda vijoi të kishte funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë Administrative.

Duke u mbështetur në nenet 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13 (e drejta për një mjet juridik efektiv), kërkuari u ankua se i ishte mohuar aksesin në gjykatë pasi nuk kishte pasur mundësi për të kundërshtuar përfundimin e mandatit të tij në KKGJ, dhe mungesës së një mjeti juridik efektiv në këtë aspekt.

VENDIMI I GJYKATËS

Neni 6

Palët nuk ranë dakord nëse kërkuari mund të konsiderohet se kishte një “të drejtë” për të ushtruar mandatin e tij katërvjeçar në

KKGJ. Gjykata konstatoi se sipas ligjit të brendshëm “e drejta” për të ushtruar një mandat të plotë ngrihej në diskutim, duke iu referuar Kushtetutës, praktikës gjyqësore kushtetuese dhe legjislacionit përkatës mbështetës.

Më pas, Gjykata vendosi se kjo “e drejtë” binte në mbrojtjen e nenit 6 pasi përjashtimi i aksesit në gjykatë nuk ishte vërtetuar se ishte i justifikuar objektivisht (kushti i dytë i testit *Eskelinen*), dhe se vetëm mbikëqyrja nga një organ gjyqësor mund t’u garantonte gjyqtarëve mbrojtjen thelbësore nga arbitrariteti nga ana e legjislativit apo ekzekutivit.

Gjykata theksoi se parimi themelor i shtetit të së drejtës ishte pjesë në të gjitha nenet e Konventës. Arbitrariteti binte ndesh me shtetin e së drejtës dhe nuk mund të tolerohej as përsa i takon respektimit të të drejtave procedurale. Gjithashtu, Gjykata theksoi se nuk po angazhohej në interpretimin kushtetues, por vetëm në interpretimin e Konventës si të zbatueshme në këtë situatë.

Lidhur me themelin e çështjes, Gjykata theksoi rëndësinë e mandatit të KKGJ-së për të mbrojtur pavarësinë e gjyqësorit dhe lidhjen midis integritetit të emërimeve në drejtësi dhe kërkesës për pavarësi të gjyqësorit. Ajo vlerësoi se masa mbrojtëse procedurale të ngjashme me ato që zbatohen për shkarkimin e gjyqtarëve duhet të jenë të disponueshme edhe për shkarkimin e një anëtari gjyqësor të KKGJ-së nga pozicioni i tij/saj.

Qeveria pohoi se mungesa e aksesit në gjykatë nuk ishte rezultat i reformave të kontestuara. Ata argumentuan se nuk kishte pasur asnjëherë mundësi që një anëtar i KKGJ-së të kundërshtonte përfundimin e mandatit të tij/saj. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se Qeveria në fakt nuk kërkoi të justifikonte mungesën e shqyrtimit gjyqësor në rrethana të tilla.

Gjykata theksoi se ishte plotësisht e vetëdijshme për kontekstin e çështjes – dobësimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimin e standardeve të shtetit të së drejtës i ardhur nga reformat qeveritare. Në veçanti, reformat e njëpasnjëshme në drejtësi kishin pasur për qëllim dobësimin e pavarësisë së gjyqësorit, duke filluar me parregullsitë e rënda në zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në dhjetor 2015, më pas, në veçanti, ri-strukturimin e KKGJ-së dhe ngritjen e dhomave të reja të Gjykatës së Lartë, duke zgjeruar kontrollin e Ministrit të Drejtësisë mbi gjykatat dhe duke rritur rolin e tij në çështjet e disiplinës gjyqësore.

Gjykata ju referua jurisprudencës së saj në lidhje me riorganizimin e sistemit gjyqësor polak, si dhe çështjeve të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe vendimeve përkatëse të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative të Polonisë. Ajo u shpreh se si rezultat i këtyre reformave të njëpasnjëshme, gjyqësori ishte ekspozuar ndaj ndërhyrjeve nga ekzekutivi dhe legjislativi dhe pavarësia e tij ishte dobësuar ndjeshëm. Rasti i kërkuarit ishte një shembull i kësaj tendence të përgjithshme. Në përgjithësi, Gjykata konstatoi se mungesa e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje cenonte të drejtën e kërkuarit për të aksesuar gjykatën, në kundërshtim me Konventën.

Nenet e tjera

Duke qenë se ankimi sipas nenit 13 në thelb ishte i njëjtë me atë sipas nenit 6 § 1, Gjykata vendosi se nuk ishte e nevojshme ta shqyrtonte më vete atë.

Neni 41

Gjykata vlerësoi se konstatimi i shkeljes përbënte një kompensim të drejtë dhe të mjaftueshëm lidhur me dëmin jo-material. Ajo i akordoi atij shumën prej 30,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

Gjykata theksoi se reformat e ndryshme gjyqësore të ndërmarra nga qeveria polake, kishin ndikuar në dobësimin e pavarësisë së gjyqësorit duke konstatuar shkelje të nenit 6 § 1. Po ashtu, kishte pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkuetit për lirinë e shprehjes dhe se kjo ndërhyrje nuk kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

ZUREK KUNDËR POLONISË

(Kërkesa nr. 39650/18)

20 maj 2020

FAKTET KRYESORE

Kërkueti, Waldemar Żurek, është shtetas polak, i cili ka lindur në 1970 dhe jeton në Rzeplin (Poloni). Ai është gjyqtar në Gjykatën Rajonale të Krakovit dhe ishte zëdhënës shtypi i gjyktës. Gjithashtu ai ishte anëtar i KKGJ-së, fillimisht i zgjedhur në 2010 dhe më pas i rizgjedhur në 2014 për mandat të dytë 4 vjeçar. Në 2014 ai u caktua si zëdhënës shtypi i KKGJ-së, dhe pas kësaj u bë një nga kritikët kryesorë për ndryshimet në gjyqësor të iniciuara nga legjislativi dhe ekzekutivi i qeverisë së re, e cila kishte ardhur në pushtet në 2015. Ai theksoi veçanërisht kërcënimin e pavarësisë së gjyqësorit për shkak të propozimeve që vinin nga Qeveria për këtë pushtet.

Mandati i tij si anëtar i KKGJ-së përfundoi në 2018 duke u ndjekur nga hyrja në fuqi e legjislacionit të ri në kuadrin e një reforme të madhe në gjyqësor.

Veçanërisht, Ligji i amenduar lidhur me KKGJ-në e 2017, parashikonte se anëtarët e gjyqësorit nuk do të zgjidheshin më nga gjyqtarët, por nga SEJM (Dhoma e ulët e Parlamentit), dhe se anëtarë e zgjedhur rishtazi do të zëvendësonin menjëherë ata që ishin zgjedhur sipas

legjislacionit të mëparshëm. Për këtë, më 6 mars 2018 Sejm zgjodhi 15 gjyqtarë si anëtarë të rinj të KKGJ-së, duke derivuar në mbarimin e mandatit të kërkuesit. Largimi i tij nuk u bë përmes një njoftimi zyrtar dhe për më tepër ai nuk mbante më as pozicionin e zëdhënësit për shtyp të KKGJ-së.

Po ashtu, në fillim të vitit 2018, kërkuesi u pushua nga pozicioni si Zëdhënës për shtyp i Gjykatës Rajonale të Krakovit. Projekt-ligji i ndryshuar lidhur me KKGJ-të u kritikua në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare. Miratimi nga Parlamenti i këtij projektligji së bashku me projektligje të tjera për Gjykatën e Lartë dhe gjykatat e zakonshme, nxiti protesta të mëdha publike në korrik të 2017. Një sërë institucionesh publike dhanë opinione, duke deklaruar se këto amendime ligjore shkelnin Kushtetutën sepse ato i akordonin tagra pushtetit legjislativ për të ndikuar dhe pasur kontroll mbi KKGJ-të, në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve.

Bazuar në nenin 6 § 1 (e drejta për të pasur akses në gjykatë) dhe nenin 13 (e drejta për të pasur një mjet efektiv) të KEDNJ-së, z. Żurek ankohej se atij i ishte mohuar aksesin në gjykatë dhe se nuk kishte asnjë procedurë gjyqësore ose një formë tjetër të kontestimit të përfundimit të parakohshëm të mandatit të tij.

Gjithashtu, bazuar në nenin 10 (liria e shprehjes), ai ankohej se shkarkimi i tij si zëdhënës për shtyp i gjykatës rajonale dhe KKGJ-së i ndërthurur me vendimet e autoriteteve për të inspektuar deklaratat financiare të tij dhe gruas së tij dhe taksave në 2017, kishin për qëllim të ndëshkonin atë lidhur me kritikën që ai kishte ngritur kundër qeverisë përse i takon ndryshimeve legjislative dhe kishte paralajmëruar dhe gjyqtarët e tjerë që kishin vepruar në atë formë. Veçanërisht ai vuri në dukje se veprimi i autoriteteve nuk ishte i paqëllimtë dhe koncordoi me debate publike të mëdha lidhur me gjyqësorin dhe angazhimin e tij aktiv në të si zëdhënës për shtyp i KKGJ-së.

VENDIMI I GJYKATËS

Neni 6 § 1

Gjykata vuri në dukje se Qeveria nuk kishte dhënë asnjë arsye që justifikonte mungesën e shqyrtimit gjyqësor të vendimit për përfundimin e parakohshëm të mandatit të kërkuarit në KKGJ, thjesht duke përsëritur argumentet e saj për pazbatueshmërinë e nenit 6 për çështjen. Megjithatë, si në çështjen e fundit të Dhomës së Madhe *Grzęda k. Polonisë*, Gjykata konstatoi se “e drejta” e kërkuarit për të kryer një mandat të plotë kishte qenë pjesë e diskursit sipas ligjit të brendshëm dhe se kjo “e drejtë” binte në fushëmbrojtjen e nenit 6.

Prandaj, neni 6 § 1 gjente zbatim në këtë rast dhe mungesa e shqyrtimit gjyqësor të vendimit për shkarkimin e z. Żurek nga KKGJ kishte cenuar rëndë të drejtën e tij për të pasur akses në gjykatë. Ashtu si në rastin *Grzęda*, Gjykata theksoi kontekstin e përgjithshëm të reformave të ndryshme gjyqësore të ndërmarra nga qeveria polake, duke përfshirë atë të KKGJ-së që kishte prekur kërkuarin, e cila kishte ndikuar në dobësimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe atë që është përshkruar gjerësisht si kriza e shtetit të së drejtës në Poloni. Prandaj, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

Gjithashtu, Gjykata u shpreh se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej veçmas pranueshmëria dhe bazueshmëria e kërkesës sipas nenit 13 të Konventës duke qenë se ajo ishte në thelb e njëjtë me nenin 6 § 1.

Neni 10

Qeveria argumentoi se masat e marra kundër z. Żurek kishin qenë neutrale dhe ishin zbatuar për të gjithë gjyqtarët dhe për rrjedhojë nuk kishin ndërhyrë në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Megjithatë, Gjykata konstatoi, se masat duheshin parë në kompleksitetin dhe

kontekstin e ngjarjeve: që do të thotë, në sfondin e përgjithshëm të reformave të njëpasnjëshme të qeverisë që synonin dobësimin e pavarësisë së gjyqësorit; dhe, konkretisht, faktin se ata të gjithë kishin ndjekur deklaratat publike të kërkuesit – në intervista, në artikuj në internet dhe në kanalin YouTube të KKGJ-së – mes viteve 2015 dhe 2018 duke kritikuar ligjet dhe politikat e propozuara të qeverisë në lidhje me gjyqësorin, se ato të gjitha ishin ndërmarrë nga organet e kontrolluara ose të emëruara nga ekzekutivi dhe se nuk ishin shkaktuar me sa duket nga ndonjë parregullsi e vërtetuar nga ana e tij, veçanërisht në lidhje me auditimin e financave dhe inspektimin e punës së tij.

Gjykata theksoi se kërkuesi, si gjyqtar dhe anëtar/zëdhënës i KKGJ-së, kishte jo vetëm të drejtën, por edhe detyrën të shprehej në mbrojtje të shtetit të së drejtës dhe pavarësisë së gjyqësorit. Në të vërtetë, ai ishte një nga figurat më të rëndësishme të komunitetit gjyqësor në Poloni, i cili i kishte mbrojtur në mënyrë të qëndrueshme vlerat themelore, duke i bërë deklaratat e tij bazuar në aspektin profesional. Për këtë, në rastin e tij kërkohet një shkallë më e lartë e mbrojtjes së lirisë së shprehjes, si dhe një shqyrtim më i rreptë i çdo ndërhyrjeje në të drejtat e tij.

Në shqyrtimin e masave kundër kërkuesit, Gjykata vuri në dukje se auditimi ishte shkaktuar nga disa parregullsi të paspecifikuara dhe kishte zgjatur 17 muaj pa ndonjë rezultat konkret, ndërsa inspektimi i punës së kërkuesit në Gjykatën Rajonale të Krakovit kishte filluar vetëm një ditë pas marrjes së një letre anonime, e cila në thelb lidhej me kritikën e tij për reformën e gjyqësorit dhe jo me ndonjë sjellje të pahijshme apo paaftësinë për të ushtruar funksionet e tij gjyqësore. Për më tepër, vendimi për shkarkimin e tij si zëdhënës i asaj gjykate ishte marrë pa marrë mendimin e Bordit, siç kërkohet nga legjislacioni përkatës.

Gjykata konstatoi se marrja e masave të tilla mund të kategorizohet si një strategji që synonte frikësimin (ose edhe heshtjen) e kërkuarit për shkak të pikëpamjeve të tij. Lidhur me materialin përpara saj, Gjykata konstatoi se nuk kishte asnjë motiv tjetër të besueshëm.

Për më tepër, masat e marra, padyshim patën një “efekt ftohës” në atë që duhej të kishin dekurajuar jo vetëm kërkuarin, por edhe gjyqtarë të tjerë nga pjesëmarrja në debatin publik mbi reformat legjislativë që prekin gjyqësorin dhe në përgjithësi për çështjet që kanë të bëjnë me pavarësinë e gjyqësorit. Duke pasur parasysh rëndësinë kryesore të lirisë së shprehjes për çështjet me interes të përgjithshëm, Gjykata ishte e mendimit se kishte pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkuarit për lirinë e shprehjes dhe se kjo ndërhyrje nuk kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Për rrjedhojë, Gjykata konkludoi se kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuarit 15,000 euro lidhur me dëmin jomaterial dhe 10,000 euro lidhur me kostot dhe shpenzimet e tjera.

*Gjykata konstatoi shkelje të shumta në çështjen lidhur me regjimin
disiplinor për gjyqtarët në Poloni*

TULEYA KUNDËR POLONISË

(Kërkesa nr. 21181/19)

6 korrik 2023

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi, Igor Tuleya, është shtetas polak i cili kishte lindur në 1970 dhe jetonte në Varshavë. Ai ishte gjyqtar i njohur dhe mbante funksione gjyqësore që nga viti 1996, si dhe ishte mjaft aktiv në mbrojtjen e shtetit të së drejtës në Poloni. Me hyrjen në fuqi e legjislacionit për ndryshimin e disiplinës gjyqësore në vitin 2018, kundër gjyqtarëve përsa i takon vendimeve të tyre apo aktivitetet publike janë nisur mjaft procedime disiplinore. Shumica e gjyqtarëve kanë kritikuar hapur ndryshimet legjislative në gjyqësor të propozuara nga viti 2016-2018.

Në vitin 2018, kundër z. Tuleya, u inicuan pesë grupe hetimesh paraprake në lidhje me shkelje të mundshme disiplinore. Këto hetime kishin të bënin kryesisht me komentet që ai kishte bërë në televizion ose pyetje mbi pjesëmarrjen e tij në takime publike, ndërsa të tjera kishin të bënin me aktivitetin e tij gjyqësor. Z. Tuleya pretendoi se si rezultat i hetimeve paraprake ai ishte bërë subjekt i një fushate shpifjeje në media, me informacion fyes ose diskreditues në lidhje me ato që publikoheshin ose transmetoheshin.

Një nga hetimet paraprake kundër z. Tuleya nisi pas vendimit të tij për të paraqitur një kërkesë në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian për një vendim paraprak mbi regjimin e ri disiplinor për gjyqtarët. Në një tjetër hetim, oficeri disiplinor thirri z. Tuleya

për të dhënë një deklaratë në lidhje me zbulimin e mundshëm të informacionit konfidencial nga një dosje hetimore. Hetimi kishte të bënte me parregullsi të pretenduara parlamentare, të cilat kishin penguar parlamentarët e opozitës të merrnin pjesë në një seancë për diskutimin e buxhetit më 16 dhjetor 2016 (i njohur si “votimi i Kolonës”).

Më 18 dhjetor 2017, në një seancë gjyqësore të mbajtur publikisht, të cilën z. Tuleya i kishte dhënë leje medias për ta regjistruar, ai kishte vendosur – duke dhënë arsye gojarisht – të lejonte një ankim të ndërmjetëm dhe urdhëroi prokurorët të vazhdonin hetimin e mbyllur më parë. Lejimi nga ana e z. Tuleya për regjistrimin e kësaj seance gjyqësore nga mediat ishte gjithashtu objekt i procedimit penal. Në këtë kuadër, më 17 shkurt 2020, një prokuror iu drejtua Dhomës Disiplinore të Gjykatës së Lartë për t’i hequr imunitetin gjyqësor me qëllim akuzimin e tij për vepra që lidhen me zbulimin e informacionit personave të paautorizuar dhe veprimin në dëm të interesit publik. Më 18 nëntor 2020, pas disa fazave të procedimit, kërkuesit iu hoq imuniteti dhe ai u pezullua nga detyrat e tij zyrtare nga Dhoma Disiplinore e Gjykatës së Lartë. Gjatë periudhës së pezullimit, paga e tij u ul me një të katërtën.

Më 29 nëntor 2022, Dhoma e sapokrijuar e Përgjegjësive Profesionale (“DHPP”), e cila kishte zëvendësuar Dhomën e Disiplinës të Gjykatës së Lartë, anuloi vendimin e pezullimit të kërkuesit nga detyra dhe uljen e pagës. Në veçanti, kjo dhomë e re u shpreh se nuk kishte dyshim të arsyeshëm se z. Tuleya mund të kishte kryer vepra penale siç pretendohet. Megjithatë mbetet në fuqi pjesa që ka të bëjë me heqjen e imunitetit të tij, duke e vendosur atë para përgjegjësive penale. Pas këtij vendimi, z. Tuleya u rikthye në detyrë, me pagë të plotë dhe mori dhe pagat e prapambetura. Procedimi penal kundër z. Tuleya vazhdon, ndërsa për asnjë nga hetimet paraprake nuk janë marrë masa disiplinore kundër tij. Ai u shpreh se në asnjë moment nuk është informuar lidhur me pushimin e hetimeve.

Duke u mbështetur në nenin 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt) të Konventës, kërkuesi u ankua se Dhoma e Disiplinës e Gjykatës së Lartë, e cila kishte vendosur t’i hiqte imunitetin dhe ta pezullonte nga detyrat gjyqësore, nuk plotësonin kërkesat e një “gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj”.

Ai gjithashtu pretendoi se masat e marra ndaj tij ishin kërcënuese dhe kishin vënë në dyshim reputacionin e tij si gjyqtar, e cila derivonte në shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), dhe kishin qenë një kundërpërgjigje për kritikën e tij publike ndaj cenimit të pavarësisë së gjyqësorit nga autoritetet, në kundërshtim me nenin 10 (lirinë e shprehjes). Sipas tij, masa të tilla jo vetëm që kishin për qëllim të dekurajonin dhe frikësonin, por edhe të prodhonin një “efekt ftohës”⁴ për të gjithë gjyqtarët. Së fundmi, ai pretendoi për shkelje të nenit 13 (e drejta për një mjet juridik efektiv), për arsye se ai nuk kishte pasur asnjë rrugë ligjore për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave të tij të privatësisë.

VENDIMI I GJYKATËS

Gjykata e pa të arsyeshme të shqyrtonte të dyja aplikimet në një gjykim të vetëm.

Neni 6 § 1

Gjykata konstatoi se, vendimi i 29 nëntorit, i DHPP-së së sapokrijuar, që kishte çuar në rivendosjen e tij në punë dhe pagesën e prapambetur, kishte pranuar – në thelb – shkeljen e të drejtës së tij sipas nenit 6 § 1 dhe kishte ofruar kompensim të mjaftueshëm për atë kohë sa kishte zgjatur pezullimi. Për rrjedhojë, ai nuk gëzonte më statusin e viktimës

4 Chilling effect – I referohet një fenomeni ku individë ose grupe të caktuara përmbahen për të mos u shprehur nga frika se mos bien ndesh me një ligj apo rregullorë. “Chilling effect ndodhin zakonisht kur një ligj është shumë i gjerë ose i paqartë.

në lidhje me atë aspekt të ankesës së tij sipas nenit 6 § 1. Gjykata e përgëzoi marrjen e këtij vendimi, duke e konsideruar një zhvillim pozitiv në krizën e shtetit të së drejtës në Poloni. Megjithatë, ajo vuri në dukje se – ndërsa DHPP kishte vërtetuar se z. Tuleya nuk kishte kryer asnjë veprë penale – vendimi i 18 nëntorit 2020 për heqjen e imunitetit të tij dhe ndjekjen penale vazhdonte të kishte efekte. Asgjë nuk ishte bërë në nivel kombëtar për të përfunduar procedimin penal. Pasojat negative të derivuara nga ai vendimi vazhduan të vepronin dhe asnjë masë nuk ishte marrë për mbylljen e procesit penal. Për këtë, Gjykata konstatoi se z. Tuleya gëzonte statusin e viktimës për sa i përket heqjes së imunitetit të tij. Gjykata më pas vazhdoi të shqyrtonte nëse aspekti penal i nenit 6 § 1 mund të zbatohet për procedurat që lidheshin me heqjen e imunitetit të z. Tuleya.

Gjykata vuri në dukje se prokurori kishte kërkuar heqjen e imunitetit të z. Tuleya në mënyrë që të mund ta akuzonte atë për zbulim të paautorizuar të informacionit gjatë procedurave paraprake, siç parashikohet në nenin 241 § 1 të Kodit Penal. Kjo veprë, sipas legjislacionit të brendshëm ishte qartësisht një veprë penale. Për më tepër, dënohej me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Rrjedhimisht, edhe pse kërkuesi nuk ishte akuzuar ende zyrtarisht në procedimin penal, dyshimi që u hodh mbi të kishte ndikuar ndjeshëm në situatën e tij. Prandaj, Gjykata konstatoi se aspekti penal i nenit 6 § 1 ishte i zbatueshëm për procedurat për heqjen e imunitetit në çështjen e z. Tuleya.

Për të arritur në këtë përfundim, ai theksoi veçoritë dhe natyrën specifike të procedurave të imunitetit në Poloni, siç përmendet në një sërë vendimesh nga gjykatat më të larta polake në vitet e fundit. Ato vendime kishin konstatuar se vendimi për heqjen e imunitetit të një gjyqtari mund të merrej vetëm nga një gjykatë dhe me një procedurë që siguron garancitë themelore për një gjykim të drejtë. Faktikisht, imuniteti gjyqësor kishte një traditë të gjatë sipas ligjit polak dhe konsiderohej si një nga garancitë e pavarësisë së gjyqësorit.

Së fundi, për sa i përket bazueshmërisë së ankesave të z. Tuleya sipas nenit 6 § 1, Gjykata konstatoi, në përputhje me vendimet e saj *Reczkoëicz k. Polonisë* dhe *Juszczyszyn k. Polonisë*, se Dhoma Disiplinore e Gjykatës së Lartë, e cila kishte shqyrtuar çështjen e z. Tuleya, nuk kishte qenë një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj”. Arsyet mbi të cilat Gjykata kishte konkluduar në këto dy vendime të mëparshme, qëndronte dhe për rastin në fjalë. Në veçanti, procedura për emërimin e gjyqtarëve në Dhomën e Disiplinës, ishte ndikuar në mënyrë të padrejtë nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, e cila rezultoi në një parregullsi thelbësore që ndikoi negativisht në të gjithë procesin dhe cenoi legjitimitetin e Dhomës Disiplinore. Për rrjedhojë, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me të drejtën për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj.

Neni 8

Së pari, Gjykata u përqendrua në një nga hetimet paraprake, në lidhje me kërkesën e z. Tuleya për një vendim paraprak në GJED dhe vendimin për heqjen e imunitetit dhe pezullimin e tij nga detyrat e tij zyrtare. Ajo konstatoi se masat që lidheshin me vënien në diskutim të integritetit të tij gjyqësor dhe reputacionin profesional si dhe duke e penguar atë në ushtrimin e detyrave të tij zyrtare për më shumë se dy vjet, kishin ndikuar së tepërmi në jetën e tij private. Prandaj, neni 8 gjente zbatim në këtë rast dhe masat e marra kishin ndërhyrë në të drejtën e z. Tuleya për respektimin e jetës së tij private. Gjykata vijoi të sillte në vëmendje gjetjet e vendimit të 15 korrikut 2021 të GJED-së, lidhur me regjimin e ri disiplinor për gjyqtarët polakë, i cili ishte i papajtueshëm me ligjin e Bashkimit Evropian.

Në këtë vendim, GJED-ja konstatoi se fakti i kryerjes së një hetimi paraprak për kërkesat për një vendim paraprak ushtron presion mbi gjyqtarët në fjalë dhe minon pavarësinë e tyre. Sipas arsytimit të Gjykatës, përgjegjësia disiplinore për dhënien e një vendimi gjyqësor mund të merret vetëm si një masë përjashtimore. Ndërhyrja në të

drejtën e z. Tuleya për respektimin e jetës së tij private nuk ka qenë “në përputhje me ligjin” sipas parashikimeve të nenit 8. As vendimi për heqjen e imunitetit të z. Tuleya dhe pezullimin e tij nuk ishte i ligjshëm, në thelb për dy arsye.

Për sa i përket pikës së parë, Gjykata konstatoi se ato masa ishin urdhëruar nga Dhoma Disiplinore e Gjykatës së Lartë, një organ i cili – sipas vendimit të *Reczkoëicz k. Polonisë* të Gjykatës Evropiane, nuk kishte përmbushur kërkesat e një “gjykate të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj”, pavarësisht se Kushtetuta polake kërkon në mënyrë eksplicite që vendime të tilla të merren nga një gjykatë.

Lidhur me arsyen e dytë, interpretimi i ligjit nga Dhoma Disiplinore në vendimin e saj për heqjen e imunitetit të z. Tuleya dhe pezullimin e tij kishte qenë qartësisht i paparashikueshëm. Gjykata nuk mundi të dallonte ndonjë keqdashje në dhënien e vendimit të saj në lidhje me hetimin e “votimit të Kolonës” në gjykatë të hapur. Në fakt, vetë Dhoma e Disiplinës nuk kishte marrë në konsideratë faktin se ai kishte zbuluar qëllimisht informacionin e mbrojtur. As Dhoma e Disiplinës nuk kishte konstatuar se dalja e tij publikisht kishte shkaktuar ndonjë kërcënim real për interesin publik ose kishte ndikuar negativisht në hetime.

Për ta përmbledhur, z. Tuleya nuk mund të kishte parashikuar që veprimet e tij mund të çonin në heqjen e imunitetit të tij për tu ndjekur penalisht dhe pezullimin e tij. Gjykata theksoi se çështja e z. Tuleya duhej parë në kontekst, veçanërisht se ai ishte një nga kritikët më të hapur të riorganizimit të gjyqësorit në Poloni dhe se ajo kishte konstatuar gjetje dhe – në vendimin e saj *Grzęda k. Polonisë* – se Reformat e njëpasnjëshme të qeverisë kishin dobësuar pavarësinë e gjyqësorit. Në përgjithësi, ndërhyrja në të drejtën e z. Tuleya për respektimin e jetës së tij private nuk ishte “në përputhje me ligjin”, për rrjedhojë kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

Neni 10

Gjykata konstatoi se kishte pasur ndërhyrje në të drejtën e z. Tuleya lidhur me lirinë e shprehjes. Për sa i përket tre prej hetimeve paraprake – në lidhje me një intervistë që ai kishte dhënë në kanalën televizivë të lajmeve TVN24 dhe pjesëmarrjen e tij në takime publike në Gdańsk dhe Lublin – ishte e qartë se ato kishin qenë rezultat i ushtrimit të lirisë së tij të shprehjes. Për më tepër, kishte arsye për të besuar, duke pasur parasysh kontekstin e përgjithshëm, se heqja e imunitetit të z. Tuleya kishte qenë një sanksion i maskuar për kritikën e tij të shprehura ndaj reformës së njëpasnjëshme gjyqësore. Ky përfundim u vërtetua jo vetëm në shtypin polak dhe ndërkombëtar, por edhe nga Këshilli i Evropës, Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve dhe Qendra Amerikane e Avokatisë për të Drejtat e Njeriut.

Kjo ndërhyrje nuk ishte “e parashikuar me ligj”. Në veçanti, z. Tuleya nuk ishte informuar për ndërprerjen e intervistës televizive dhe pjesëmarrjen e tij në dy takimet publike për shkak të hetimeve paraprake. Pa këto garanci minimale, hetimet paraprake kishin vend për abuzim dhe mund t’i dekurajonin gjyqtarët për të shprehur opinionet e tyre për çështjet me interes publik.

As vendimi për heqjen e imunitetit dhe pezullimin e tij nga detyrat e tij zyrtare nuk mund të konsiderohej i ligjshëm, duke pasur parasysh konstatimin e mësipërm se Dhoma Disiplinore e Gjykatës së Lartë që kishte marrë vendimin nuk ishte një “gjykatë” për qëllimet e Konventës. Së fundmi, Gjykata nuk mund të pranonte se kishte pasur ndonjë qëllim legjitim për ndërhyrjen në të drejtën e z. Tuleya për lirinë e shprehjes. Ai e kishte mbrojtur në mënyrë të qëndrueshme shtetin e së drejtës dhe pavarësinë e gjyqësorit, pa shkuar përtej kritikave profesionale.

Në të vërtetë, masat e marra nga autoritetet mund të karakterizohen si një strategji që synon frikësimin (apo edhe heshtjen) për pikëpamjet e

tij. Masa të tilla duhej të kishin dekurajuar jo vetëm z. Tuleya por edhe gjyqtarë të tjerë nga pjesëmarrja në debatin publik lidhur me reformat legislative që preknin gjyqësorin dhe në përgjithësi për çështjet që kanë të bëjnë me pavarësinë e tij. Për rrjedhojë, kishte pasur shkelje të nenit 10.

Neni 13

Duke konstatuar gjetjet që u bënë lidhur me nenin 8, Gjykata konstatoi se nuk ishte i nevojshëm shqyrtimi më vete i themelit të kërkesës lidhur me nenin 13.

Neni 41

Gjykata i akordoi z. Tuleya 30,000 euro në lidhje me dëmin jo-material dhe 6,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet e tjera.

3. PAANSHMËRIA OBJEKTIVE DHE SUBJEKTIVE

Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 pasi hetimi i kryer ishte i plotë dhe i pavarur dhe se kërkuesit ishin të përfshirë në të në një shkallë të mjaftueshme për mbrojtjen e interesave të tyre dhe për garantimin e të drejtave.

MUSTAFA TUNÇ DHE FECIRE TUNÇ KUNDËR TURQISË

(Kërkesa nr. 24014/05)

14 prill 2015

Dhomë e Madhe

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi, Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç, burrë e grua, janë shtetas turq të cilët kanë lindur përkatësisht në 1946 dhe 1952 dhe jetojnë në Stamboll (Turqi). Ata janë prindërit e Cihan Tunç, i cili lindi në 1983 dhe vdiq në 13 shkurt 2004, kur ishte duke kryer shërbimin ushtarak në Kocaköy, i caktuar në një vend që i përkiste një kompanie private naftë dhe për të cilën xhandarmëria kombëtare kryente shërbimin e sigurisë. Në shkurt 2004 rreth orës 05:50 të mëngjesit ai u plagos me armë zjarri dhe u dërgua menjëherë në spital, ku u deklarua i vdekur pas mbërritjes.

Për çështjen, u hap një hetim gjyqësor dhe po ashtu u krye autopsia e trupit. M.S. dhe rreshteri A.A., të cilët kishin shoqëruar viktimën në spital, u morën në pyetje. Nga hetimet e kryera në vendin e ngjarjes u

zbulua se arma e Cihan Tunç ishte përdorur, nga ku u gjet një fishek në tokë afër vendit ku qëndronte personi që bënte roje. Provat e mbledhura u dërguan për analizë në laborator.

Më 16 shkurt 2004 laboratori kriminalistik i xhandarmërisë komunikoi raportin e tij, sipas të cilit Cihan Tunç kishte qenë viktimë e një të shtëne nga një distancë e afërt. Si pjesë e hetimeve të kryera nga prokuroria ushtarake, shumë ushtarakë u morën në pyetje.

Sipas konkluzioneve të hetimit administrativ rezultoi se vdekja e Cihan Tunç kishte ndodhur aksidentalisht ndërkohë që ai ishte duke pastruar armën.

Më 30 qershor 2004, me arsyetimin se nuk kishte dyshime se një person tjetër mund të ketë qenë përgjegjës për vdekjen e Cihan Tunç, prokuroria pasi kishte përfunduar hetimet konkludoi se rasti në fjalë nuk do ndiqej penalisht.

Kërkuesit apeluan vendimin duke pretenduar se ekzistonin pista që linin vend për dyshim mbi vdekjen e djalit të tyre.

Më 14 tetor 2004, Gjykata ushtarake pranoi ankesën e kërkuesve dhe urdhëroi shërbimin e prokurorisë për të kryer një hetim shtesë. Hetimi i kryer konfirmoi se incidenti nuk mund të kishte qenë vetëvrasje dhe se të gjitha provat e mbështetnin hipotezën e vetvrasjes aksidentale për shkak të mospërdorimit me kujdes të armës. Në dhejtor 2004 Gjykata Ushtarake hodhi poshtë ankesën e kërkuesve.

Më 13 janar 2005, kërkuesit ngritën padi para Gjykatës së Lartë Administrative Ushtarake, duke pretenduar kompensim financiar për vdekjen e djalit të tyre. Më 10 janar 2007, gjykata pranoi pjesërisht kërkesën e tyre.

Duke u bazuar në nenin 2 të Konventës, kërkuesit pretenduan se hetimi për përcaktimin e rrethanave të vdekjes së të afërmit të tyre nuk i përmbush kërkesat e këtij neni.

Kërkesa u paraqit në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut më 24 qershor 2005. Mustafa Tunç vdiq më 9 shkurt 2006. Djali i tij informoi Gjykatën se dëshironte të ndiqte kërkesën para Gjykatës si trashëgimtar i të ndjerit.

Më 4 mars 2010, kërkesa iu komunikua Qeverisë. Më 25 qershor 2013 Dhoma e Seksionit të Dytë dha një vendim me katër vota, ku tre vendosën se ka pasur shkelje të Nenit 2 të Konventës në lidhje me pavarësinë e hetimit dhe njëzëri për mospranueshmërinë e kërkesave të tjera.

Dhoma nuk identifikoi asnjë arsye, por hodhi dyshime mbi përshtatshmërinë dhe shpejtësinë e hetimit të bërë nga autoritetet vendase. Ajo u shpreh se kërkuesve i ishte dhënë akses mbi hetimin e kryer deri në atë masë sa që ishte e mjaftueshme për marrjen pjesë në mënyrë efektive në procedurë. Megjithatë, Dhoma vendosi se hetimi nuk kishte qenë i pavarur, duke e bazuar gjetjen e saj në rregullat në fuqi në atë kohë, ku një nga tre anëtarët e gjykatës ushtarake nuk e gëzojnë të gjitha garancitë e kërkuara të pavarësisë.

Më 25 shtator 2013, Qeveria ka kërkuar që rasti t'i referohet Dhomës së Madhe në bazë të nenit 43. Më 4 nëntor 2013 paneli i Dhomës së Madhe pranoi kërkesën. Seanca u mbajt më 16 prill 2014.

VENDIMI I GJYKATËS

Neni 2

Në rastin konkret, Gjykata vërejti se Qeveria nuk i ka ngritur prapësimet përpara marrjes në konsideratë të pranueshmërisë së kërkesës nga Dhoma, edhe pse vendimi i Gjykatës së Lartë

Administrative Ushtarake në të cilën Qeveria bazon argumentet e saj, është dorëzuar para se atyre t'u ishte komunikuar lënda. Për më tepër, ata nuk përmendin rrethana të veçanta që mund t'i lirojnë nga detyrimet e tyre në përputhje me kërkesat e Rregullores 55. Gjykata arsyetoi se Autoriteteve nuk u lejohet të ngrenë kundërshtime paraprake në këtë fazë të procedurave, në bazë të statusit të viktimës dhe për këtë refuzoi kërkesat e tyre.

A. Në lidhje me nenin 2 të Konventës

Gjykata vërejti se çështja në fjalë ka të bëjë vetëm me aspektet procedurale të nenit 2 dhe ankesat në lidhje me aspektin thelbësor të këtij neni u deklaruan të papranueshme nga Dhoma.

Gjykata vuri në dukje se më 30 qershor 2004, shërbimi i prokurorisë kishte përfunduar hetimet dhe kishte nxjerrë një vendim për mos ndjekjen penale. Më 14 tetor 2004, Gjykata Ushtarake e pranoi kundërshtimet e kërkuësve dhe urdhëroi kryerjen e një hetimi shtesë. Shërbimi i prokurorisë komunikoi raportin e tij më 8 dhjetor 2004, pas kryerjes së masave plotësuese hetimore. Më 17 dhjetor 2004, Gjykata Ushtarake hodhi poshtë ankesën e kërkuësve. Në këto rrethana, Gjykata konstatoi se autoritetet kishin marrë masa të mjaftueshme për mbledhjen dhe sigurimin e provave lidhur me rastin në fjalë.

Në lidhje me pavarësinë e hetimeve të kryera nga prokurori ushtarak, Gjykata theksoi se ky i fundit nuk kishte asnjë lidhje hierarkike ose në rastin e kundërt në lidhje me të dyshuarit e mundshëm ose xhandarët në të njëjtën pozitë, apo edhe me xhandarmërinë më të lartë. Prokurori ushtarak mblodhi gjithë dëshmitë që ishin të nevojshme për tu marrë, dhe për rrjedhojë ai nuk mund të kritikohet për dështimin në marrjen e një mase hetuese të veçantë.

Në lidhje me pavarësinë e shqyrtimit të kryer nga Gjykata Ushtarake, Gjykata vuri në dukje se, duke pasur parasysh rregulloret në fuqi në atë kohë, kishte disa faktorë që vinin në dyshim pavarësinë ligjore të Gjykatës Ushtarake, e cila ishte thirrur për të shqyrtuar ankesën e kërkuësve kundër vendimit të prokurorisë për mos kryerjen e ndjekjes penale.

Së pari, një nga tre gjyqtarët e kësaj gjykate ishte oficer shërbimi dhe nuk përmbushte të njëjtin kriter pavarësie si dy gjyqtarët e tjerë. Më tej, si prokurorët ashtu dhe gjyqtarët ushtarakë në atë kohë ishin edhe objekt vlerësimi nga komandanti i njësisë ushtarake në lidhje me ushtrimin e detyrave të tyre. Përkundrajt një sërë masash mbrojtëse në lidhje me pavarësinë, sistemi për vlerësimin e gjyqtarëve ishte i tillë që lë shkas për dyshime lidhur me pavarësinë e tyre brenda kuptimit të Kushtetutës.

Gjykata konstatoi, se në bazë të nenit 2, këto rrethana në vetvete nuk ishin të mjaftueshme për të konkluduar se hetimi kishte mungesë të pavarësisë. Neni 2 nuk kërkon pavarësi absolute, dhe për më tepër, pavarësia e hetimit duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të rastit objekt gjykimi.

Në këtë drejtim, Gjykata vuri në dukje se anëtarët e gjykatës nuk kishin lidhje hierarkike ose të qartë me xhandarët në po atë pozicion ose me xhandarmërinë në përgjithësi, ashtu si dhe Gjykata Ushtarake në fjalë pjesë e rrethit gjyqësor, e cila ndodhej nën juridiksionin e forcave ajrore. Gjykata vuri në dukje se nuk ka pasur asgjë të dyshimtë në sjelljen e gjykatës dhe gjyqtarëve për të treguar se këta të fundit kanë qenë të prirur për mos hedhjen dritë mbi rrethanat e vdekjes, për të pranuar pa dyshuar mbi përfundimet e paraqitura ose për të penguar nxitjen e hetimeve kundër autorëve të mundshëm.

Nga ana tjetër, gjykata kishte pranuar ankimin e kërkuësve, duke urdhëruar hetime plotësuese për të provuar besueshmërinë e hipotezës

për vetëvrasje aksidentale siç është paraqitur nga prokurori. Ajo ishte ngritur në bazë të masave të mëtejshme hetimore, duke përfshirë në këtë mënyrë një rindërtim të ngjarjeve, por pa rezultat pasi Gjykata Ushtarake në fund të fundit e kishte hedhur poshtë ankesën e kërkuësve. Duke pranuar se subjektet që hetuan çështjen nuk mund të konsiderohen se gëzonin pavarësi të plotë ligjore, Gjykata konstatoi se hetimi kishte qenë mjaft i pavarur brenda kuptimit të nenit 2 të Konventës.

Në këtë drejtim theksohet se vdekja e Cihan Tunç nuk ka ndodhur në rrethana të cilat *a priori* mund sjellin dyshime kundër forcave të sigurisë si institucion, si për shembull në rastin e vdekjeve që vijnë nga përplasjet që përfshijnë përdorimin e forcës në demonstrata, policore dhe operacionet ushtarake ose në rastet e vdekjeve të dhunshme gjatë ndalimit nga policia. Edhe mbi bazën e hipotezës penale të ngritur, e cila ishte më tepër favorizuese për kërkuësit, sërish dyshimet ranë mbi M.S. në vend që të binin mbi autoritetet. Por fakti është se M.S. ishte rekrut i thjeshtë, dhe jo oficer i ushtrisë.

Në përfundim, Gjykata konstatoi se hetimi i kryer në rastin në fjalë ishte mjaft i plotë dhe i pavarur dhe se kërkuësit ishin të përfshirë në të në një shkallë të mjaftueshme për mbrojtjen e interesave të tyre dhe për garantimin e të drejtave. Për rrjedhojë nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin procedural.

Gjykata konstatoi se kërkesa ishte haptazi e pabazuar, duke konstatuar se bindjet politike, që mund të luajnë një rol në procesin e emërimit të gjyqtarëve, nuk mund të ngrinin në vetvete dyshime legjitime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre

FILIPPINI KUNDËR SAN MARINOS

(Kërkesa nr. 10526/02)

26 gusht 2003

Ndikimi i jashtëm

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi, që u ndoq penalisht për shpifje, u dënua me gjobë. Ai pretendoi se fakti që gjyqtarët e San Marinos u emëruan nga Parlamenti do të thoshte se çështja e tij nuk mund të shqyrtohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

VENDIMI I GJYKATËS

Gjykata konstatoi papranueshmërinë e kërkesës si haptazi të pabazuar, duke konstatuar se bindjet politike, të cilat mund të luajnë një rol në procesin e emërimit të gjyqtarëve, nuk mund të ngrinin në vetvete dyshime legjitime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre. Në veçanti, Gjykata vuri në dukje se fakti që gjyqtarët u zgjedhën nga Parlamenti nuk ndikoi në pavarësinë e tyre pas emërimit, pasi ata nuk iu nënshtruan asnjë presioni apo marrjes së udhëzimeve nga Parlamenti.

Ligji në fjalë i San Marinos përcaktonte statusin e gjyqtarëve në këtë kuptim dhe vetëm fakti që gjyqtarët emëroheshin nga Parlamenti

nuk justifikonte pretendimin se Parlamenti ndikonte tek gjyqtarët në kontekstin e kompetencave të tyre gjyqësore. Në rastin konkret, nuk kishte asnjë arsye objektive për të ngritur dyshime se gjyqtarët që ishin marrë me çështjen në fjalë nuk kishin vepruar në përputhje me statusin e tyre ligjor. Së fundmi, kërkuesi nuk ngriti pretendonte se gjyqtarët në fjalë kishin vepruar sipas udhëzimeve të Parlamentit ose kishin treguar njëanshmëri.

Ndërhyrja nga palët në proces

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6, bazuar në dyshimin e arsyeshëm të kërkuetit në lidhje me paanshmërinë e N.I. në gjykimin në arbitrazh

BEG SH.P.K KUNDËR ITALISË

(Kërkesa nr. 5312/11)

20 maj 2021

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi, Beg S.p.a., është një kompani e regjistruar në Itali, e cila operon në sektorin e ndërtimit dhe menaxhimit të hidrocentraleve dhe instalimit të impianteve të energjisë së rinovueshme. Në vitin 1996, kompania kërkuese kontaktoi ENEL-in (ish-ofrues shtetëror i energjisë elektrike dhe gazit) nëse do të ishte e interesuar të shpërndante energjinë e prodhuar nga një hidrocentral që po ndërtonte në Shqipëri. Në atë kohë N.I. ishte zëvendës president dhe u caktua edhe në bordin e ENEL. Në vitin 2000, kjo e fundit dha pëlqimin dhe nënshkroi një marrëveshje midis Beg S.p.a. dhe ENELPOWER S.p.a. (e cila kohët e fundit ishte ndarë nga ENEL, por vazhdonte

ende të ishte në pronësi të saj). Në bazë të marrëveshjes, në rast mosmarrëveshje mes palëve çështja do të kalonte për gjykim Dhomës së Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Romës (ACR).

Mosmarrëveshja e parë lindi në vitin 2000 kur ENELPOWER kishte pakënaqësi për auditimin e koncesionit të kompanisë kërkuese në Shqipëri. Procedurat e arbitrazhit u hapën nga kompania kërkuese, e cila kërkoi zgjidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe dëmshpërblim prej rreth 130 milionë euro. Më 28 dhjetor 2000, ENELPOWER emëroi N.I. si përfaqësuesin e saj në arbitrazh. Gjatë kësaj periudhe N.I. përfaqësonte ENEL-in në një mosmarrëveshje civile. Sipas Qeverisë, më 25 nëntor 2002, ACR-ja hodhi poshtë të gjitha kundërpaditë e kompanisë kërkuese, por përfaqësuesi në arbitrazh i caktuar nga kërkuesi, G.G., refuzoi të nënshkruante; sipas kërkuesit, nuk u arrit të merrej asnjë vendim dhe G.G. asnjëherë nuk ka shprehur vullnetin për të mos nënshkruar. Beg S.p.a. u vendos në dijeni se N.I. kishte punuar si avokat për ENEL. Më 25 nëntor 2002, ACR-ja dha vendimin e saj kundër, duke hedhur poshtë ankesat e mëtejshme të G.G., duke përfshirë këtu dhe kërkesën për tërheqjen e N.I. Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Romës hodhi 2 herë poshtë kërkesat për largimin e N.I.

Në një datë të papërcaktuar, kërkuesi paraqiti një padi kundër ACR-së për neglizhencë, duke kërkuar kompensim prej 374,482.91 euro, padi e cila u hodh poshtë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Romës. Ndërsa tjetra, Gjykata vendosi se ACR nuk mund të mbante përgjegjësi për mos deklarin e konfliktit të interesit nga ana e N.I. dhe nuk kishte asnjë detyrim të kërkonte këtë gjë. Kompania kërkuese apeloj kundër vendimit të arbitrazhit. Ky ankim u rrëzua nga Gjykata e Apelit në Romë dhe më vonë, më 15 nëntor 2010 edhe nga Gjykata e Lartë.

Gjykata e fundit deklaroi se lidhja ndërmjet N.I. dhe ENELPOWER që ka të bëjë me “përafrim të interesave” nuk ishte arritur të provohej. Kërkuesi paraqiti kërkesë në GJEDNJ për shkelje të nenit 6 (e drejta

për një proces të rregullt) të KEDNJ, me pretendimin se përfaqësuesi në arbitrazh N.I., nuk kishte qenë i paanshëm për shkak të lidhjeve të tij profesionale me ENEL.

VENDIMI I GJYKATËS

Neni 6

Qeveria argumentoi se duke rënë dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me arbitrazh, palët kishin hequr dorë vullnetarisht nga disa nga të drejtat e tyre të garantuara nga Konventa. Gjykata përsëriti se neni 6 § 1 garantonte gjithsecilit të drejtën që çdo pretendim në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij/saj civile të paraqitet përpara një gjykate. Gjykata duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Nuk kishte asnjë mosmarrëveshje ndërmjet palëve se arbitrazhi ishte pranuar nga palët vullnetarisht. Megjithatë, Gjykata theksoi se vendimi i arbitrazhit nga ana e Beg S.p.a. ishte dhënë përpara emërimit të N.I. si përfaqësues në arbitrazh.

Gjykata vendosi se arsyet e paraqitura nga gjykatat vendase dhe qeveria bazoheshin në prezumimin – se kompania kërkuese kishte pasur dijeni përsa i takon aktiviteteteve profesionale të N.I. – fakt që nuk ishte i provuar realisht. Ajo gjithashtu deklaroi se kompania kërkuese nuk kishte hequr dorë nga e drejta e saj për të garantuar pavarësinë e procedurave të arbitrazhit dhe pajtueshmërinë me ligjin italian. Gjykata evidentoi se N.I. kishte qenë avokat i ENEL-it kur u emërua si përfaqësues në arbitrazh dhe se kompania ENELPOWER ishte 100% në pronësi të saj duke pasur lidhje të ngushta në atë kohë. Gjithashtu, duke pasur parasysh se N.I. ka qenë më parë zëvendës president në bordin e ENEL-it, Gjykata vlerësoi se dyshimi i arsyeshëm i Beg S.p.a. në lidhje me paanshmërinë e N.I. ishin të justifikuar objektivisht. Për rrjedhojë, Gjykata konkludoi se ka pasur shkelje të Konventës.

Neni 41

Gjykata vendosi se shteti Italian duhej ti paguante kërkuetit 15,000 euro në lidhje me dëmin jo-material dhe 35,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

Ndikimet nga brenda gjyqësorit

Procedurat e falimentimit kundër rafinerisë më të madhe të naftës në Ukrainë të nisura nga një kompani private përfshinë shkelje të shumta të nenit 6 § 1 për shkak të kohëzgjatjes së tyre dhe mungesës së pavarësisë, paanshmërisë dhe sigurisë ligjore

AGROKOMPLEKS KUNDËR UKRAINËS

(Kërkesa nr. 23465/03)

6 tetor 2011

FAKTET KRYESORE

Kërkuetsja, Agrokomples, ishte një kompani private me seli në Ukrainë e cila, në kohën e ngjarjeve, bënte biznes me kompani ruse të përfshira në operacione shkëmbimi, përfshirë shkëmbimin e materialeve bazë ushqimore të Ukrainës me naftë bruto të Rusisë dhe shitjen e produkteve të kompletuara të naftës. Në fillim të viteve '90, kompania kërkuetsë furnizoi me 375,000 ton naftë bruto rafinerinë më të madhe të naftës në atë kohë në Ukrainë, shumica e së cilës ishte në pronësi të shtetit – më vonë e riemërtuar LyNOS – për ta përpunuar. Në vitin 1993, rafineria i dorëzoi kompanisë kërkuetsë vetëm një pjesë të vogël të produkteve të naftës për të cilat ishte rënë dakord. Në mars 1993 dhe nëntor 1994, Gjykata e Lartë e Arbitrazhit (“GjLA”), pas padisë së bërë nga kompania kërkuetsë, konfirmoi detyrimet kontraktuale të

rafinerisë dhe e urdhëroi këtë të fundit që të dorëzonte produktet e naftës për të cilat ishte rënë dakord. Në vitin 1995, Departamenti i Shtetit për Naftë, Gaz dhe Industrinë e Rafinimit të Naftës gjeti se pretendimet e kompanisë kërkuese kishin baza të forta, dhe theksoi se arsyeja kryesore për dështimin e rafinerisë për t'iu përmbajtur detyrimeve të veta ishte devijimi i papaguar i produkteve të naftës nga autoritetet rajonale drejt industrive lokale në vitin 1993.

Në korrik 1996, GjLA i caktoi kompanisë kërkuese kompensim për mos-zbatimin për një kohë të gjatë të vendimeve në favor të saj. Gjithashtu në korrik, kompania kërkuese nisi procedurën e falimentimit kundër LyNOS, duke iu referuar mos-zbatimit të vendimeve në favor të saj. Në një vendim përfundimtar të 2 korrikut 1998, GjLA e caktoi borxhin që LyNOS i detyrohej kompanisë kërkuese në shumën 216,150,544 hrivnja ukrainase (UAH) (të barasvlershme me afërsisht 19.5 milionë euro).

Megjithatë, më vonë në korrik 1998, Qeveria krijoi një ekip (taskforcë) me përfaqësues të autoriteteve të larta shtetërore për të përcaktuar arsyet e borxheve të LyNOS-it dhe për të analizuar pasojat e tyre.

Në raportin e tij të gushtit 1998, ekipi këshilloi se ishte e nevojshme të verifikohej shuma e punëve të prapambetura, dhe pas kësaj u urdhërua një auditim nga Zv/Kryeministri i Parë. Në raportin e tij të prillit 2000, Departamenti i Auditimit i Rajonit Lugansk doli me përfundimin se gjetjet e GjLA-së më 2 korrik 1998 ishin në kundërshtim me ligjet e aplikueshme dhe borxhi i LyNOS-it në fakt ishte 36,401,894 UAH.

LyNOS u mbështet mbi atë përfundim dhe bëri kërkesë në GjLA për rishikimin e vendimit të 2 korrikut 1998. Ndërkohë që në shtator 2000 GjLA gjeti se raporti i Departamentit të Auditimit nuk përmbante informacione të reja dhe konfirmoi vendimin që përcaktonte shumën përfundimtare të borxhit, kryetari i gjykatës më

pas udhëzoi zëvendësit e tij që ta rishikonin atë gjetje. Në qershor 2001, GjLA e reduktoi borxhin në 97,406,920 UAH dhe, pas apelit të kompanisë kërkuese, Gjykata Komerciale e Apelit në Donetsk e reduktoi atë më tej në 90,983,077 UAH në tetor 2001.

Apelet e kompanisë kërkuese kundër atij vendimi dhe sërish një marrëveshje miqësore mes LyNOS dhe kreditorëve të saj, sipas së cilës pretendimet e kreditorëve do të zgjidheshin përmes shkëmbimit të tyre me asetet e borxhliut, qenë të pasuksesshme. Në nëntor 2004, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e kompanisë kërkuese për leje për të apeluar në kasacion.

Në shumë raste, LyNOS iu ankua disa autoriteteve shtetërore për vendimet e gjykatave, dhe aktorë të ndryshëm shtetërorë ndërhyjnë në procedura në emër të saj (LyNOS). Në mënyrë të veçantë, në shtator 1998, Zv/Kryeministri i Parë i kërkoi kryetarit të GjLA-së të merrte në shqyrtim gjetjet e task forcës në lidhje me nevojën e rivlerësimit të borxhit, “duke pasur parasysh rëndësinë [e LyNOS] për ekonominë dhe sigurinë e Shtetit”. Në dhjetor 2000, Presidenti i Ukrainës përcolli një letër nga LyNOS drejtuar kryetarit të GjLA-së në të cilën LyNOS ankohej me të madhe për “pretendimet e ekzagjeruara” të kompanisë kërkuese në procedurat e falimentimit. Kryetari i GjLA-së u përgjigj me raportet e statusit të procedurave dhe me shpjegimin e masave të marra.

VENDIMI I GJYKATËS

Neni 6 § 1

Kompania kërkuese u ankua sipas nenit 6 § 1 për kohëzgjatjen e tepruar dhe padrejtësinë e procedurave të falimentimit, duke pretenduar se gjykatat nuk ishin të pavarura ose të paanshme duke pasur parasysh presionin e lartë politik për shkak të interesave të mëdha të autoriteteve shtetërore në rezultatin e tyre. Më tej ajo u

ankua se gjykatat kishin shkelur parimin e sigurisë ligjore duke prishur vendimin përfundimtar të korrikut 1998.

Duke u mbështetur në nenin 1 të Protokollit nr. 1, ajo u ankua se nuk kishte mundësi t'i rimerrte të plota 375,000 tonët e naftës që ia kishte furnizuar rafinerisë. Neni 6 § 1 Gjykata vuri re se autoritete të shumta ukrainase kishin ndërhyrë në procedurat gjyqësore në disa raste. Ato ndërhyrje kishin ndodhur në mënyrë të hapur dhe këmbëngulëse, shpesh të kërkuara shprehimisht nga kundërshtarja e kompanisë kërkuese, LyNOS. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata i ka dënuar fuqimisht përpjekjet e autoriteteve jogjyqësore për të ndërhyrë në procedurat e gjykatës, duke i konsideruar ato në papajtueshmëri me nocionin e “gjykatës së pavarur dhe të paanshme” të nenit 6 § 1.

Ajo theksoi se fushëveprimi i detyrimit të Shtetit për të garantuar gjykimin nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme nuk ishte i kufizuar tek gjyqësori, por nënkuptonte edhe detyrimin e çdo autoriteti tjetër shtetëror për të respektuar dhe për t’iu përmbajtur gjykimeve dhe vendimeve të gjykatave. Më tej, pavarësia gjyqësore kërkonte që gjyqtarët individualë të ishin të çliruar nga ndikimet e papërshtatshme, përfshirë ato brenda gjyqësorit. Fakti që kryetari i GjLA-së i kishte dhënë udhëzime të drejtpërdrejta zëvendësve të tij që të rishqyrtonin vendimin e gjykatës të shtatorit 2000 ishte në kundërshtim me parimin e pavarësisë së brendshme gjyqësore. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 për shkak të mungesës së pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatave.

Më tej, Gjykata përsëriti se siguria ligjore, një aspekt themelor i shtetit të së drejtës, kërkonte që kur gjykatat e kanë vendosur përfundimisht një çështje vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje. Në rastin konkret, vendimi i korrikut 1998 ishte përcaktim gjyqësor përfundimtar i shumës së punëve të pakryera që LyNOS i kishte borxh. Megjithatë, autoritetet jogjyqësore të Shtetit e kishin vënë në pikëpyetje atë vendim, e kishin rishikuar atë siç kishin dashur,

dhe i kishin kritikuar gjetjet e tij si të paligjshme. Për më tepër, rishikimi jogjyqësor i borxhit ishte baza mbi të cilën gjykatat e kishin rikonsideruar shumën e tij, në dëm të kompanisë kërkuese. Rihapja e çështjes përfundimisht të përcaktuar ligjore të shumës së punëve të pakryera ishte bazuar thjesht mbi faktin që autoritetet shtetërore nuk ishin dakord me të, çka përbënte shkelje flagrante të parimit të sigurisë ligjore në kundërshtim me nenin 6 § 1.

Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, Gjykata vërejt se periudha që duhet marrë në konsideratë, që nga data e hyrjes në fuqi të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Ukrainë e deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme, kishte zgjatur mbi shtatë vjet. Ndërkohë që çështja kishte qenë komplekse nga aspekti faktik dhe ligjor, vonesat e mëdha mund të shpjegoheshin me përpjekjet e autoriteteve për ta rishikuar shumën e borxhit, pavarësisht nga vendimi gjyqësor përfundimtar në lidhje me të. Asnjë vonesë procedurale nuk iu atribuua kompanisë kërkuese. Prandaj, kishte pasur gjithashtu shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave.

Neni 1 i Protokollit nr. 1

Meqenëse borxhi i LyNOS ndaj kompanisë kërkuese u konfirmua me anë të një vendimi gjyqësor përfundimtar, ai përbënte pjesë të “pasurisë” së kompanisë brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Reduktimi i tij i mëpasshëm, për shkak të rihapjes së çështjes, përbëri ndërhyrje tek e drejta e kompanisë kërkuese për gëzimin paqësor të atyre pasurive. Prishja e vendimit të GjLA-së të korrikut 1998 e lëkundi fort mbështetjen e kompanisë kërkuese mbi një vendim gjyqësor detyrues dhe e privoi atë nga mundësia për të marrë paratë që priste të merrte në mënyrë legjitime. Pra rishikimi i shumës së borxhit vuri një barrë të tepërt mbi supet e kompanisë kërkuese dhe ishte në papajtueshmëri me nenin 1 të Protokollit nr. 1.

Duke pasur parasysh gjetjet e Gjykatës që gjykatave vendase në këtë çështje u mungoi pavarësia dhe paanshmëria e kërkuar, ajo konsideroi se nuk ishte vënë “ekuilibri i drejtë” mes nevojave të interesit publik dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e kompanisë për gëzimin paqësor të pasurive të veta. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Neni 41

Gjykata urdhëroi shtetin t’i paguante kompanisë kërkuese 27,000,000 euro në lidhje me dëmin material dhe jo-materiale dhe 30,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

4. GARANCITË OBJEKTIVE PËR KARRIERËN E GJYQTARËVE

Mbarimi i parakohshëm i mandatit të kërkuesve, si nënkryetarë të një gjykate nuk ishte shqyrtuar as nga një gjykatë e zakonshme, as nga një organ duke derivuar në shkelje të vetë thelbit të të drejtës së aksesit në gjykatë.

BRODA DHE BOJARA KUNDËR POLONISË

(Kërkesat nr. 26691/18 dhe 27367/18)

29 qershor 2021

FAKTET KRYESORE

Kërkuesit, z. Mariusz Broda dhe znj. Alina Bojara, janë shtetas Polakë të cilët kanë lindur respektivisht në 1969 dhe 1960 dhe jetojnë në Kielce (Poloni). Z. Broda kishte ushtruar funksionin e gjyqtarit nga viti 1998 dhe znj. Bojara që nga viti 1988 dhe secili prej tyre ishin emëruar në Gjykatën Rajonale të Kielce respektivisht më 14 prill 2014 dhe 25 tetor 1995. Në tetor dhe maj 2014, ata u emëruan si nënkryetarë me një mandat 6 vjeçar në të njëjtën Gjykatë nga Ministri i Drejtësisë.

Më 2 janar 2018, zëvendës Sekretari i Shtetit pranë Ministrisë të Drejtësisë i informoi ata me shkresë për përfundimin e mandatit të tyre si nënkryetar, në zbatim të nenit 17 § 1 të ligjit të datës 12 korrik 2017 për ndryshimin e ligjit për organizimin e gjykatave të

zakonshme. Z. Broda dhe znj. Bojara i kërkuan Zëvendës Sekretarit të Shtetit pranë Ministrisë të Drejtësisë që t'i informonte për arsyet e vendimeve ministrore që ishin marrë dhe mjetet juridike në dispozicion të tyre. Në përgjigje ata u njoftuan se në bazë të nenit 17 të Ligjit të datës 12 korrik 2017, Ministri i Drejtësisë është autorizuar, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, domethënë nga data 12 gusht 2017 deri më 12 shkurt 2018, të shkarkojë drejtuesit e gjykatave pa qenë nevoja të plotësojnë kushtet e parashikuara në nenet 23 deri në 25 të Ligjit për Pusp, që është në fuqi nga 12 gushti 2017, dhe pa asnjë detyrim që ministri t'ju komunikojë arsyet e vendimit të tij të interesuarve.

Gjithashtu, ata u informuan se ndaj vendimeve të largimit të Ministrisë të Drejtësisë nuk mund të bëhej ankim. Z. Broda dhe znj. Bojara përsëritën kërkesën e tyre. Ata argumentuan se përmes letrave nga ana e ministrisë dilte qartë që largimi i tyre kishte ardhur për shkak të pretendimeve të “mangësive administrative” në Gjykatën Rajonale të Kielce dhe se mbajtja e tyre në detyrë ishte konsideruar si e dëmshme për “funksionimin e duhur të gjykatave”. Ata konsideruan se këto deklarata ishin krejtësisht të pabaza dhe dëmtonin reputacionin e tyre si nënkryetarë dhe gjyqtarë. Ata pohuan se kryerja e detyrave të tyre nuk ishte vënë kurrë në pikëpyetje, por përkundrazi, ishte vlerësuar gjithmonë brenda profesionit të tyre.

Më 16 maj dhe 13 qershor 2018, Ministria e Drejtësisë informoi me letër z. Broda dhe znj. Bojara se Ministri i Drejtësisë kishte ushtruar diskrecionin e tij për të shkarkuar kryetarët e gjykatave në përputhje me nenin 17 § 1 të ligjit të datës 12 korrik 2017 dhe se ata kishin keqinterpretuar deklaratën ministrore të arsyeve që kishin të bënë me ta. Ministria shtoi se ministri kishte të drejtë të zbatonte masat e ndryshme që kishte në dispozicion jo vetëm për të korigjuar mangësitë që ishin vërejtur brenda gjykatave, por edhe për të bërë përmirësime edhe kur situata ishte e kënaqshme. Më 1 prill 2019, zonja Bojara doli në pension të parakohshëm.

Duke u mbështetur në nenin 6 § 1 kërkuessit u ankuan se ishin shkarkuar nga postet e tyre si nënkryetarë të një gjykate, duke pretenduar se largimi i tyre kishte qenë i paligjshëm dhe arbitrar dhe se nuk kishte pasur mjet juridik për të kundërshtuar këtë vendim.

VENDIMI I GJYKATËS

Neni 6 § 1

Gjykata vuri në dukje se vendimet e Ministrit të Drejtësisë për largimin e kërkuessve nga detyra nuk mund të apelohehin. Nga parashtrimet e Qeverisë mund të evidentohet se përjashtimi i apelit kundër largimit kishte për qëllim të lehtësonte zbatimin e reformave ministrore të sistemit gjyqësor polak. Gjykata theksoi rëndësinë në rritje që Këshilli i Evropës dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare, dhe praktika gjyqësore e gjykatave ndërkombëtare, i kushtojnë parimit të respektimit të drejtësisë procedurale në çështjet që kanë të bëjnë me heqjen ose shkarkimin e gjyqtarëve, dhe në veçanti ndërhyrjes të një autoriteti të pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ në çdo vendim që ndikon në përfundimin e mandatit të gjyqtarit. Gjykata evidentoi se kërkuessit ishin larguar para kohe nga postet e tyre si drejtues gjykatash nga Ministri i Drejtësisë sipas nenit 17 të Ligjit të 12 korrikut 2017. Ky legjislacion kishte qenë kalimtar dhe i kishte akorduar pushtet Ministrit për të larguar drejtuesit e një gjykate sipas diskrecionit të tij, pa u pasur në vëmendje kushtet thelbësore ose procedurale.

Vendimet e kundërshtuara të Ministrit të Drejtësisë nuk kishin pasur arsye dhe nuk ishin objekt shqyrtimi nga një organ i jashtëm, i pavarur nga ministri përkatës. Në bazë të të gjithë informacionit që kishte në dispozicion, Gjykata arriti në përfundimin, së pari, se largimi i kërkuessve ishte bazuar në një dispozitë legjislative të dyshimtë përse i takon përputhshmërisë me kërkesat e shtetit të së drejtës dhe, së dyti,

masa e marrë nuk bazohej në ndonjë prej garancive themelore të të drejtës procedurale.

Vendimet ministrore për largimin e kërkuesve nuk ishin të arsyetuara. Gjykata vuri në dukje se kuadri ligjor kombëtar i zbatueshëm në kohën e largimit të kërkuesve nuk i mbronte ata në asnjë formë ndaj përfundimit të parakohshëm dhe arbitrarisht të detyrave të tyre si nënkryetarë të një gjykate. Megjithatë, gjyqtarët duhej të gëzonin mbrojtje kundër veprimeve arbitrare nga ekzekutivi dhe vetëm një rishikim i ligjshmërisë së atij vendimi nga një organ i pavarur gjyqësor do të ta bënte atë të drejtë efektive.

Gjykata theksoi rëndësinë e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimit të procedurave në rastet që kanë të bëjnë me karrierën e gjyqtarëve. Ajo vërejti se kuadri ligjor kombëtar në fuqi lidhur me largimin e kërkuesve nuk sqaronte kushtet në të cilat krerët e një gjykate mund të shkarkoheshin nga detyra, me përjashtim të parimit që një gjyqtari duhet t'i garantohet siguria e mandatit gjatë ushtrimit të funksionit të tij/saj.

Pothuajse të gjitha kompetencat lidhur me çështje të tilla ishin të përqendruara në duart e përfaqësuesit të ekzekutivit dhe organet e vetë administrimit gjyqësor në përgjithësi dhe Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit, në veçanti, ishin përjashtuar nga procesi. Më tej, Gjykata vuri në dukje se kërkuesve nuk iu ishte dhënë e drejta për të bërë përfaqësime dhe nuk ishin informuar për arsyet e vendimeve të ministrive. Së fundi, nuk kishte pasur rishikim të vendimeve të largimit nga një organ që të ishte i pavarur nga Ministria e Drejtësisë.

Gjykata vuri në dukje se në vëzhgimet e saj qeveria e paditur kishte deklaruar se kuadri legjislativ për shkarkimin e parakohshëm të drejtuesve të gjykatave u kishte mundësuar atyre të anashkalojnë procedurat përkatëse. Megjithatë, Gjykata evidentoi se ishin pikërisht këto procedura që siguruan garancitë në bazë të parimit, të sanksionuar

në nenin 6 të Konventës, që një “gjykatë e pavarur” – sipas kuptimit të kësaj dispozite të Konventës – duhet të sigurojë domosdoshmërisht sigurinë e mandatit, pavarësisht nëse gjyqtarit/es në fjalë i janë hequr nga detyrat e tij/saj gjyqësore apo vetëm funksionet administrative që ushtron brenda gjyqësorit. Duke pasur parasysh rëndësinë e rolit të gjyqtarëve në mbrojtjen e të drejtave të Konventës, Gjykata e konsideroi të domosdoshme vendosjen e masave mbrojtëse procedurale për të siguruar që autonomia gjyqësore të mbrohej siç duhet nga ndikimi i padrejtë. Besimi i publikut në gjyqësor ishte në rrezik.

Duke qenë se mbarimi i parakohshëm i mandatit të kërkuesve si nënkryetarë të një gjykate nuk ishte shqyrtuar as nga një gjykatë e zakonshme, as nga një organ tjetër që ushtronte funksione gjyqësore, shteti i paditur kishte shkelur vetë thelbin e të drejtës së aksesit të kërkuesve në gjykatë. Për këtë, ka pasur shkelje të së drejtës së aksesit në gjykatë të garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës.

Neni 41

Polonia duhej ti paguante secilit prej kërkuesve vlerën prej 20,000 euro në lidhje me dëmin material dhe jo-material.

Gjykata theksoi rëndësinë e pavarësisë së gjyqësorit dhe masave mbrojtëse procedurale në lidhje me vendimet që ndikojnë në karrierën e një gjyqtari

BILGEN KUNDËR TURQISË

(Kërkesa nr. 1571/07)

9 mars 2021

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi, Hüseyin Cahit Bilgen, është shtetas turk, i cili ka lindur në 1952 dhe jeton në Ankara. Në 1979 kërkuesi u emërua gjyqtar relator në Gjykatën e Lartë Administrative. Pas një karriere të larmishme gjyqësore, në vitin 1998 kërkuesi u bë kryetar në Divizionin e Tetë të Gjykatës Administrative të Ankarasë. Në vitin 2005, Këshillit të Lartë të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (KLGJP) e emëroi kërkuesin si gjyqtar në Gjykatën Administrative Rajonale të Ankarasë, pa marrë pëlqimin e tij.

Ankimimi i z. Bilgen u refuzua nga Bordi i Ankimimeve në një vendim që nuk mund të ankimohej në gjykatat e zakonshme. Në vitin 2006 ai u transferua në Gjykatën Administrative Rajonale të Sivas. Kjo e fundit ishte një gjykatë e një shkalle më të ulët se pozicionet që kishte mbajtur më parë. Për transferimin e tij nuk u dhanë arsye. Qeveria paraqiti një vlerësim të performancës profesionale të kërkuesit të kryer në vitin 2005, në të cilin atij i ishte dhënë një vlerësim “mesatar” dhe kishte deklaruar se “... do të ishte e përshtatshme ta hiqte atë nga posti i kryetarit të gjykatës dhe ta zhvendoste në një gjykatë tjetër përveç se në Ankara”.

Kërkuesi parashtrroi se për shkak të atij vlerësimi atij i ishte mohuar rritja e pagës. Më 27 korrik 2006, kërkuesi aplikoi për rishikimin e vendimit për ta transferuar në gjykatën e Sivas në HSYK. Ai argumentoi se vendimet ishin marrë pa pëlqimin e tij, duke cenuar

pavarësinë gjyqësore dhe duke dëmtuar reputacionin e tij profesional. Duke qenë se Sivas ishte 440 km larg shtëpisë së tij, caktimi i tij atje kishte mohuar të drejtën për gëzimin e jetës familjare.

Në përgjigjën e saj, Ministria e Drejtësisë deklaroi se lëvizjet janë bërë në bazë të nevojave dhe se ky vendim nuk mund të ankimohej në gjykatat e zakonshme. Në vitin 2007, kërkuesi paraqiti kërkesë në Ministri për të zbuluar arsyet e vlerësimit të tij “mesatar”. Ministria u përgjigj se formularët e vlerësimit ishin të klasifikuar dhe nuk binin në fushëveprimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit. Gjithashtu në vitin 2007, pas një kërkesë të paraqitur nga z. Bilgen, Bordi i Inspektimit të Drejtësisë deklaroi se ai ishte informuar për vlerësimin e tij dhe i ishte paraqitur një listë me rekomandime për përmirësim, të cilat në kohën që ishte vënë në dijeni, nuk i kishte kundërshtuar. Në vitin 2007 kërkuesi aplikoi për pension të parakohshëm.

VENDIMI I GJYKATËS

Gjykata përsëriti se e drejta e aksesit në gjykatë nuk është një e drejtë absolute dhe mund të kufizohet me ligj kur qëllimi ishte legjitim dhe kufizimi proporcional. Gjithashtu, Gjykata theksoi rëndësinë e ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së gjyqësorit, duke vënë në dukje se kuadri ligjor në Turqi nuk u siguronte gjyqtarëve një garanci gjeografike. Në këtë mënyrë, ajo konsideroi se dispozitat e Kushtetutës Turke dhe dispozitat përkatëse të brendshme që garantojnë pavarësinë e gjyqësorit në Turqi i kishin siguruar kërkuesit, i cili kishte qenë gjyqtar në atë kohë, të drejtën e mbrojtjes nga transferimi arbitrar. Gjykata vlerësoi se mund t’u referohej normave ndërkombëtare të pavarësisë së gjyqësorit në interpretimin e ekzistencës së një të drejte në nivel të brendshëm.

Në përfundim, Gjykata u shpreh se e drejta në fjalë konsiderohej si çështje civile. Gjykata përsëriti se në parim, mosmarrëveshjet mes nëpunësve civilë dhe shtetit binin në fushëveprimin e nenit 6 të

Konventës, përveçse kur plotësoheshin dy kushte, siç përcaktohet në *Vilho Eskelinen dhe të tjerë*.

Kushtet ishin që legjislacioni të përjashtonte shprehimisht aksesin në një gjykatë për të zgjidhur mosmarrëveshjen dhe përjashtimi të ishte i bazuar objektivisht në interes të shtetit. Edhe pse në rastin konkret legjislacioni përkatës kishte përjashtuar shprehimisht aksesin në gjykatë, Gjykata konstatoi, në aspektin e rolit të veçantë të gjyqësorit dhe rëndësisë së ndarjes së pushteteve, se përjashtimi i anëtarëve të gjyqësorit nga garancitë e nenit 6 në çështjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit të tyre nuk mund të justifikohen mbi baza objektive në interes të shtetit.

Gjykata vuri në dukje se vendimi për transferimin e kërkuesit nuk ishte shqyrtuar dhe as nuk ishte i hapur për rishikim nga një gjykatë e zakonshme ose organ tjetër që ushtronte pushtetin gjyqësor, në përputhje me Kushtetutën. Prandaj, mungesa e shqyrtimit gjyqësor ishte e ligjshme. Gjykata duhej të vendoste nëse mungesa e shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të transferimit gjyqësor ishte në përputhje me Konventën. Gjykata përsëriti rëndësinë e pavarësisë së gjyqësorit dhe masave mbrojtëse procedurale për të mbrojtur këtë pavarësi në lidhje me vendimet që ndikojnë në karrierën e një gjyqtari. Ndër të tjera, ajo vuri në dukje, diskursin ndërkombëtar për përdorimin e papërshtatshëm të mekanizmit të transferimit të gjyqtarëve në Turqi.

Si konkluzion, Gjykata theksoi dhe një herë që ajo që ishte në rrezik ishte besimi në gjyqësor dhe pavarësia personale e gjyqtarëve. Ajo arriti në përfundimin se mungesa e aksesit të kërkuesit në gjykatë nuk kishte ndjekur një qëllim legjitim. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 12,500 euro në lidhje me dëmin jo-material dhe 8,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

5. ETIKA

Një Gjykatë Apeli nuk ishte “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” sepse ajo u kryesua nga i njëjti gjyqtar në procedurën e dytë ashtu si edhe në procedurën e parë

OBERSCHLICK KUNDËR AUSTRIË

(Kërkesa nr. 11662/85)

23 maj 1991

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi ishte gazetar austriak me banim në Vjenë, dhe në atë kohë ai ishte redaktor i revistës Forum. Më 29 mars 1983, gjatë një fushate zgjedhore, z. Walter Grabher-Meyer, politikan, kishte bërë deklarata publike në lidhje me ndihmat financiare për familjet e të huajve, dhe kishte propozuar që persona të tillë duhet të marrin trajtim më pak të favorshëm sesa austriakët. Më 20 prill 1983, kërkuesi dhe disa persona të tjerë bënë ankesë penale kundër z. Grabher-Meyer. Megjithatë, prokuroria publike e Vjenës vendosi më 1 qershor 1983 që të mos e ndiqte atë penalisht.

Ditën që u dorëzua, teksti i plotë i ankesës penale u botua nga kërkuesi në Forum. Më 22 prill 1983, z. Grabher-Meyer ngriti padi private për shpifje kundër kërkuesit dhe nënshkruesve të tjerë të informacionit penal. Gjykata Rajonale e Vjenës gjeti që botimi nuk përbënte veprë penale, sepse çështja nuk kishte të bënte me atribuimin e gabuar të një sjelljeje të pandershme por vetëm me gjykimin e vlerës së një sjelljeje e cila, si e tillë, ishte përshkruar saktë.

Gjykata e Apelit e Vjenës e përbërë nga z. Cortella, si Kryetar, dhe z. Schmidt dhe z. Hagen, e prishi vendimin e mësipërm më 31 maj 1983. Ajo vendosi se botimi i atij shkrimi duhet të ketë krijuar përshtypjen tek lexuesit e thjeshtë se një sjellje e caktuar përçmuese i atribuohet z. Grabher-Meyer. Çështja iu referua sërish Gjykatës Rajonale për një procedurë të dytë, ku Gjykata mbajti seancë dëgjimore më 11 maj 1984 dhe mori vendimin përfundimtar në të njëjtën ditë. Kërkuesi u shpall fajtor për shpifje dhe u dënua me gjobë në shumën 4,000 shilinga austriake (afro 290 euro) ose, në rast mospagimi, me 25 ditë burg.

Në vendimin e saj, Gjykata Rajonale deklaroi se ajo ishte e detyruar t'i përmbahej opinionit të shprehur nga Gjykata e Apelit në vendimin e saj të 31 majit 1983. Gjykata Rajonale deklaroi se, ndërkohë që secili ishte i lirë për të raportuar në polici fakte që konsideronte se përbënin vepër penale, botimi i informacionit në këtë mënyrë duke e vënë në dispozicion të publikut të gjerë shkonte përtej thjesht raportimit të dyshimeve penale.

Më 6 shtator 1984 kërkuesi bëri kërkesë pa sukses pranë Gjykatës Rajonale për korrigjimin e procesverbalit të gjyqit i cili, sipas tij, nuk përmendte deklaratat e caktuara të z. Grabher-Meyer të cilat ishin me rëndësi për vlerësimin e provave në lidhje vërtetësinë e pretendimeve të kërkuesit. Më 17 dhjetor 1984, Gjykata e Apelit e Vjenës, e përbërë nga të njëjtit gjyqtarë si edhe në procedurën e parë të 31 majit 1983 dhe sërish nën kryesimin e z. Cortella, e rrëzoi apelin e kërkuesit kundër dënimit të tij. Gjykata e Apelit deklaroi se botimi në formën e informacionit penal kishte për qëllim që akuzat e bëra aty rreth karakterit të tij të bënin efekt veçanërisht të dukshëm tek lexuesit e thjeshtë.

VENDIMI I GJYKATËS

Kërkuesi pretendoi se ai nuk kishte pasur “seancë dëgjimore të drejtë” nga një “gjykatë e pavarur e ngritur me ligj”, brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës. Më tej, ai argumentoi se shpallja e tij fajtor për

shpifje dhe vendimet e tjera të gjykatës kishin shkelur të drejtën e tij për lirinë e shprehjes e cila garantohet me nenin 10.

Neni 6

Në lidhje me ankesën e kërkuarit për korrigjimin e procesverbalit të gjyqit dhe padrejtësinë e procedurave para Gjykatës Rajonale, nuk u gjet shkelje e nenit 6 § 1. Më pas, kërkuari argumentoi që Gjykata e Apelit e Vjenës, gjatë dëgjimit të çështjes në procedurën e dytë, nuk kishte qenë “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” dhe nuk kishte qenë “e ngritur sipas ligjit” sepse, në kundërshtim me Nenin 489 § 3 të Kodit të Procedurës Penale, ajo ishte kryesuar nga i njëjti gjyqtar si në procedurën e parë.

Para Gjykatës, kërkuari e plotësoi këtë ankesë duke pohuar se ndërkohë ai ishte bërë të besonte se jo vetëm kryetari i trupit gjykues por edhe dy gjyqtarët e tjerë ishin të njëjtit në të dy rastet. Gjykata theksoi se Kodi i Procedurës Penale parashikonte që Gjykata e Apelit nuk duhet të përfshijë, në një çështje si kjo, asnjë gjyqtar që e ka trajtuar atë më herët në procedurën e parë, dhe shprehu shqetësimin e parlamentit të vendit për të fshirë të gjitha dyshimet e arsyeshme rreth paanshmërisë së asaj gjykate. Rrjedhimisht, dështimi për t’iu përmbajtur kësaj rregulle do të thoshte se apeli i kërkuarit ishte dëgjuar nga një gjykatë paanshmëria e së cilës u njoh nga ligjet vendase si e hapur për dyshime.

Në lidhje me argumentin e Qeverisë që, duke mos konstestuar ose kundërshtuar pjesëmarrjen e kryetarit të trupit gjykues, kërkuari kishte hequr dorë nga e drejta e tij për ta zëvendësuar atë, Gjykata deklaroi se heqja dorë nga një e drejtë e garantuar nga Konventa duhet të konstatohet në mënyrë të qartë. Këtu, jo vetëm Kryetari por edhe dy anëtarët e tjerë të Gjykatës së Apelit duhet të ishin tërhequr në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Pavarësisht nga qëndrimi në lidhje me kryetarin e trupit gjykues, as kërkuari e as avokati i tij nuk

u vunë në dijeni deri pas seancës së 17 dhjetorit 1984 që dy gjyqtarët e tjerë po ashtu kishin marrë pjesë në vendimin e 31 majit 1983.

Pra, nuk u konstatua që kërkuesi kishte hequr dorë nga e drejta që çështja e tij të vendosej nga një gjykatë “e paanshme”. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në këtë aspekt. Neni 10 nuk u vu në diskutim që, shpallja e kërkuesit fajtor nga Gjykata Rajonale e Vjenës më 11 maj 1984 dhe e konfirmuar nga Gjykata e Apelit e Vjenës më 17 dhjetor 1984, përbënte “ndërhyrje” tek e drejta e tij për lirinë e shprehjes. Diskutimi para Gjykatës u përqendrua tek pyetja nëse kjo ndërhyrje ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për ta arritur atë qëllim. Në këtë aspekt, Gjykata kujtoi se liria e shprehjes përbën një prej themeleve esenciale të një shoqërie demokratike dhe një prej kushteve bazë për përparimin e saj dhe vet përmbushjen individuale të secilit.

Gjykata theksoi se liria e debatit politik qëndron në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike, dhe problemi tek çështja në fjalë qëndronte tek kufijtë e kritikave të pranueshme në kontekstin e një debati politik lidhur me një çështje politike të interesit publik. Gjykata tha se kërkuesi ishte shpallur fajtor për riprodhimin në shtyp të tekstit të një informacioni penal të cilin ai dhe persona të tjerë e kishin ngritur kundër z. Grabher-Meyer. Informacioni i botuar nga kërkuesi fillonte duke cituar faktet e raportuara në deklaratat e z. Grabher-Meyer.

Më pas vijonte një analizë e atyre deklaratave, mbi bazën e së cilës autorët e informacionit dilnin me përfundimin se ky politikan kishte shprehur me vetëdije të plotë ide që përputhen me idetë e propaganduara nga nazistët. Gjykata tha se kërkuesi kishte botuar një deklaram të vërtetë të fakteve i ndjekur nga një gjykim mbi vlerën e atyre fakteve.

Më tej, Gjykata deklaroi se kërkesa e gjykatave austriake që ai duhet të jepte prova për vërtetësinë e pretendimeve të tij në vetvete ishte shkelje e lirisë së shprehjes. Sa i përket formës së botimit, Gjykata pranoi vlerësimin e bërë nga gjykatat austriake. Ajo shënoi se ato nuk e konstatuan që “prezantimi i artikullit në formën e informacionit penal” ishte çorientues në kuptimin që një numër i madh lexuesish ishin bërë të besonin se kundër z. Grabher-Meyer kishte nisur ndjekja penale ose madje se ai tashmë ishte shpallur fajtor. Për pasojë, kishte ndodhur shkelje e nenit 10 sepse ndërhyrja tek ushtrimi i të drejtës së kërkesit për lirinë e shprehjes nuk kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Neni 50 (tani neni 41)

Gjykata i caktoi kërkesit shumën 18,123.84 shilinga (afro 1,317 euro) në lidhje me dëmet dhe 85,285 shilinga (afro 6,197 euro) në lidhje me kosto dhe shpenzime.



**PËRMBLEDHJE E VENDIME
TË GJYKATËS KUSHTETUESE
FEDERALE GJERMANE**

Perceptimi i gjyqtarit të çështjes për portretizimin e migrantëve dhe azilkërkuesve si autorë të veprave penale haptazi ngrinin dyshime të arsyeshme për njëanshmërinë e gjyqtarit

KËRKESA BVR 890/20

1 korrik 2021

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi është shtetas afgan. Në mars 2017, Zyra Federale për Migrim dhe Refugjatë (Zyra Federale) e refuzoi kërkesën e tij për azil. Në procesin gjyqësor kundër këtij refuzimi, kërkuesi kërkoi zëvendësim të gjyqtarit të çështjes me pretendimin se ai kish qenë i anshëm. Për të vërtetuar pretendimin e tij, kërkuesi iu referua një vendimi që ky gjyqtar kishte dhënë në favor të partisë së ekstremit të djathtë NPD kundër heqjes së një posteri elektorale me sloganin “Stop pushtimit – migrimi vret! Rezistoni tani”.

Në këtë vendim gjyqtari në fjalë kishte konstatuar se urdhri që kërkonte heqjen e posterit ishte i paligjshëm për shkak të një gabimi procedural. Sipas tij shprehja “Migrimi vret” në posterin zgjedhor nuk përbënte nxitje të urrejtjes, por duhet të konsiderohej si pasqyrim i realitetit në një farë mase. Sipas këtij vendimi, fluksi i migrimit drejt Gjermanisë që nga viti 2014/2015 ka çuar në ndryshime brenda shoqërisë, që kanë shkaktuar vdekjen e njerëzve dhe terma afatgjatë cënojnë rendin kushtetues. [...] Gjyqtari u shpreh se gjykata ishte në djeni të rasteve në të cilat azilkërkuesit janë bërë vrasës.”

Gjykata Administrative rrëzoi kundërshtimin e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtarit. Përsa i takon rastit të kërkuesit Gjykata Administrative pranoi një pjesë të kërkesës duke hedhur poshtë

pjesërisht vendimin e Zyrës Federale dhe urdhëroi këtë zyrë t'i jepte kërkuetit statusin e mbrojtjes plotësuese. Kërkueti apeloj rrezimin e disa pikave të kërkesës së tij. Ky proces është ende në pritje në Gjykatën Administrative të Apelit.

Përpara Gjykatës Kushtetuese Federale kërkueti pretendoi shkelje të fjalisë së dytë të nenit 101.1 të Ligjit Themelor, duke pohuar se Gjykata Administrative kishte shkelur të drejtën e tij për përjashtimin e gjyqtarit.

VENDIMI I GJYKATËS

Gjykata Kushtetuese Federale konstatoi se vendimi i Gjykatës Administrative cenon të drejtën themelore për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur parashikuar në fjalinë e dytë të nenit 101.1 të Ligjit Themelor.

Kundërshtimi i gjyqtarit nga kërkueti nuk përbën një kritikë ndaj opinionit ligjor të gjyqtarit dhe as nuk përfshin përgjigjen e pyetjes ligjore nëse slogani i përdorur nga NPD përbën veprën penale të nxitjes së urrejtjes. Përkundrazi, ai merr deklaratat e gjyqtarit për migrimin si arsye për ta kundërshtuar atë.

Refuzimi i kërkesës së tij është arbitrar. Gjykata Administrative mohoi që paanshmëria e gjyqtarit mund të vihej në dyshim në bazë të vendimit të referuar në kërkesën e ankuesit. Kjo është e papranueshme në dritën e faktit se gjykimi përfshin një arsyetim të gjerë historik të pohimit se migrimi “për nga natyra e tij përbën një rrezik për vlerat kulturore” kudo që ndodh, si dhe ai përbën “rrezik për kulturën gjermane, rendin kushtetues dhe jetën e njerëzve”.

Sipas Gjykatës Kushtetuese është veçanërisht e papranueshme në dritën e pasazheve ku gjyqtari e konsideron shprehjen “migrimi vret” si një fakt i verifikueshëm empirikisht dhe i referohet rasteve

individuale të azilkërkuesve, që ishin dënuar për vrasje, ose vepra të tjera penale. Sipas Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari i kishte marrë këto raste individuale si provë se migrimi është i lidhur me vdekjen dhe se emigrantët në Gjermani janë të aftë të vrasin. Me këtë interpretim të proceseve historike dhe situatës aktuale politike, gjyqtari ngushton konceptin e gjerë të migrimit duke përfshirë dhe azilkërkuesit dhe portretizon anëtarët e këtij grupi, si autorë të veprave penale të rënda. Vendimi tregon qartë se gjyqtari në fjalë e konsideron migrimin si një forcë të keqe, që kërcënon të ardhmen e shoqërisë gjermane.

Pjesët e cituara më sipër dhe vëzhgime të tjera të bëra nga gjyqtari qartazi ngrinin dyshime të arsyeshme tek kërkuesi për njëanshmërinë e gjyqtarit. Ky përfundim nuk ndryshohet nga fakti se Gjykata Administrative, pranoi pjesërisht ankimin e kërkuesit.

*Rrëzimi i ankimit në bazë të ligjit cenoi të drejtën themelore të kërkuesve
për t'u gjykuar nga një gjyqtar i caktuar me ligj*

KËRKESAT BVR 2034/16 DHE BVR 2011/16

16 janar 2017

FAKTET KRYESORE

Në korrik 2014 kërkuesit u akuzuan për evazion fiskal, si dhe ndihmë e nxitje për evazion. Sipas skemës së caktimit të juridiksionit të Gjykatës Rajonale të Rostokut (Landgericht) në fuqi në atë kohë, divizioni 18 i Gjykatës Rajonale të Rostokut (divizioni i 8-të i gjykatës së madhe për vepra të rënda penale – 8. Große Strafkammer) do të ishte divizioni kompetent i kësaj gjykate për shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi. Pas marrjes së aktakuzës, më 12 nëntor 2014, kryetari i trupit gjykues të divizionit të 8-të të Gjykatës së Madhe zgjati afatin për paraqitjen e prapësimeve për të gjithë të akuzuarit deri më 1 dhjetor 2014. Të njëjtën ditë, kryetari i trupit gjykues njoftoi Presidiumin e Gjykatës Rajonale (Präsidium des Landgerichts) për ngarkesën e tepërt të divizionit dhe shpjegoi detajet përkatëse.

Rrjedhimisht, më 19 nëntor 2014, Presidiumi konfirmoi këtë ngarkesë dhe krijoi një seksion tjetër gjyqësor për veprat penale (Hilfsstrafkammer). Sipas urdhrit të Presidiumit, divizioni i ri kishte kompetencë për shqyrtimin e të gjitha proceseve të pranuar nga divizioni i 8-të i Gjykatës së Madhe që nga 1 gushti 2014. Procedimi i kërkuesve nuk nisi punën deri më 27 janar 2015.

Në seancën e parë publike të këtij procesi përfaqësuesit ligjorë të kërkuesve paraqitën kundërshtime në lidhje me përbërjen e trupit gjykues. Kundërshtimet bazoheshin kryesisht në pohimin se ndarja e

juridiksionit të përcaktuar në urdhrin e Presidiumit të datës 19 nëntor 2014 cenonte të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj dhe gjyqtar i pavarur, e drejtë kjo e parashikuar nga Ligji Themelor, pasi lejonte manipulime të kompetencave duke iniciuar ose mos filluar procesin. Kundërshtimet u refuzuan. Seksioni i ri i Gjykatës së Madhe i shpalli kërkuesit fajtorë dhe i dënoi me burg. Apelimet e kërkuesve për çështjen nuk patën sukses.

VENDIMI I GJYKATËS

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj dhe gjyqtar i pavarur ka për qëllim parandalimin e rrezikut të ndërhyrjes së papërshtatshme në dhënien e drejtësisë. Një nga funksionet kryesore të këtij parashikimi është të ruajë pavarësinë e gjyqësorit dhe besimin e publikut në paanshmërinë dhe objektivitetin e gjykatave. Sipas kësaj garancie kushtetuese, ndarja e juridiksionit të gjykatave duhet të jetë sa më specifike dhe e qartë. Duhet të jetë e mundur të përcaktohet gjyqtari kompetent ose seksioni gjyqësor për çdo proces, thjesht duke iu përmbytur skemës së ndarjes së juridiksionit gjyqësor.

Zgjidhja e dhënë nga Presidiumi i Gjykatës Rajonale për rivendosjen e afatit është e papajtueshme me Ligjin Themelor, sepse krijon mundësi për një ndikim të padrejtë të organeve gjykuese duke vendosur nëse do të fillojë ose jo shqyrtimi mbi themelin. Më vonë mund të bëhet i nevojshëm një ndryshim i ndarjes së juridiksionit nëse kjo është mënyra e vetme për të garantuar mbrojtje efektive ligjore. Një ndryshim i tillë nuk ndalohet përgjithësisht nga e drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, por duhet të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara më sipër.

Skema e ndarjes së juridiksionit në fjalë nuk përmbante ndonjë dispozitë të përgjithshme-abstrakte në lidhje me çështjen fillestare. Zgjidhja që iu dha rastit duke shtyrë afatin lejon vetëm përcaktimin e mëvonshëm të kompetencave specifike në lidhje me nisjen ose jo të

shqyrtimit të themelit të çështjes. Delegimi i vendimit për ndarjen e juridiksionit tek organet gjyqësore, që në fakt duhet të jenë adresues të kompetencës abstrakte është i papajtueshëm me fjalinë e dytë të nenit 101.1 të Ligjit Themelor.

Gjykata Kushtetuese Federale vërejti se vendimet e gjykatave penale cenuan të drejtën e kërkuesve për tu gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj garantuar në fjalinë e dytë të nenit 101.1 të Ligjit Themelor.

Vendimmarrja e Presidiumit nuk ishte në përputhje me garancitë kushtetuese të gjykimit të drejtë. Për rrjedhojë, vendimmarrja e seksionit të ri të gjykatës në llogari të kërkuesve nuk përbën një vendim të dhënë nga një gjykatë e krijuar me ligj. Rrëzimi i ankimit mbi bazë të ligjit ka cenuar të drejtën e kërkuesve për t'u gjykuar nga një gjyqtar i caktuar me ligj e drejtë kjo e konsideruar si drejtë themelore.

Zbatimi i ligjit nga kërkuesi në mënyrë jo koherente nuk kishte ardhur si rezultat i mbingarkesës në puna

KËRKESA BVR 661/16

14 korrik 2016

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi është ish-gjyqtar i Gjykatës Lokale. Ai iu nënshtrua procedimeve disiplinore për shkak se kishte dhënë shumë pak rezultate në punë, si dhe kishte përdorur formatin zyrtar¹ të korrespondencës së gjykatës për t'u ankuar tek krye bashkiaku për pakënaqësitë lidhur me pastrimin e rrugëve të qytetit. Ky gjyqtar punonte që nga viti 1997 në seksionin e kundërvajtjeve administrative të Gjykatës Lokale. Prej vitit 2002 ai ndihej i mbingarkuar me punë. Megjithatë, për shkak të mungesës së argumenteve objektive, mbingarkesa e punës nuk u konfirmua zyrtarisht. Në vitet 2010 dhe 2012, kërkuesi njoftoi drejtuesin e Gjykatës Lokale për gjendjen e tij. Ndjenja subjektive e të ndjerit i mbingarkuar me punë vinte dhe për shkak të problemeve të tij shëndetësore.

Gjatë procesit penal kundër kërkuesit, një psikiatër i ngarkuar për ekzaminim diagnostikoi tipare të një çrregullimi anancastik të personalitetit. Megjithatë, kërkuesi nuk iu nënshtrua trajtimit të mjaftueshëm për problemet e tij shëndetësore. Për rrjedhojë, gjendja e tij e përgjithshme psikologjike përkeqësohej vazhdimisht.

Përpara vitit 2005, kërkuesi rrëzoi gjobat administrative të dhëna nga autoritetet për shkak të mosdorëzimit të raporteve përkatëse që kishin kryer matjen e shpejtësisë në rrugë bashkë me dosjet.

1 Letër me logon zyrtare në kokën e saj.

Gjithashtu, ai informoi organet administrative se kishte ndërmend të merrte “vendime të ndryshme” nëse ata nuk do t’i dorëzonin ato raporte në të ardhmen. Ndërmjet viteve 2006 dhe 2008, kërkuesi liroi disa të akuzuar në procese të ngjashme ku raportet nuk ishin në dosje. Në argumentet e tij, ai parashtroi se nuk ishte në gjendje të verifikonte korrektësinë e matjeve për shkak të mungesës së raporteve të përkatëse. Sipas tij, kjo përbënte një pengesë procedurale. Në disa raste, Gjykata e Lartë Rajonale ka ndryshuar vendime të tilla.

Në vitin 2011, kërkuesi liroi përsëri disa të akuzuar për mungesë të raporteve të matjes së shpejtësisë ose certifikatave të kalibrimit në lidhje me shpejtësinë, drejtimin e mjetit me semafor të kuq dhe për tejkallim të peshës maksimale të lejueshme për automjetet. Në arsyetimin e tij, ai deklaroi se Gjykata e Lartë e Rajonale, në vendimet e saj të mëparshme, nuk kishte njohur funksionin gjyqësor për të hetuar dhe kishte ndryshuar rolet e autoriteteve hetuese dhe gjykatave. Ai më tej deklaroi se nuk ishte detyra e gjykatës të korrigjonte mangësitë në menaxhimin e dosjeve administrative, por më tepër të siguronte “barazinë e armëve” procedurale për personin në fjalë.

Si pasojë e këtyre vendimeve, në vitin 2011 ai u akuzua për pengim të drejtësisë por u deklarua i pafajshëm nga Gjykata e Lartë Rajonale në vitin 2013. Gjykata Federale e Drejtësisë e prishi vendimin dhe e riktheu çështjen në Gjykatën Rajonale. Në vendimin e mëposhtëm, kërkuesi u dënua për pengim të drejtësisë në shtatë raste.

Në ankimin e tij kushtetues kërkuesi ankimoi vendimin e Gjykatës Federale të Drejtësisë dhe dënimin e tij për pengimin e drejtësisë dhënë nga Gjykata Rajonale. Ai pretendoi se e drejta e tij për të qenë i pavarur ishte cenuar.

VENDIMI I GJYKATËS

Gjykata Kushtetuese Federale vërejti se vendimet e apeluara nuk janë të kundërshtueshme sipas ligjit kushtetues, pasi sipas saj nuk ka pasur shkelje të parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Kërkuesi ishte i detyruar me ligj të kryente detyrat e tij funksionale ai nuk zbatoi në përpikmëri parashikimet e nenit 20.3 të Kushtetutës. Ai u justifikua me përjashtime ligjore të tjera.

Megjithëse jo çdo sjellje e pahijshme e një gjyqtari, që vjen si pasojë e mbingarkesës në punë përmbush elementet përbërëse për t'u konsideruar pengim i drejtësisë, zbatimi i ligjit nga kërkuesi në mënyrë jo koherente nuk bazohej vetëm në një mbingarkesë të tillë pune. Në një kohë që mbingarkesa në punë mund të merret parasysh në raste individuale, ajo nuk mund të konsiderohej e rëndësishme në rastin e kërkuesit.

Gjykata Kushtetuese Federale nuk e pranoi ankesën kushtetuese për vendim, pasi nuk ishin përmbushur kriteret e pranimit sipas nenit 93a.2 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese Federale. Gjykata u shpreh se ankesa kushtetuese ishte e pabazuar.

Në një balancim të përgjithshëm të të gjithë faktorëve, Gjykata Kushtetuese Federale vërejtë se vëzhgimi i kërkuetit nuk ishte proporcional në krahasim me ashpërsinë e ndërhyrjes në pavarësinë e mandatit të deputetit.

KËRKESA BVR 2436/10

17 shtator 2013

FAKTET KRYESORE

Kërkuesi ka qenë anëtar i Parlamentit të Thuringisë² prej tetorit 1999. Nga tetori 2005 deri në shtator 2009, ai ishte anëtar i Bundestagut³ Gjerman ku ishte anëtar i grupit parlamentar DIE LINKE, si dhe nënkryetar i tij. Ai ka qenë kryetar i të njëjtit grup parlamentar DIE LINKE në Parlamentin e Thuringia prej vjeshtës 2009.

Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës (Bundesamt für Verfassungsschutz) vëzhgon anëtarë të Bundestagut Gjerman, që janë anëtarë të grupit parlamentar DIE LINKE. Prej vitit 1986 ajo ka mbajtur një dosje personale për kërkuesin, në të cilën janë mbledhur informacione që datojnë që nga vitet 1980. Informacioni i mbledhur ka të bëjë me punën e kërkuesit brenda dhe për partinë, si dhe punën e tij si deputet që nga viti 1999, me përjashtim të qëndrimit të tij në votim dhe deklaratave të tij si në Parlament dhe komisione. Megjithatë, Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës vlerëson dokumentet parlamentare dhe mbledh informacione dhe për aktivitetet e tjera politike të kërkuesit. Sipas fakteve të gjetura nga gjykatat vendase, vetë kërkuesi nuk dyshohet se ka kryer veprimtari

2 Land gjerman.

3 Parlamenti.

kundër rendit kushtetues. Arsytimi i vetëm për vëzhgimin e tij është anëtarësimi dhe funksionet e tij në partinë DIE LINKE.

Në ankimin e tij kushtetues, kërkuesi kundërshtoi një vendim të Gjykatës Administrative Federale (Bundesverwaltungsgericht) të datës 21 korrik 2010 (BVerwGE 137, 275), i cili miratoi vëzhgimin e kryer nga Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës.

VENDIMI I GJYKATËS

Mandati i pavarur i deputetit sipas nenit 38/1 fjalia dytë e Ligjit Themelor (Grundgesetz - GG) mbron formimin e pandërprerë të opinioneve nga parlamentari. Ky mandat përfshin një marrëdhënie komunikimi midis parlamentarit dhe votuesve, që duhet të jetë e lirë nga ndërhyrjet e qeverisë. Parimi i lirisë së mendimit është i lidhur ngushtë me parimin e demokracisë parlamentare sipas nenit 20/2 fjalia e dytë e Ligjit Themelor. Në demokracinë përfaqësuese të krijuar nga Ligji Themelor, formimi i mendimeve nga populli dhe formimi i mendimeve në organet shtetërore ndodhin në një ndërveprim të vazhdueshëm dhe të larmishëm. Procesi komunikues në të cilin deputeti jo vetëm përcjell, por edhe merr informacion, mbulohet nga pavarësia e mandatit të tij.

Në këtë kontekst, neni 38/1 fjalia e dytë mbron gjithashtu të drejtën e parlamentarëve për të qenë të lirë nga vëzhgimi, mbikëqyrja dhe kontrolli nga ekzekutivi. Ky parashikim lidhet ngushtë me parimin e ndarjes së pushteteve garantuar nga neni 20/2 fjalia e dytë. Është e vërtetë, që deputetët nuk janë *a priori* të përjashtuar nga çdo kontroll ekzekutiv. Megjithatë, ky kontroll është në radhë të parë përgjegjësi e Bundestagut gjerman, i cili vepron këtu në kuadrin e autonomisë parlamentare.

Sipas nenit 28/1 të Ligjit Themelor, e drejta e parlamentarëve për të qenë të lirë nga kontrolli i ekzekutivit vlen edhe për anëtarët e

Parlamenteve të Landeve (shtetet federale). Në rastin konkret, ai mund të kundërshtohet nëpërmjet një ankese kushtetuese sepse kërkuesi po kundërshton vendimin e një Gjykate Federale.

Vëzhgimi i një deputeti nga Zyrat e Mbrojtjes së Kushtetutës dhe mbledhja e ruajtja e nënkuptuar e të dhënave përbën ndërhyrje në mandatin e pavarur. Kjo ndërhyrje mund të justifikohet në raste individuale, por duhet ti nënshtrohet kërkesave strikte të proporcionalitetit.

Interesi për mbrojtjen e rendit kushtetues mund të mbizotërojë veçanërisht nëse ka indikacione se deputeti e keqpërdor mandatin e tij për luftën kundër këtij rendi kushtetues, ose e lufton këtë rend në mënyrë aktive dhe agresive.

Përkatësia në një parti të caktuar politike mund të përbëjë një aspekt të vlerësimit të përgjithshëm të kërkuar. Neni 21 i Ligjit Themelor u jep partive një rol të madh në formimin e vullnetit politik të popullit në rendin demokratik. Për këtë arsye, mund të supozohet se rendi kushtetues forcohet nga aktivitetet politike partiake, që bazohen në të. Pra, anëtarësimi i thjeshtë në një parti mund të justifikojë vetëm një vëzhgim të përkohshëm, i cili ndihmon për të qartësuar funksionet, rëndësinë dhe pozicionin e deputetit në parti, marrëdhëniet me segmentet antikushtetuese, për të vlerësuar rëndësinë e këtyre segmenteve brenda partisë dhe në parlament.

Përveç kësaj, kufizimi i mandatit të pavarur nëpërmjet vëzhgimit të deputetëve kërkon një bazë ligjore, e cila duhet të plotësojë kërkesat e të qenit specifike dhe e qartë sipas parimeve të shtetit të së drejtës. Vendimi i Gjykatës Administrative Federale i datës 21 korrik 2010 nuk i plotëson mjaftueshmërisht këto kritere. Sipas kritereve të lartpërmendura, vëzhgimi i kërkuarit nga Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës përbën një ndërhyrje të pajustificuar në ushtrimin e pavarur të mandatit të tij.

Megjithatë, sikurse kishin vërejtur gjykatat që shqyrtuan çështjen mbledhja e informacionit ishte bërë pa përdorur metoda të mbledhjes së informacionit sekret. Kur pohoi se Zyra për Mbrojtjen e Kushtetutës ka përdorur metoda të mbledhjes së informacionit sekret, kërkuesi nuk ka identifikuar shkelje të rëndësishme kushtetuese të bëra nga gjykatat të cilat kanë konstatuar të kundërtën.

Dispozitat përkatëse të ligjit për Zyrën Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës përbëjnë një bazë ligjore mjaft specifike, që plotëson kërkesat e rezervës ligjore. Është vetë legjislativi ai që i është përgjigjur pozitivisht pyetjes jetike nëse anëtarët e Bundestagut gjerman mund t'i nënshtrohen vëzhgimit nga Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës. Në kuadër të nenit 8 § 5 të Ligjit për Zyrën Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës, me qëllim përcaktimin e proporcionalitetit, legjislatori ka marrë në konsideratë mjaftueshëm nevojën e veçantë të deputetëve për mbrojtje.

Gjykatat e përfshira kanë deklaruar shprehimisht se vetë kërkuesi nuk dyshohet se ka kryer veprimtari antikushtetuese. Gjykatat gjetën vetëm indikacione faktike për një dyshim të tillë në lidhje me një njësi të partisë DIE LINKE, të cilës kërkuesi nuk i përket dhe as nuk e mbështet. Edhe duke marrë parasysh marrëdhëniet e tij me partinë dhe segmentet e saj, vetë kërkuesi nuk paraqet kërcënim për rendin kushtetues. Për më tepër, sjellja e tij - në veçanti, nëse ai lufton në mënyrë aktive forcat radikale - mund të justifikojë vëzhgimin e tij vetëm nëse këto forca do të kishin një ndikim dominues brenda partisë. Asnjë konstatim i tillë nuk u bë gjatë proceseve gjyqësore.

Sipas kriterëve të mësipërme, supozimi i mëposhtëm i Gjykatës Administrative Federale është i pambështetur nga pikëpamja kushtetuese. Vendimi i saj nuk e kupton se veprimtaritë politike partiake të bazuara në rendin themelor të lirë demokratik e forcojnë këtë rend. Kjo vlen dhe nëse ndodh brenda një partie në të cilën forca dhe segmente të ndryshme luftojnë me njëra-tjetrën për ndikim.

Për më tepër, Gjykata Administrative Federale nuk sheh se instrumentet e përdorura nga Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës janë joproportionale në lidhje me sjelljen e kërkuesit në sferën parlamentare, e cila mbrohet veçanërisht me neni 46 § 1 i Ligjit Themelor. Gjykata Kushtetuese Federale vëren se nuk është kryer asnjë nga balancimet e nevojshme të interesave në lidhje me mbledhjen dhe vlerësimin e dokumenteve parlamentare.

Gjykata Kushtetuese Federale vërejti se vëzhgimi i gjatë i kërkuesit nuk i plotëson kërkesat e parimit të proporcionalitetit. Në një balancim të përgjithshëm të të gjithë faktorëve, njohuritë e vogla shtesë që Gjykata Administrative Federale për krijimin e një tabloje gjithëpërfshirëse të partisë janë joproportionale në krahasim me ashpërsinë e ndërhyrjes në pavarësinë e mandatit të deputetit.



**PËRMBLEDHJE E VENDIME
TË GJYKATËS KUSHTETUESE
ITALIANE**

Papajtueshmëria e gjyqtarit që ka kryer veprime procedurale për të mbrojtur vlerat e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit

VENDIMI 16/2022

(Kërkesa nr. 44520)

21 janar 2022

OBJEKTI I ÇËSHTJES

Në rastin konkret, paligjshmëria kushtetuese e normës, që parashikon se Gjyqtari i Veprimeve Paraprake (GIP), që ka hedhur poshtë kërkesën procedurale penale, mund të shqyrtojë një kërkesë të re penale të lidhur me themelin e çështjes.

VENDIMI I GJYKATËS

Rregullat për papajtueshmërinë e gjyqtarit, që rrjedhin nga veprimet e kryera gjatë hetimit, synojnë të mbrojnë vlerat e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës, të mbrojtura nga nenet 3, 24 (2) dhe 111 (2) të Kushtetutës, duke synuar që të shmangin kufizimin e vendimmarrjes për themelin e çështjes. Pra, në këtë rast shmanget qasja e natyrshme për vendimmarrje të njëjtë ose për të mbajtur të njëjtin qëndrim, që rrjedh nga vlerësimet dhe bindja e gjyqtarit mbi të njëjtën çështje e cila për të është *res judicata*.

Kështu, neni 34 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale vlerësohet si anti-kushtetues dhe bie ndesh me parashikimin e neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës. Konkretisht neni 34/2 i Kodit të Procedurës Penale nuk parashikon se GIP, i cili ka rrëzuar pranimin e një kërkesë për

rrethana rënduese, është i papërshtatshëm për të dhënë një vendim mbi parashtrimet e reja të bëra nga prokurori.

Me gjykim nënkuptojmë çdo vendimmarrje, e cila në bazë të shqyrtimit të provave jep vendim mbi themelin. Prandaj koncepti përfshin jo vetëm gjykimin, por edhe gjykimin e shkurtuar, ekzekutimin e dënimit me kërkesë të palëve, seancën paraprake si dhe vendimmarrjen mbi dënimin.

Përkufizimi i "nivelit tjetër" të gjykimit, veçanërisht në procesin civil dhe çdo fazë që pason atë të mëparshme, me objekt të njëjtë dhe për të njëjtat parashtrime të propozuara në fazën e parë

VENDIMI 45/2023

(Kërkesa nr. 45424)

17 mars 2023

OBJEKT GJYKIMI

Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarit, shtrirja e këtij parimi në çdo lloj gjykimi

Në rastin konkret deklarimi si anti-kushtetues i nenit 630 (3) të Kodit të Procedurës Civile, në pjesën ku përcaktohet se kundër urdhrin për shuarjen e ekzekutimit, lejohet ankimi në kolegji, pa parashikuar se gjyqtari që ka marrë pjesë në procesin e mëparshëm dhe ka dalë me një vendim nuk mund të jetë sërish pjesë e tij.

VENDIMI I GJYKATËS

Parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës ka vlerë të plotë kushtetuese në lidhje me çdo lloj procesi, përfshirë edhe ekzekutimin e vendimit.

Kërkesa që gjyqtari të mos japë vendime mbi fakte që lidhen me vlerësime të mëparshme të bëra prej tij nënkupton në mënyrë të drejtpërdrejtë garantimin e parimit të paanësisë së gjykatës.

Në kuadrin e procesit civil, gjyqtari duhet të përjashtohet në rastet kur i kërkohet të marrë një vendim tjetër mbi të njëjtën çështje p.sh.

në rastet e ankimit para të njëjtit organ gjyqësor ose një organi tjetër më të lartë.

Në rast se ligji parashikon papajtueshmërinë e gjyqtarit për të marrë pjesë në gjykim për shkak të njohurive mbi çështjen, që mund ti ketë marrë gjatë një shkalle tjetër gjykimi, gjyqtari ka detyrimin të tërhiqet nga çështja dhe palët kanë të drejtë ta kundërshtojnë atë, në zbatim dhe brenda kushteve të parashikuara nga neni 52 i Kodit të Procedurës Civile.

Në rastin konkret, neni 630/3 i Kodit të Procedurës Civile shpallet i papajtueshëm me Kushtetutën, konkretisht me nenin 11 (2) të saj, sa i takon klauzolës që parashikon përfundimin e procesit të ekzekutimit ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim. Për këtë lejohet ankim përpara të njëjtit trup gjykues.

Ankimi kërkon një *revisio prioris instantiae*, i cili i jep trupit gjykues të njëjtin lloj vlerësimi në bazë të dispozitës së miratuar nga gjyqtari përmbarues, duke e përfshirë vendimin e ankimit brenda garancive kushtetuese në lidhje me paanshmërinë. Paanshmëria e gjyqtarit përfshin edhe procesin e ekzekutimit të vendimit.

